9	**Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe aseteve** Përfshin bërjen publike të: 1. Aseteve dhe pronave të ofruara për shitje ose dhënie me qira 2. Kritereve që duhet të plotësohen	Neni 19 i ligjit 68/2017	a) www.elbasani.gov.al b) Stenda në hyrje të bashkisë c) Gazeta "Almanak"e Bashkisë Elbasan;		Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë
10	**Donacionet.** Përfshin bërjen publike të: 1. Emrit të donatorit 2. Shumës së donacionit 3. Qëllimit e donacionit	Neni 20/5 të ligjit 68/2017	http://elbasani.gov.al/sq-al/Bashkia/Pages/projekte.aspx	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë

Fusha 3- Për kërkesat për informim						
Nr	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin

3.	**Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve.** Përfshin bërjen publike të: 1. Të gjitha kërkesave për informim 2. Informacionet e dhënë në përgjigje të kërkesave për informim 3. Përditësimi i regjistrit	Neni 7/i i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja http://elbasani.gov.al/sq-al/Services/Pages/programitransparences.aspx	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
4.	**Informacion i dhënë më parë**	Neni 9 i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja……..(me link)	Menjëherë	Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
5.	**Trajtimi i kërkesave për informacion** Përfshin bërjen publike të: 1. Procedurës së regjistrimit të kërkesës në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2. Afateve të trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë 3. Mënyrave të dhënies së informacionit	Neni 11, 12 dhe 14 i ligjit Nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja www.elbasani.gov.al		Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
6.	**Kufizimi i së drejtës së informimit** Përfshin bërjen publike të: 1. Rasteve të kufizimit të së drejtës për informim;	Neni 17 i ligjit Nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja www.elbasani.gov.al		Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
7.	**Tarifa për dhënien e informacionin (nëse ka)** Përfshin bërjen publike të: 1. Tarifave 2. Rregullave për mënyrën e kryerjes së pagesës	Neni 13/1 i ligjit Nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja www.elbasani.gov.al	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	Koordinatori për të drejtën e informimit

1	**Shërbimet** Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron bashkia sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015 1) Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike 2) Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale 3) Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese 4) Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit 5) Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit 6) Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor 7) Shërbimet në fushën e sigurisë publike 8) Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara..... Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi: ✓ Instrumentin për administrimin e shërbimit ✓ Sistemin e administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet ✓ Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës ✓ Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor	Neni 32-33 i ligjit nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja http://elbasani.gov.al/sq-al/Services/Pages/default.aspx	**Menjëherë**	**Kryetari i Bashkisë**	**Koordinatori për të drejtën e informimit**
2.	**Shërbimet administrative** Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron bashkia sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015 1) Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike		a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja http://elbasani.gov.al/sq-al/Services/Pages/lista.aspx b) Website c)Gazeta	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
	2) Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale 3) Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese 4) Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit 5) Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit		1. http://elbasani.gov.al/sq-al/Services/Pages/kerkesean kesa.aspx 2. http://elbasani.gov.al/sq-al/Services/Pages/Sherbimi-Social.aspx			

	- Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës					
4	**E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet** Përfshin bërjen publike të: 1. Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet 2. Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve		a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja http://elbasani.gov.al/sq-al/Services/Pages/kerkeseankesa.aspx b)Vendet e caktuara për njoftimet publike Nëpërmjet zyrës së Informacioni	Brenda 10 ditëve nga shpallja e miratimit	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

Fusha 5 - Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore

Nr	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike se këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	**Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore:** 1) I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave: - Fusha e organizimit dhe funksionimit të bashkisë - Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare - Fusha e qeverisjes së mirë vendore (integriteti, etika, anti-korrupsioni, transparenca, llogaridhënia etj) - Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike - Fusha e shërbimeve sociale - Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese - Fusha e mbrojtjes së mjedisit	Neni 7/b i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja 1. http://elbasani.gov.al/sq-al/Bashkia/Pages/legjislacini.aspx	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare. Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit dhe kryetarit bashkisë brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Kuvendi i Shqipërisë Këshilli i Ministrave Ministri Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

2.	**Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje.** Përfshin bërjen publike të: 1. Akteve që do të konsultohen 2. Mënyrat e konsultimit 3. Afatet 4. Strukturat përgjegjëse	Neni 6/b i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
3.	**Dispozitat e brendshme rregullatorë për këshillimin me publikun.** Përfshin bërjen publike të:	Neni 18/2 i ligjit 139/2015 dhe	a)Në faqen zyrtare të internetit-	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak
	1. Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim	neni 6 ligji 146/2014	menuja……..(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve)		Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
4.	**Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik.** Përfshin bërjen publike të: 1. Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik	Neni 18/1 ligjit Nr. 139/2015 Neni 5/ç dhe 13/3 e ligji Nr. 68/2017 Neni 1/1 dhe 4/c e ligjit 146/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve)	Menjëherë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

7.	**Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim** në lidhje me konsultimin publik. Përfshin bërjen publike të: 1. Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i bashkisë, Kryetari i bashkisë;) 2. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës 3. Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun 4. Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën	Neni 21 i ligjit Nr. 146/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja http://elbasani.gov.al/sq-al/Services/Pages/Kerkese-Ankese.aspx b) Vendet e caktuara për njoftimet publike Plotësimi i ankesës ose kërkesën pranë zyrave me një ndalesë	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
8.	**Raporti vjetor për transparencën** në procesin e vendimmarrjes. Përfshin bërjen publike të: 1. Numrit të akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti. 2. Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; 3. Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes 4. Numrin e takimeve publike të organizuara	Neni 20/1 i ligjit Nr. 146/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja www.elbasani.gov.al	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
9.	**Iniciativa qytetare.** Përfshin bërjen publike të: 1. Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare	Neni 20/1 Ligji Nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja http://elbasani.gov.al/sq-al/Services/Pages/pjesemarrjaqytet.aspx	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak
	2. Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare 3. Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare. 4. Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare					Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
F7 - Informacion tjetër						

V. PROCESI I PËRGATITJES DHE ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

1. Përgatitja

Procesi i përgatitjes së projekt-programit të transparencës drejtohet nga Kryetari i Bashkisë duke u mbështetur në Programin model të Transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore, miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me urdhër nr. ... datë .../.../2018.

2. Miratimi

Bazuar në nenin 9, 15 dhe 18/3 të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 4 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe në programin model të miratuar nga Komisioneri, Këshilli Bashkiak me vendim nr..., datë .../.. 2018 miraton Programin e Transparencës së bashkisë.

3. Publikimi

Brenda 10 ditëve nga data e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak, Programi i Transparencës publikohet (i) në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar "Programi i Transparencës" *(linku)* (ii) në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.

4. Zbatimi

Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për zbatimin e përditshëm të Programit të Transparencës. Në ushtrim të kësaj përgjegjësie, Kryetari i Bashkisë me urdhër nr..., datë..../...../201... ka caktuar [emër mbiemër], Koordinator për të drejtën e informimit si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Me urdhër nr..., datë..../...../201... ka caktuar [emër mbiemër], Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Me urdhër nr..., datë..../...../201... ka miratuar Rregulloren e Administratës së bashkisë [linku] e cila në nenin ... ka përcaktuar procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të faqes zyrtare të internetit të bashkisë për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës. Në nenin ... janë përcaktuar procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo strukture të administratës për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës dhe në nenin ... janë përcaktuar procedurat e trajtimit të kërkesave për informim.

5. Monitorimi

Monitorimi kryhet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili mbikëqyr respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe në rastet kur vërehet mosrespektim i tyre, bën vlerësimin e kundërvajtjes dhe vendos sanksionet administrative përkatëse. Këshilli Bashkiak mbikëqyr informimin e publikut nga ana e bashkisë duke analizuar dhe vlerësuar shkallën e zbatimit të rregullave që ai vetë ka vendosur.

Kryetari i Bashkisë vlerëson dhe mbikëqyr të gjithë procesin e zbatimit të programit të transparencës nga ana e administratës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë. Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës do të bëhet jo më pak se njëherë në vit nga ana e këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë.

533/2
05.02.19

14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 135/1 prot.

Elbasan, më 01. 2. 2019

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.10 datë 24.01.2019 "Mbi miratimin e Programit të Transparencës të Bashkisë Elbasan", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Gledian Llatja

Arkivit!
Origjinali në dosje
Fotokopje drejtorive
përkatese për zbatim!
dt. 05.02.2019

Lagja "Brig.17 Sulmuese", Rr."Qemal Stafa" Tel.054252138, www.prefektielbasan.gov.al , prefekti.elbasan@mb.gov.al

136
30.1.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 534/1 Prot. Elbasan, më 30.01.2019

V E N D I M

Nr. 11 datë 24.01.2019

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR PUBLIK
Rinovoimi i kontratave të qirasë me kompanitë e telekomunikimit "Albtelekom"sha, "Telekom"sha dhe "Vodafon"sha.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____.____.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit, i mbështetur në:

a) Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
b) Ligjin nr. 9385 datë 04.05.2005"Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar,
c) Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar,
d) Ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-teritoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë",
e) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë Mjedisit e të ish komunave/bashkive",
f) Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik",

V e n d o s i:

1. Të miratojë rinovimin e kontratave për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi dhe plan-vendosjeve të stacioneve të telefonisë së lëvizëshme në Petresh, Shelcan dhe Seltë.

2. Procedura ligjore për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve pyjore publike të vazhdohet vetëm pasi të jetë konfirmuar përmbushja e detyrimeve të parashikuara nga kontratat e mëparshme.

BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PYJORE, BUJQËSISË, VETERINARISË DHE MJEDISIT

LISTA N/NGASTRAVE PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TE FONDIT PYJOR PUBLIK

Rinovim i kontratave të qirasë me kompanitë e telekomunikimit 'Albtelekom'sha, 'Telekom'sha, dhe Vodafon'sha.

Nr.	Subjekti	Ekonomia pyjore	Ngastra nr.	Qëllimi i përdorimit parashikuar në VKM Nr. 1064 dt.22.12.2010	Afati I përdorimit (vjet) kohëzgjatjes së kontratës	Tarifa dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qeraje të fondit pyjor VKM Nr. 1064 dt.22.12.2010						Vlera gjithësej lekë/vit	Shënim
						Sip. (ha) që propozohet të jepet në përdorim dhe vlera lekë/vit (Lidhja 2.7. 3.)			Përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes me rrjetin rrugor ekzistues (km) Lidhja2.12.3				
						Sip. (ha)	Tarifa lek/ha/vit	Vlera lekë/vit	Rrugë lidhëse (km)	Tarifa lek/km/vit	Vlera lekë/vit		
1.	Telekom albania sha	Kushë_l	2/a	Për vendosje antene të telefonisë lëvizëshme/stacion transmetimi celular.	6-9	0.025	8000000	200000.0	0.5	35000	17500.0	217500.0	Bazuar në udhezim të Ministrisë Mjedisit, nr. 1 dt. 09.06.2016 "Për rregullat, proçedurat e kalimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullsor publik", pika 22, kur persona fizikë/ juridikë janë të pajisur me leje/licencë nga institucionet përkatëse për veprimtaritë që kanë të bëjnë me: g) procedurat në zbatim të ligjit për ndërtimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare, ***përjashtohen nga konkurimi publik.***
2.	Vodafon albania sha	Shpat-Shtërrmen	62/a	Për vendosje antene të telefonisë lëvizëshme/stacion transmetimi celular.	1-5	0.03	8500000	255000.0	0.5	35000	17500.0	272500.0	
3.	Vodafon albania sha	Kushë_l	2/a	Për vendosje antene të telefonisë lëvizëshme/stacion transmetimi celular.	1-5	0.03	8500000	255000.0	0.5	35000	17500.0	272500.0	
4.	Albtelekon	Gjinar-Zavalinë	101/a	Për vendosje antene të telefonisë lëvizëshme/stacion transmetimi celular.	6-9	0.02	10000000	200000.0	0.8	35000	28000.0	228000.0	
	Shuma gjithësej					0.105		910000.0			80500.0	990500.0	

SPECIALISTI I KADASTRËS
Preni Bardhi

PËRGJEGJËSI SEKTORIT
Jakov Bodurri

D R E J T O R I
Shpëtim Çullhaj

Adresa: Bashkia Elbasan, rruga "Q. Stafa", sheshi "Aqif Pasha", Elbasan,Tel: (+355) 54 252734; Fax: (+355) 54 252246;
E-mail: bashkiaelbasan@yahoo.com

534/2
12-02-19

4

REPUBLIKA E SHQIPERISE

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 136 prot. Elbasan, më 8.2.2019

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 11 datë 24.01.2019 " Për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik ", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

GLEDIAN LLATJA

Arkivit!
Origjinali në dosje
Fotokopje dërgtorive
përkatëse për zbatim!
dt. 12.02.2019

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", Tel: 054 252138, ëëë.prefektielbasan.gov.al, prefekti.elbasan@mb.gov.al

137
30.1.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr637/1 Prot. **Elbasan, më 30.01.2019**

V E N D I M

Nr.12 Datë:24.01.2019

"Mbi miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin (e pasurive nr. 14/388 dhe nr.14/402) në lagjen "5 Maj", për realizimin e projektit, me interes publik "Rikonstruksion i plotë i Rrugës "Baki Kotherja"", Z.K. 8525 nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi"".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.01.2019 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operiacionale dhe Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Miraton në parim fillimin e proçedurës së shpronësimit për pasuritë me nr. 14/388 dhe nr. 14/402 ndodhur në Z.K. 8525, lagja "5 Maj", për realizimin e projektit, me interes publik "Rikonstruksioni i plotë i Rrugës "Baki Kotherja"", nga Bashkia Elbasan.

2. Miraton përdorimin e shumës së mbetur disponibël, prej 29.2 milion lekë, nga kredia e miratuar me V.K.B. nr.101 datë 23.11.2009, si burim financimi për shpronësimin e pasurisë të prekur nga projekti i lartpërmendur.

3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

ZV/KRYETAR
Zheni Gjergji

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Sektori Pronave : *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Financës: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *Q. Tusha*
Drejtoria P.Sh.O.: *E. Këmuti*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *K. Xhoxhi*

637/2
07.02.19

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

SEKTORI JURIDIK

Nr.137/1 **Prot.** **Elbasan më** 5/2/19

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.12 dt.24.01.2019 "Mbi miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin (e pasurive nr.14/388 dhe nr.14/402) në lagjen "5Maj", për realizimin e projektit, me interes publik "Rikonstruksion i plotë i rrugës "Baki Kotherja", Z.K 8525 nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Gledian LLATJA

137
30.1.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Nr.640/1 Prot. **Elbasan më,30.01.2019**

VENDIM

Nr.13 Dt.24/01/2019

"MIRATIMIN DHE DHENIE BURSE NGA FONDET E BASHKISE ELBASAN PER STUDENTEN ME AFTESI TE KUFIZUARA, ANTONETA LIKOLLARI"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 24/01/2019, mori ne shqyrtim relacionin e bazuar ne kerkesen e studentes Antoneta Lefter Likollari, lindur e banuese ne Katund te Ri, e regjistruar prane Universitetit "Aleksander Xhuvani" Elbasan, e percaktuar me paaftesi te Grupit te II (dyte), e cila kerkon ndihme financiare prane Bashkise Elbasan, per ti mundesuar ndjekjen e studimeve.
Bazuar ne Ligjin 9355 date 10.03.2005, i ndryshuar, VKM nr. 618 date 07.09.2006, e ndryshuar me VKM nr. 813 date 29.12.2017, Vendimit nr. 3187 date 19.06.2018 te Komisionit Mjeko Ligjor (KMCAP) prane DRSHSSH bazuar ne VKB nr. 162 date 24.12.2018 "Per miratimin e buxhetit te Bashkise Elbasan per vitin 2019"

VENDOSI:

1. Te miratoje trajtimin me burse te plote studenten me aftesi te kufizuar Antoneta Likollari per vitin akademik 2018-2019, sipas mases se percaktuar ne VKM nr. 903 date 21.12.2016 ne shumen 81.000 leke (9.000 leke/muaj, per 9 muaj kohezgjatje te studimeve te nje viti akademik), nga fondi i miratuar ne buxhetin e vitit 2019 ne zerin "Menaxhim i rasteve sociale" ne artikullin 606.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Elbasan dhe Qendra Ekonomike Arsimore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas miratimit ne Keshillin Bashkiak.

Konceptoi : Anjeza Islami
Miratoi : Klajdi Bekteshi
Pranoi : Vesa Liço

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

Zv/KRYETARI

Zheni Gjergji

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Adresa:Bashkia Elbasan,Rr. "Q.Stafa",Tel.+3555452797,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

640/2
31-01-19

2

REPUBLIKA E SHQIPERISE

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 138/1 prot. Elbasan, më 31.1.2019

Lënda: *Konfirmim akti.*

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.13 Datë 24.12.2018, "Për dhënien e bursave nga fondet e bashkisë për studenten me aftësi të kufizuara, Antoneta Nikollari", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

Arkivit!
Origjinali në dosje fotokopje dregtorive përkatese për zbatim!
dt. 31.01.2019

PREFEKTI
Gledian Llatja

REPUBLIKA E SHQIPERISE PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", Tel: 054 252138, www.prefektielbasan.gov.al, prefekti.elbasan@mb.gov.al

(6)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 532 Prot. Elbasan më 23.01.2019

RELACION

Mbi miratimin e Planit te Mbrojtjes Sociale të Bashkisë Elbasan 2018-2020

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Sot po ju paraqesim për miratim Planin e Mbrojtjes Sociale te Bashkisë Elbasan për vitet 2018-2020 .

C'është Plani I Mbrojtjes Sociale ?

Plani i Mbrojtjes Sociale të Bashkisë Elbasan është një dokument i bazuar në një qasje gjithpërfshirëse i cili synon të adresojë nevojat për shërbime sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe llojshmërisë së shërbimeve.

Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile si dhe grupeve në nevojë për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të grupeve dhe komuniteteve të ndryshme dhe mundësive për të adresuar këto nevoja nga aktorë të ndryshëm.

Perse nje Plan i mbrojtjes Sociale ?

Reforma e re administrative-territoriale ka sjellë një sërë ndryshimesh në kompetencat e njësive të qeverisjes vendore si në shtrirje ashtu edhe në krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel lokal.

Në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në nenin 24 përcaktohet se "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale", të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj.[1] Këto funksione dhe përgjegjësi të reja nxjerrin në pah edhe nevojën e një procesi gjithpërfshirës të programimit, planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve sociale në nivel vendorë, duke shtuar këtu edhe zgjerimin e territorit dhe popullatës që Bashkia duhet të mbulojë me shërbime.

Bashkia Elbasan, është qënder e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut me të njëjtin emër. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Elbasan, përfshin nën juridiksionin e saj administrativ, qytetin e Elbasanit dhe 12 komunat, Labinot Mal, Funarë, Labinot Fushë, Bradashesh, Gracen, Shushicë, Papër, Shirgjan , Gjergjan, Gjinar, Tregan dhe Zavalinë.

Popullata rezidente e bashkisë Elbasan, si rrjedhoje e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 80% duke shënuar një numër popullsie rezidente stok në fillim te vitit 2015, prej 147 mijë banorë(sipas censusit) .

Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës dhe mosha mesatare të cilat tregojnë se aktualisht popullata e Bashkisë Elbasan, vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi. Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë, tregon së 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 20% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia, ka potencial të lartë të popullsisë në moshë punë që mund të jetë ekonomikisht aktive

Ne kete kontekst planifikimi është një komponent shumë i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të programeve dhe strategjive dhe Plani Social tenton të ofrojë një panoramë sa më të plotë se deri në çfarë mase, shërbimet që aktualisht parashikohen në shportën e shërbimeve sociale ofrohen ose mbulohen financiarisht aktualisht dhe në të ardhmen nga Pushteti Vendor.

Si u realizua Plani I mbrojtjes Sociale

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij dokumenti zbaton një qasje meta-analitike të kombinuar me një proces me pjesëmarrje.Sa I perket pjeses analitike , ekspertët u mbështetën: së pari, në takime me grupe të fokusuara me specialistet e shërbimeve sociale dhe ato të planifikimit të buxhetit në Bashkinë Elbasan. Së dyti, ekspertët kanë konsultuar, një sërë dokumentash, siç janë planet e zhvillimit, planet buxhetore vjetore dhe ato afatmesme, për të vlerësuar nëse problemet sociale janë në fokusin e politikave sociale lokale si dhe parashikimet buxhetore për realizimin e këtyre politikave

Përveç kësaj, procesi me pjesëmarrjen e punonjësve të bashkisë bëri të mundur që nëpërmjet grupeve të fokusuara me specialistë të sektorëve përkatës (shërbime sociale dhe buxhetit-financës) të merreshin të dhëna specifike mbi shërbimet që ofron Bashkia Elbasan.

Ne terma konkrete, ky plan u fokusua në:

- Vlerësimin e kapaciteteve lokale të Bashkisë Elbasan për të ofruar Shërbime Sociale;
- Identifikimin e kuadrit ligjor, i cili rregullon Shërbimet Sociale në vijim te reformës teritoriale duke identifikuar normativën për secilin target grup në nevojë që është kompetencë e Bashkive për t'u ofruar Shërbime;
- Vlerësimin e kapaciteteve institucionale, materiale, financiare dhe njerëzore të pushtetit vendor, për të ofruar këto shërbime, të cilat do të adresojnë nevojat e këtij komuniteti;
- Ofrimin e një hartëzimi të territorit të Bashksë Elbasan;

- Ofrimin e një modeli për hartimin e Planeve Sociale për Bashkinë Elbasan në nivel aktivitetesh dhe buxhetimi të shërbimeve sociale.

Volumi më i madh i punës së këtij plani është kryer nga vetë stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të Bashkisë, ku nuk mungon edhe analiza demografike dhe territoriale e situatës së Bashkisë Elbasan për tu fokusuar më tej në shërbimet që ofrohen për fëmijët, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit si edhe komuniteti Rom dhe Egjiptian.

Plani i Mbrojtjes Sociale është realizuar nga Bashkia Elbasan me mbështetjen teknike të Fondacionit "Ndihmë për Fëmijët" dhe mbështetjen financiare të UNICEF Shqipëri.

Miratimi nga ana juaj e Planit të Mbrojtjes Sociale 2018-2020 e bën Bashkinë Elbasan poseduese zyrtare të këtij dokumenti shumë të rëndësishëm si dhe krijon mundësitë për zbatimin e tij në bashkëpunim me aktorë, institucione dhe donator të ndryshëm.

Duke ju falenderuar !

Konceptoi:	P/Sek.N.Ekonomike	M.Duka
	P/Sek.Mbr.Femijeve	N.Kreka
	P/Sek.Shtresave nevoje	E.Kolla
	Juriste	I. Hoxholli
Miratoi:	Dr. Sh.K.S.K.	Sh. Lika
Konfirmoi:	Zv/Kryetar	E. Saraci

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

Aulona Bylykbashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr._____ Prot. Elbasan më .01.2019

PROJEKT - VENDIM
Nr. ___ datë____/01/ 2019

Mbi miratimin e Planit te Mbrojtjes Sociale të Bashkise Elbasan 2018-2020

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/01/2019 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 36 të ligjit nr. 121/2016, datë 24.12.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqërore ne RSh",

VENDOSI

I. Të miratojë Planin e Mbrojtjes Sociale te Bashkise Elbasan 2018-2020.
II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.
III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori K.Social Sh.Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxhet M . Beluli
Drejtori Finances A.Merkja

Sekretari Këshillit Bashkiak **Kryetari I Këshillit Bashkiak**

Klajd GRIPSHI **Altin IDRIZI**

313

26.2.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1501 Prot

Elbasan më 25 /02/ 2019

VENDIM

Nr. 14 datë 25 02.2019

Për propozimin e dhënies së ndihmës ekonomike për muajin SHKURT 2019

Bazuar në nenin 29 të ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, në nenin 6 të kreut II të V.K.M nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" si dhe Udhëzimi nr. 3 datë 17.2.2017 "Mbi zbatimin e VKM nr. 955, datë 7.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar,

VENDOSI

Të propozojë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan të përfitojnë nga aplikimi:

1. Kanë aplikuar për ndihmë ekonomike **6058** familje, me një fond mujor _____ lekë,
2. Individë me statusin e Jetimit **15** persona, me një fond **45000** lekë,
3. Individë viktima të trafikimit **1** persona, me një fond **3000** lekë,
4. Individë viktima të dhunës në familje **39** persona, me një fond **117000** lekë,
5. Individë prindër të fëmijëve të lindur:
   a. Trinjakë **1** familje, me një fond **9000** lekë;
   b. Katërnjakë **0** familje, me një fond **0** lekë;
   c. Pesënjakë e më shumë njëherësh **0** familje, me një fond **0** lekë
6. Fëmijë në kujdestari të një familje kujdestare **9** aplikime, me një fond **81000** lekë,
7. Kompesim per dhenien e energjise elektrike **2925** familje.

Drejtori K. Social Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori i Buxhetit E. Beluli
Drejtori i Financës A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Altin Idrizi

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

1501/2
07.03.19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr.Prot 313/1 **Elbasan, më** 28.2.**2019**

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.14 dt.25.02.2019 "Për propozimin e dhënies së ndihmës ekonomike për muajin Shkurt 2019 ", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Gledian LLATJA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Eva Bica

Lagja:Brig."17.Sulmuese",Rruga " Qemal Stafa " E-mail : prefekturaelbasan@yahoo.com Tel.:054 26 21 38, Fax:. 054 25 24 46

314

20.2.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1502/1 Prot Elbasan më 25 /02/2019

VENDIM

Nr 15 datë 25 /02/2019.

Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë, për muajin SHKURT 2019

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21, 34, 29 pika 9 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"(i ndryshuar), V.K.M nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" të Udhëzimit nr. 4 datë 17.02.2017 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar të M.M.S.R si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 49 datë 19.05.2017

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHKURT 85 familje me fond 300.000 lekë.
2. Masa e pagesës për familjet përfituese të jetë sipas VKM nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" pika 13, dhe udhëzimit nr.4 datë 17.2.2017 të MMSR të ndryshuar.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Sh. K. Soc Komunit Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Financës A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Altin Idrizi

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

1502/2
07.03.19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr.Prot 3141 **Elbasan, më** 28.2.**2019**

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.15 dt.25.02.2019 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë , për muajin Shkurt 2019 ", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Gledian LLATJA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Eva Bica

Lagja:Brig."17.Sulmuese",Rruga " Qemal Stafa " E-mail : prefekturaelbasan@yahoo.com Tel.:054 26 21 38, Fax:. 054 25 24 46

315
26.2.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1503/1 Prot

Elbasan më 25 /02/ 2019

VENDIM
Nr. 16 datë 25 /02/2019

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHKURT 2019

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 29 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, V.K.M nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", Udhëzimeve nr. 3, 4 dhe 5 datë 17.2.2017, "Mbi zbatimin e vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuara të M.M.S.R si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 50 datë 19.05.2017

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **SHKURT 2019** gjithsej 180 familje me një fond prej 500.000 lekë.
2. Masa e pagesës për familjet përfituese të jetë sipas V.K.M nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve,të procedurave,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" pika 13 dhe të udhëzimeve nr 3,4 dhe 5 datë 17.02.2017 te ndryshuar të M.M.S.R
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Altin Idrizi

1503/2
07.08.19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr.Prot 315/1 **Elbasan, më** 28.2.**2019**

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.16 dt.25.02.2019 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2019 ", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Gledian LLATJA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Eva Bica

Lagja:Brig."17.Sulmuese",Rruga " Qemal Stafa " E-mail : prefekturaelbasan@yahoo.com Tel.:054 26 21 38, Fax:. 054 25 24 46

316

26.2.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr.1504 prot.

Elbasan më 25 .02. 2019

VENDIM
Nr. 17 datë 25 /02/2019

Mbi dhënien e Pagesave për aftësinë e kufizuar për muajin SHKURT 2019

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 7 dhe neni 29 pika 2 të ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar; V.K.M nr. 618 datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar; Udhëzim nr. 626, datë 27.8.2018 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar"; ligjin nr. 8089, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit"i ndryshuar, VKM nr. 277 datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit" Udhëzimin nr. 627 datë 27.08.2018 ''Mbi zbatimin e Vendimit Nr 277 te Këshillit te Ministrave Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit", i ndryshuar ; Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", V.K.M nr. 31 datë 20.01.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar; Udhezimin nr. 625 date 27.08.2018 "Mbi zbatimin e Vendimit Nr.31 datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave ''Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar ;V.K.M nr. 869 datë 18.06.2008 "Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit",

VENDOSI

1. Të përfitojnë pagesë paaftësie për muajin SHKURT 2019 në total 6599 persona me fond 84.921.161 lekë, të ndarë në :

- Persona të paaftë 4559 persona
- Kujdestarë paaftësi 609 persona
- Të verbër 687 persona ;
- Kujdestarë verbërie 140 persona ;
- Para/tetraplegji 303 persona ;
- Kujdestarë p/tetraplegj 301 persona

2. Përfitojnë pagesë për shkak invaliditeti në punë për muajin SHKURT 2019, në total 5671 persona me fond 19.369.200 lekë.
3. Kompesim për energjinë elektrike 809 persona me fond 2.179.676 leke.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar dhe Drejtoria e Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:

Dr.Sh. K.S.Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxhetit M . Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Altin Idrizi

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

1304/2
04.03.19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr.Prot 316/1 **Elbasan, më** 28.2.**2019**

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.17 dt.25.02.2019 "Mbi dhënien e pagesave për aftësinë e kufizuar për muajin Shkurt 2019 ", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Gledian LLATJA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Eva Bica

Lagja:Brig."17.Sulmuese",Rruga " Qemal Stafa " E-mail : prefekturaelbasan@yahoo.com Tel.:054 26 21 38, Fax:. 054 25 24 46

317

26.2.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1505/1 Prot. Elbasan më 25.02.2019

VENDIM
Nr. 18 datë 25 /02/ 2019

Mbi miratimin e Planit te Mbrojtjes Sociale të Bashkise Elbasan 2018-2022

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/02/2019 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 36 të ligjit nr. 121/2016, datë 24.12.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqërore ne RSh",

VENDOSI

I. Të miratojë Planin e Mbrojtjes Sociale te Bashkise Elbasan 2018-2022.

II.Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.

II.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori K.Social Sh.Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxhet M . Beluli
Drejtori Finances A.Merkja

Sekretari Këshillit Bashkiak

Klajd GRIPSHI

Kryetari I Këshillit Bashkiak

Altin IDRIZI

PLANI I MBROJTJES SOCIALE
BASHKIA ELBASAN
2018-2022

Realizuar nga Bashkia Elbasan me mbeshtetjen teknike te Fondacionit "Ndihme per Femijet" dhe mbeshtetjen financiare te UNICEF Shqiperi.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE 4
1.1 PARASHTRIMI I PROBLEMIT 5
1.2 METODOLOGJIA 6
2. SITUATA E IDENTIFIKUAR NË BASHKINË ELBASAN 7
3. KËNDVËSHTRIMI LEGJISLATIV DHE REFORMA E DECENTRALIZIMIT
3.1 Strategjia Kombëtare E Mbrojtjes Sociale 2015-2020 11
3.2 Ligji Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë14.12.2015 12
3.3 Plani Strategjik dhe Vjetor për Veprimtarinë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror Viti 2015-2019 13
3.4 Urdhri i Punonjësit Social 13
3.5 Programi i Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror 15
3.6 Aspekte Ligjore sipas Target Grupeve: 15
3.6.1 Personat me Aftësi të Kufizuar 15
3.6.2 Fëmjët 16
3.7 Pakti Social 17
3.8 Urdhri i Psikologut 18

4. 4. NEVOJAT LOKALE PËR ZBATIMIN E PLANIT SOCIAL 21

4.1 Organizimi strukturor i nevojshëm i drejtorisë së shërbimit të kujdesit social dhe komunitar 21
4.2 Shporta e Shërbimeve Shoqërore 25
4.3 Përshkrimi i funksioneve dhe kompetencave: 26
4.3.1.Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore 26
4.3.2 Sektori i Shtresave në Nevojë dhe Moshës së Tretë 29
4.3.3 Sektori i Mbrojtes Sociale , PAK dhe Ndihmës Ekonomike 30
4.4 Shpërndarja territoriale e shërbimeve sociale: 32
4.4.1 Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Elbasan 32
4.4.2 Shërbimet e përkujdesit Social per Vitin 2016 sipas kategorive 35
4.5 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime 49
4.6 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve 50
4. 7 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesjes sociale në Bashkinë Elbasan 51

5. MATRICA E AKTIVITETE TË PLANIT SOCIAL PËR BASHKINË E ELBASANIT 56

Ankeks: **PLAN BUXHETI PËR BASHKINË ELBASAN**

LISTA E SHKURIMEVE

BE Bashkia Elbasan
NjMF Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
VKM Vendim i Këshillit të Ministrave
EU Bashkimi Europian
ILO-IPEC Organizata Botërore e Punës, Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve
IPA Instrumenti i para antaresimit
INSTAT Instituti i Statistikave
GIZ Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
LSMS Studimi mbi Matjen e Nivelit të Jetesës
OZhM Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
MASh Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
MPCSSHB Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
NGO Organizata Jo-qeveritare
NPO Organizata Jo-fitimprurëse
OSBE Organizata Sigurimit dhe Bashkëpunimit Europian
QKL Qendra Kombëtare e Licensimit
RC Këshilli i Qarkut
RATC Komiteti Rajonal Antitrafikimi
SSS Shërbimi Social Shteteror
StC Save the Children
SDC Koperacioni Zviceran per Zhvillim
TSC Sekretariati Teknik për Fëmijet
TdH Terres des Homes
UNICEF Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNDP Programi i Kombeve te Bashkuara per Zhvillim
USAID Ndihma e ShBA-ve për Shqipërinë
VET Trajnim dhe Formim Profesional
WB Banka Botërore
ËFLC Format e Këqija të Punës së Fëmijëve

1. HYRJE

Gjatë dekadës së fundit shoqëria dhe qeveria shqiptare kanë treguar interesim në rritje ndaj ofrimit të shërbimeve sociale në nivel vendor, interesim, i cili është shprehuar me hartimin e politikave, nismave ligjore, zbatimin e programeve dhe projekteve për rritjen e numrit të shërbimeve, përmirësimit të kushteve të banimit të grupeve në nevojë si dhe përmirësimit të infrastrukturës së zonave rurale. Këto projekte janë iniciuar dhe mbështetur në pjesën më të madhe nga partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat e huaja. Kështu pas vitit 1990, institucionet ndërkombëtare siç janë Këshilli i Europës, OSBE, agjenci të ndryshme të OKB-së janë angazhuar në përmirësimin e kushteve të jetesës të target grupeve të ndryshme në nevojë, për barazinë gjinore, shërbimet për fëmijët dhe moshën e tretë, komuniteti Rom dhe Egjyptian etj.

Ky plan parashtron si dokument reference Strategjinë Kombëtare per Mrojtjen Sociale 2015-2020, e cila bazohet në tre shtylla kryesore:

> *A.Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, përmirësimin e shenjëstrimit të tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndihmës Ekonomike, si dhe lidhjen me shërbime të integruara dhe skemat e punësimit, me qëllim riintegrimin social të tyre.*
>
> *B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në Cash me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.*
>
> *C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale, si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes se plotë dhe efektive në shoqëri.*

Kjo Stategji dhe Ligji i ri për shërbimet sociale bazohen në parimet bazë të konventave botërore:

- Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi: Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.

- Mbrojtja: Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.

- E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit: Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.

- Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve: Individët janë përgjegjës për jetën e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.

- Përfshirja dhe integrimi:Respektimi i të drejtave dhe nevojave.

- Partneriteti: koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.

- Cilësia e shërbimeve: Standardet Kombëtare udhëheqin vendim-marrjen në nivel vendor.

Vlerësimi i nevojave për shërbime sociale dhe i kapaciteteve të institucioneve vendore për të adresuar këto parime duke ju referuar nevojave dhe specifikave lokale mori në shqyrtim një spektër të gjerë të shërbimeve, kapacitetet njerëzore, financiare dhe institucionale të bashkisë Elbasan për të ofruar këto shërbime sot dhe në të ardhmen si dhe ofron rekomandime në fushat e nevojshme për ndërhyrje.

Hendeku ndërmjet nevojave për shërbime sociale dhe sistemi aktual i shërbimeve publike në nivel vendor është i njohur. Aktualisht ky hendek mbulohet deri në një farë shkalle nga organizatat jo-fitimprurese (OJF-të), operatorët privatë që ofrojnë shërbime sociale dhe organizatat fetare, të cilët të mbështetura nga organizmat ndërkombëtare dhe në një masë më të vogël nga buxheti i shtetit, ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë.

Plani Social tenton të ofrojë një panramë sa më të plotë se deri në çfarë mase, shërbimet që aktualisht parashikohen në shportën e shërbimeve sociale ofrohen dhe/ ose mbulohen financiarisht aktualisht dhe/ ose në të ardhmen nga Pushteti Vendor. Për realizimin e kësaj detyre, ekspertët u mbështetën: së pari, në takime me grupe të fokusuara me specialistet e shërbimeve sociale dhe ato të planifikimit të buxhetit në Bashkinë Elbsan. Së dyti, ekspertët kanë konsultuar, një sërë dokumentash, siç janë planet e zhvillimit, planet buxhetore vjetore dhe ato afatmesme, për të vlerësuar nëse problemet sociale janë në fokusin e politikave sociale lokale si dhe parashikimet buxhetore për realizimin e këtyre politikave.

1.1 Parashtrimi i problemit

Ndërsa Qeveria shqiptare ka rritur përpjekjet e saj për të zhvilluar politika kombëtare në lidhje me adresimin e problemeve sociale, implementimi i tyre në terren dhe veçanërisht angazhimi i pushtetit vendor në ofrimin e shërbimeve ka mbetur pas. Veç kësaj anagazhimi i partnerëve ndërkombëtarë dhe organizatave që veprojnë në këtë fushë, nuk po ndiqet me të njëjtin ritëm nga pushteti vendor dhe organizatat vendore përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve të përshtatshme për këtë komunitet.

Pikërisht hendeku ndërmjet hartimit të politikave dhe kthimit të tyre në aksione konkrete në terren përfshirë këtu edhe mungesën e mjeteve monetare përbëjnë dhe problemin kryesor, të cilin duam ta fokusojmë në mënyrë specifike për bashkinë Elbasan.

Vlerësimi i kapaciteteve institucionele të pushtetit vendor në ofrimin e shërbimeve sociale, fokuson tre pyetje të një interesi të veçantë:

1. Në ç'mënyrë janë strukturuar institucionet lokale; si janë hartuar politikat lokale, dhe sa janë funksionale procedurat për të adresuar problemet ekonomike e sociale në Bashkinë Elbasan? Sa të përfshira kanë qenë strukturat e pushtetit vendor në shërbimet e ofruara duke ju referuar shportës së shërbimeve sociale?

2. Sa janë përfshirë kërkesat e komunitetit në planet e punës të bashkive; në programet politike të pushtetit vendor? Nga ana tjetër sa janë përfshirë vetë qytetarët në hartimin e politikave sociale vendore?

3. Çfarë vendimesh, standardesh, marrëveshje ndërmjet organizatave (publike dhe jo-publike), ose dokumenta të tjerë janë funksional? Cilat janë ndryshimet e pritëshme lidhur me buxhetet, kuadrin ligjor dhe qasjet që aplikojnë bashkitë ndaj këtyre problemeve?

1.2 Metodologjia

Nisur nga çështjet dhe pyetjet e mësiperme, ky plan do të fokusohet në:

- Vlerësimin e kapaciteteve lokale të Bashkisë Elbasan për të ofruar Shërbime Sociale;
- Do të identifikojë kuadrin ligjor, i cili rregullon Shërbimet Sociale në vijim te reformës teritoriale duke identifikuar normativën për secilin target grup në nevojë që është kompetencë e Bashkive për t'u ofruar Shërbime;
- Vlerësimin e kapaciteteve institucionale, materiale, financiare dhe njerëzore të pushtetit vendor, për të ofruar këto shërbime, të cilat do të adresojnë nevojat e këtij komuniteti;
- Ofrimin e një hartëzimi të territorit të Bashksë Elbasan;
- Ofrimin e një modeli për hartimin e Planeve Sociale për Bashkinë Elbasan në nivel aktivitetesh dhe buxhetimi të shërbimeve sociale.

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij dokumenti zbaton një qasje meta-analitike të kombinuar me një proces me pjesëmarrje. Qasja meta-analitike bën të mundur analizën, sintezën dhe nxjerrjen e përfundimeve nga dokumentat ekzistues, siç janë: planet e zhvillimit të bashkive respektive, planet buxhetore afatmesme, profili social i bashkive etj. Gjithashtu është marrë në konsideratë, dokumentacioni i vënë në dispozicion nga NPF, me informacion të mbledhur dhe përpunuar gjatë kohës që kjo organizatë ka ofruar shërbime për Bashkinë Elbsan, si dhe dokumentacion ndihmës i ofruar nga organizata të tjera, të cilat kanë të njëjtin fokus.

Përveç kësaj, procesi me pjesëmarrjen e punonjësve të bashkiisë bëri të mundur që nëpërmjet grupeve të fokusuara me specialistë të sektorëve përkatës (shërbime sociale dhe buxhetit-financës) të merreshin të dhëna specifike mbi shërbimet që ofron Bashkia Elbasan

Gjithashtu u zhvilluan konsultime edhe me përfaqësues të organizatave të tjera, të cilat veprojnë në Bashkinë Elbasan, me fokus ofrimin e shërbimeve sociale për target grupe të ndryshëm. Në mënyrë të hollësishme, përgatitja e këtij raporti ndoqi veprimet si më poshtë:

o Një vështrim i plotë i politikave vendore lidhur me shpërndarjen e shërbimeve sociale,

o Nje inventar i shërbimeve të ofruara nga Fondacionit NPF dhe shoqata që ofrojnë shërbime sociale në Bashkinë Elbasan,

- Të dhënat e Bashkisë Elbasan për shërbimet sociale dhe kategoritë e targetuara,
- Konsultime me strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve sociale,
- Konsultime me strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vendor,
- Konsultimet me drejtuesit e projektit dhe koordinatorët,
- Intervistë me përfaqësues të këshilit bashkiak,
- Intervista me përfaqësuesit e organizatave të tjera që ofrojnë shërbime për komunitetin.

Metodologjia është hartuar duke marrë në konsideratë Bashkinë Elbasan si njësi më vete me specifikat e nevojave për shërbime sociale, si dhe me specifikat për zhvillimin e shërbimeve në të ardhmen. Metodologjia ka parashikuar gjithashtu marrjen e të dhënave sasiore për secilin target grup dhe sherbime sociale që ofrohen.

2. SITUATA E IDENTIFIKUAR NË BASHKINË ELBASAN

Në këtë pjesë të dokumentit, ne nuk marrim përsipër të bëjmë një studim të situatës sociale për Bashkinë Elbsan. Në këtë pjesë theksohen problemet e identifikuara në bashkinë Elbasan gjatë takimeve me përfaqësuesit e shërbimeve sociale.

Bashkia Elbasan, është qëndra me e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut me të njëjtin emër. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Elbasan, përfshin nën juridiksionin e saj administrativ, qytetin e Elbasanit dhe 12 komunat, Labinot Mal, Funarë, Labinot fushë, Bradashesh, Gracen, Shushicë, Papër, Shirgjan , Gjergjan, Gjinar, Tregan dhe Zavalin.

Popullata rezidente e bashkisë Elbasan, si rrjedhoje e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 80% duke shënuar një numër popullsie rezidente stok në fillim te vitit 2015, prej 147 mijë banorë .

Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës dhe mosha mesatare të cilat tregojnë se aktualisht popullata e Bashkisë Elbasan, vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi. Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë, tregon së 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 20% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku, ka potencial të lartë të popullsisë në moshë punë që mund të jetë ekonomikisht aktive

Table 1: Populisia rezidente, sipas grup-moshave

Populisia, qarku, bashkia, komunat	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsëj	0-14	15-64	65+	Gjithsëj	0-14	15-64	65+
Bashkia Elbasan	147,037	30,001	101,841	15,195	144,382	29,459	100,002	14,921
Elbasan	81,659	15,235	57,621	8,804	80,185	14,959	56,581	8,645
1. Labinot Mal	5,490	1,473	3,466	550	5,391	1,447	3,404	540
2. Funare	2,202	409	1,501	292	2,162	401	1,474	286
3. Labinot Fushë	7,323	1,916	4,825	582	7,191	1,882	4,738	572
4. Bradashesh	11,102	2,426	7,706	970	10,901	2,382	7,567	953
5. Gracen	2,274	529	1,494	251	2,233	520	1,467	247
6. Shushicë	9,059	2,214	6,024	821	8,895	2,174	5,915	806
7. Papër	6,586	1,490	4,466	631	6,468	1,463	4,385	619
8. Shirgjan	7,581	1,646	5,166	770	7,445	1,616	5,073	756
9. Gjergjan	5,319	988	3,789	542	5,223	970	3,721	532
10. Gjinar	3,609	675	2,511	422	3,543	663	2,466	415
11. Tregan	3,150	664	2,159	327	3,093	652	2,120	321
12. Zavalinë	1,683	336	1,112	234	1,653	330	1,092	230
Qarku Elbasan	**306,939**	**64,755**	**210,885**	**31,299**	**301,397**	**63,586**	**207,077**	**30,734**

Burimi:të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, NjA

Ekonomia e Bashkisë Elbasan ndahet mes shërbimeve, tregtisë dhe industrisë në qytet dhe bujqësisë e blegtorisë në zonat rurale. Statistika zyrtare tregojnë se në pjesën urbane 45 % e ndërrmarrjeve ekonomike i perkasin sektorit të tregtisë, 41 % sektorit të shërbimeve, 11 % industrisë dhe 3 % ndërtimit. Bujqësia është e përqëndruar në pjesën e territorit të fshatrave të Bashkisë.

Niveli i ulët arsimor, varfëria dhe papunësia, kushtet e këqija të jetesës dhe shërbimi shëndetësor i pamjaftueshëm janë problemet kryesore të adresuara edhe nga dokumentat strategjikë.

Arsimimi është një segment i rëndësishëm, që ndikon në mirëqënien e populisisë në Bashkinë Elbasan. Mungesa e arsimit sidomos për komunitet Rome dhe Egjiptiane përveçse kufizon punësimin është një pengesë serioze për familjet rome në përfitimin e të drejtave që sigurohen nga ligji. Shumë nga fëmijët rom, kur nisin klasën e parë nuk dinë gjuhën shqipe, gjë e cila krijon vështirësi në ecurinë e tyre në

shkollë. Edukimi parashkollor dhe disa shërbime arsimore shtesë është një nga masat që duhet të merren për të paraprirë ecurinë e tyre normale në shkollë. Braktisja e shkollës është një fenomen i përhapur ndër fëmijët rom dhe egjiptianë. Studimet tregojnë se arsyet më të shpeshta për braktisjen e shkollës nga fëmijët rom janë puna dhe niveli i ulët arsimor i prindërve. Kufizimet në gjuhën shqipe dhe martesat në mosha të vogla, niveli shumë i ulët arsimor i prindërve ndikon gjithashtu në nivelin e ulët arsimor të fëmijëve rom dhe egjyptianë.

Varfëria dhe papunësia. Niveli ekonomik i familjeve rome, është dukshëm më i ulët se ai i familjeve jo rom. Të dhënat e skemës së ndihmës ekonomike (NE) në bashki tregojnë se përqindja e familjeve rome përfituese të ndihmës ekonomike është më e lartë se ajo e familjeve të tjera jo-rome. Faktorët që ndikojnë varfërinë e tyre ekonomike janë: numri i lartë i anëtarëve të familjes, shkalla e lartë e papunësisë, sektorët e punësimit ose të vetëpunësimit të romëve nuk krijojnë të ardhura të mjaftueshme, mënyra e jetesës etj. Si rrjedhojë e mungesës së përgjithshme të punësimit në Shqipëri, për 92% të romëve është e vështirë të gjejnë një punë. Për më tepër ka shumë pak kërkesë për profesionet tradicionale të romëve siç janë punimet me dorë apo profesione të ushtruara nga romët. Me gjithë politikat lehtësuese për t'i krijuar kushte për marrjen e një profesioni, kufizimet arsimore të romëve çojnë edhe në kufizime për të përfituar nga skemat nxitëse të punësimit.

Ndihma ekonomike. Sipas të dhënave të studimit UNICEF2013[1], Elbasani rezulton të jetë një nga bashkitë që e ka nivelin e varfërisë më të ulët, por numrin e përfituesve të ndihmës ekonomike më të lartë, përkatësisht 10.7% e popullsisë në varfëri dhe 13.7% në Ndihmë Ekonomike.

Ndoshta kjo ka bërë që me zbatimin e ligjit të ri për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas sitemit të pikëzimit, për të cilën bashkia Elbasan ka qënë bashki pilot, *"shumë familje janë përjashtuar nga skema dhe kjo për shkak të kritereve tejet strikte, të cialt nuk lejojnë fleksibilitet edhe pse shumë familje janë në varfëri. Pikëzimi në sistemin online trajton njësoj si një familje nga qyteti që nuk ka të ardhura fare ashtu edhe një familje nga fshati që mund të ketë tokë e të merret me blegtori e bujqësi. Sistemi është rixhid dhe shumë familje në varfëri të vërtetë që pas aplikimit të sistemit online kanë mbetur jashtë skemës së ndihmës eknomike. Edhe pse ne e kemi ngritur problemin që ka sjelle sistemi i aplikimit online për ndihmen ekonomike nuk duket të jetë marrë parasysh pasi është quajtur i suksesshem dhe për këtë do fillojë të aplikohet në të gjitha Bashkitë."*, *shprehet Drejtori i Shërbimeve Sociale Elbasan.*

Nga ana tjetër, pikëzimi 'favorizon' familjet me një numër të madh antarësh, duke kushtëzuar në këtë formë familjet e vogla të mbeten shpesh-herë pa përfituar, pavarësisht se nevojat e familjes së vogël mund të jenë më persistente krahasuar me nevojat e familjes së madhe. Ky është një aspekt që ka shkaktuar diskutime për sa i përket skemës së re të ndihmës ekonomike, pasi mjaft familje që janë në nevojë nuk përfitojnë pikërisht prej këtyre rregullave strikte që janë vendosur për të bërë klasifikimin.

Shërbimet sociale në qëndra. Në Elbasan, rezultojnë 11 qëndra që ofrojnë shërbime të kujdesit social, prej të cilave 10 jo publike dhe një publike[2]. Për sa i përket **qëndrave ditore** dhe për Personat me Aftësi

[1] UNICEF (2013) Shërbimet e përkujdesit social në nivelin rajonal: Analizë dhe rekomandime. Tiranë

të Kufizuara dhe për moshën e tretë, shërbimet që ofrohen në këto qëndra ofrohen nga Qëndra e Autizmit, e cila varet direkte nga Qarku; qëndra Balashe, e cila është qëndër ditore për të rriturit me Aftsi të Kufizuar; qëndra ditore për fëmijët me Aftësi të kufizuara, si edhe qëndra për moshën e tretë, në të cilën 80 të moshuar marrin shërbimin në qëndër, ndërsa 50 të tjerë marrin shërbimin në shtëpi, shërbim ky i fundit që përfshin 1 vakt ushqimor, aktivitete rekreative dhe shërbim lavanterie. Qëndra Balashe, sipas asaj që kryetari ka deklaruar, do të zgjerojë shërbimin e saj në ndihmë të të moshuarve. *"Do të ofrohet shumë shpejt Brenda muajit Tetor shërbimi rezidencial për të moshuar ku do të vendosen në dispozicion 4-shtretër."*

Shoqatë tjetër, që ofron shërbime të përkujdesit social është edhe shoqata A2B, e cila ka një **qëndër ditore për moshë e tretë**, ku ofron një vakt ushqimor dhe aktivitete sociale e rekreative. Nuk ka informacion se sa të moshuarve u shërben kjo qëndër dhe cila është përbërja profesionale e stafit që ofron shërbimet.

Shërbimet që adresojnë nevojat e grupeve vulnerable, sikurse janë viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, mbulohen nga dy organizata jofitimprurëse, Forumi i Gruas dhe Tjetër Vizion, të cilat ofrojnë **strehëza për gratë dhe fëmijët**. Tjetër Vizion është një shoqatë e njohur dhe licensuar nga Ministria e Mirëqnies Sociale dhe Rinisë dhe njihet për kontributin që jep në lidhje më këtë kategori që synon t'i ofrojë shërbime.

Banesat sociale janë shpërndarë të gjitha dhe për këtë arësye Drejtoria e strehimit nuk ka më banesa sociale në dispozicion për vitin 2016. Meqënëse këto banesa sociale i ka pasur drejtoria e strehimit, që koordinohet me drejtorinë e shërbimt social për trajtimin e rasteve të veccanta, 96 banesa prej tyre janë shpërndarë që para dy vitesh, por kriteri për të pasur një minimum të ardhurash përjashtoi familjet e regjistruara tek programi i ndihmës ekonomike. Për ta balancuar paksa këtë situatë, është ofruar bonusi social ku 50% të qerasë e paguan Bashkia dhe ka familje të varfëra të cilat mund të aplikojnë dhe të përfitojnë.

Buxheti i shërbimeve sociale. Shërbimet Sociale, shpesh herë ndodh që të mos jenë prioritet i politikave qeverisëse dhe kjo shprehet nga buxheti i kufizuar që iu vihet në dispozicion, megjithatë në rastin e Bashkisë Elbasan mund të thuhet se ka një rritje në buxhet për sa i përket shërbimeve sociale dhe kjo rritje është vjetore, megjithëse nuk është shumë e madhe. Ndryshimet në Ligjin e Buxhetit, i kanë deleguar bashkive kompetenca të reja dhe fleksibillitet sa i përket menaxhimit të fondeve sipas nevojave, por për shkak se nuk është miratuar ende si ligj, veprohet me ligjin e vjetër, që do të thotë se bashkia është e limituar në përdorimin e fondeve për nevojat e shërbimeve që ka.

[2], UNICEF (2014). Ri-shkallëzimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për nivelet e qeverisjes vendore - propozim për përgjegjësitë dhe funksionet e njësive të qeverisjes vendore. Tiranë.

3. KËNDVËSHTRIMI LEGJISLATIV DHE REFORMA E DECENTRALIZIMIT

3.1 STRATEGJIA KOMBËTARE E MBROJTJES SOCIALE 2015-2020

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015–2020 është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1071, datë 23.12.2015[3].

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 është e ndërtuar mbi parimet që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa për të Drejtën e personave me Aftësi të Kufizuara, Karta Sociale Evropiane e rishikuar, Karta Evropiane e Autonomisë Lokale, Komunikata e Komisionit Evropian datë 12 Mars 1997 "Mbi modernizimin dhe përmirësimin e Mbrojtjes Shoqërore", Strategjinë Evropiane deri në 2020.

E drejta për mbrojtjen sociale është reflektuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë[4]. Neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore njeh të drejtën e secilit për të pasur mbrojtje sociale. Në mënyrë të ngjashme, në Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara njohin gjithashtu të drejtat e veçanta për mbrojtjen sociale. Zbatimi i suksesshëm i kësaj strategjie do të kontribuojë në përforcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Strategjia ka synimin të shërbejë si bazë për dialog të mëtejshëm të strukturuar me Bashkimin Evropian (BE), agjencitë ndërkombëtare dhe partnerët socialë mbi çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes sociale. Një qëllim i rëndësishëm është përputhja me Axhendën Sociale të BE 2020, duke ndihmuar vendin në arritjen e synimeve të saj për integrimin në BE. Programet Parandaluese dhe të Riintegrimit Social të alternuar me skemat e punësimit do të konvergojnë me konceptet të cilat po përshtaten aktualisht nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në vitin 2020 mirëqenia e përgjithshme e popullsisë do të jetë përmirësuar, varfëria dhe përjashtimi social do të jenë zbutur, nëpërmjet realizimit të qëllimeve dhe objektivave strategjike të shtjelluara në këtë strategji ndërsektoriale. Me një vizion të qartë për ndërtimin e një sistemi mbrojtjeje sociale që të luftojë pabarazitë social-ekonomike, parashikimi i një sistemi që ka politikat dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët ne nevojë, ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegrimit social alternuar me skemat e punësimit, Strategjia e Mbrojtjes Sociale bazohet në politikat për:

- Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë,
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara,
- Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social.

Kj strategji përbën një nga dokumentat themeltar për hartimin e Planeve Sociale në nivel vendor.

[3] Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 139, datë 07.01.2016, faqe 16304.

[4] Neni 52 pika 2 e Kushtetutës së republikës së Shqipërisëpërcakton: "Çdo person që për arsye të mos dëshirës së tij/saj humbet punën dhe nuk ka mjete të tjera mbështetjeje, ka të drejtën për ndihmë sociale, sipas kushteve që parashikon ligji".

3.2 PROJEKTLIGJI PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Objektivi i projektligjit[5] është rregullimi dhe ofrimi i shërbimeve sociale në atë mënyrë që të mundësojnë zbulimin në kohë të nevojave të përfituesve dhe ofrimin e atyre shërbimeve që ndihmojnë në parandalimin dhe zhvillimin e kushteve apo situatave kërcënuese që prekin grupet në nevojë. "Projektligji gjithashtu synon identifikimin dhe përcaktimin e të gjithë grupeve në nevojë dhe parashikimin e shërbimeve për ta duke përcaktuar parimet, gamën e përfitimeve dhe lehtësirave, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar nga skema e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si edhe procedurat e kërkimit dhe përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror", thuhet në relacionin për projektligjin "Për Shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

Risi në këtë projektligj janë edhe shërbimet parandaluese, të këshillimit si dhe shërbimet me telefon, on line ose të emergjencës. Sa i takon përfituesve, me miratimin e ligjit të ri lista dhe shpërndarja e parave do të bëhet me vendim të këshillit bashkiak. Për tu theksuar është edhe fakti që në këtë draft parashikohen qartë kategoritë e përdoruesve të shërbimeve sipas nevojës dhe llojit të shërbimit. "Të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror do ta kenë individë ose familje të cilët nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera. Sipas këtij projektligji, shërbimet shoqërore mbulojnë të gjithë kategoritë e personave, të cilët janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre bazë të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak rrethanave të pafavorshme personale, ekonomike e sociale".

Ligji përcakton edhe ngritjen e Fondit Social pranë çdo bashkie në të njëjtën linjë, ndërsa Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinis bën parashikimin e buxhetit, fond që më pas i transferohet organeve të qeverisjes vendore për shpërndarje. Shërbimet shoqërore përfitojnë financim vetëm nëse ato kanë një marrëveshje tripalëshe me Shërbimin Social Shtetëror dhe njësinë e qeverisjes vendore ku ofrojnë shërbimin.

Projektligji detajon dhe klasifikon të gjitha rolet dhe funksionet që do të kenë institucionet në nivel qendor dhe vendor në ofrimin e shërbimeve shoqërore. Një risi absolute është ngritja e sektorëve të vlerësimit të nevojave dhe referimit (SVNR) në çdo komunitet. SVNR është një mekanizëm që kujdeset për futjen e përfituesve në sistem, në mbështetje të objektivit strategjik të largimit nga përdorimi i kujdesit rezidencial. Gjithashtu,pranëçdo bashkie do të ngrihet një drejtori e dedikuar për shërbimet shoqërore, si njësi më vete brenda strukturës së bashkisë.Në këtë mënyrë, zgjidhet situata e zvarritjes së përfituesve në zyrat e administratës, qendrore apo lokale, sepse tashmë kanë një adresë të qartë ku mund të drejtohen.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e skemës së shërbimeve shoqërore janë:

[5]Projektligj i miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, datë 3 Gusht 2016.

Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe institucionet e saj të varësisë (SHSSH, Inspektorati Shtetëror i Shërbimeve); Këshilli i Qarkut; Bashkia.

3.3 PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR PËR VEPRIMTARINË E SEKTORIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR VITI 2015-2019

Nga Shërbimi Social Shtetëror alokohen fonde buxhetore për veprimtarinë e 17 Institucioneve publike të përkujdesit shoqëror që ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë, dhe menaxhohen në nivel lokal, subjekte në varësi të Bashkive.

Plani Strategjik për auditimin e brendshëm hartohet për të siguruar që asnjë nga departamentet e Drejtorisë së Përgjithshme, njësitë, institucionet vartëse ose departamente operacionale pune, fusha të caktuara etj.,të mbetet jashtë vëmendjes së auditimit.

Plani strategjik i auditimit identifikon fushat për t'u audituar gjatë një periudhe kohe 2 deri në 5 vjet, duke zhvilluar një mënyrë gjykimi sipas prioriteteve, të cilat përcaktohen pas një proçesi të gjatë të vlerësimit të riskut. Përveç kësaj, ky plan konsideron edhe menaxhimin efektiv të burimeve të auditimit, stafit, kohës së punës dhe kostos së auditimit për një periudhë kohe më të gjatë.Mbulimi me auditim bëhet mbi bazën e risqeve relative, problemeve më prioritare ose më të ekspozuara, bazuar p.sh. mbi rezultatet e auditimeve të mëparshme.

Çdo vit Plani Strategjik duhet analizuar dhe rishikuar duke pasqyruar ndryshime që vijnë nga ndryshimet operacionale, organizative, të buxheteve, të risqeve etj. Këta faktorë duhet të konsiderohen për rishikim vetëm nëse ato janë materiale.

3.4 URDHRI I PUNONJËSIT SOCIAL

Ligj nr. 163/2014 "Për Urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë"[6]ka si objekt rregullimin e organizimit dhe veprimtarisë së Urdhrit të Punonjësve Socialë, si dhe tëmarrëdhënieve juridike dhe etiko-profesionale të punonjësve socialë. Ky ligj e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit dhe zbatohet për të gjithë punonjësit socialë që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë në sistemin publik dhe atë privat.

[6] Botuar në Fletoren Zyrtare n. 198 datë 30 dhjetor 2014

Urdhri i Punonjësve Socialë është ent publik jobuxhetor i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtarinë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut. Misioni i Urdhrit është garantimi dhe ruajtja në vazhdimësi e standardeve dhe praktikave të mira të ushtrimit të profesionit në fushën e punës sociale dhe mbrojtja e publikut nga veprimet joprofesionale dhe joetike të punonjësve socialë.

Për realizimin e misionit të tij, Urdhri i Punonjësve Socialë ushtron këto kompetenca:

a) jep dhe heq të drejtën e ushtrimit individual të profesionit të punonjësit social nëpërmjet dhënies dhe revokimit të licencës profesionale;

b) krijon dhe përditëson regjistra të posaçëm, sipas fushës së veprimtarisë dhe profileve;

c) miraton standarde etike të detyrueshme për punonjësit socialë, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre

në praktikën profesionale;

ç) mbron të drejtat e anëtarëve të urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre, si dhe pavarësinë e ushtrimit të profesionit;

d) nxit në vazhdimësi punonjësit socialë në përdorimin e standardeve më të larta dhe të

praktikave më të mira në fushën e punës sociale;

dh) kontribuon, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, për sigurimin e standardeve më të larta dhe praktikave më të mira në edukimin dhe formimin etik, profesional dhe shkencor të punonjësit social;

e) kontribuon, në marrjen e masave të nevojshme e të përshtatshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e mbrojtjes e mirëqenies sociale të popullatës;

ë) informon publikun përmes njoftimeve, buletineve periodike, botimeve shkencore dhe botimeve të tjera të veçanta, nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar;

f) kontribuon në zbatimin e programeve shtetërore, të enteve dhe organizatave të tjera publike e private, në funksion të interesit publik.

Anëtarësimi në Urdhrin e Punonjësit Social ka nisur në muajin tetor 2016 dhe është kusht për të ushtruar profesionin. Kjo do të shoqërohet me një kontratë ku parashikohen detyrat dhe të drejtat mes palëve. Ky Urdhër do të rregullojë pikërisht një shërbim më cilësor për çdo punonjës social, i cili do të jetë anëtar i këtij urdhri dhe më pas i licencuar edhe me profesionin e rregulluar edhe sipas legjislacionit në fuqi. Por, për t'u regjistruar në këtë databazë që më vonë do të njohë qytetarët me punonjësit ku duhet të kërkojnë ndihmë, kandidati duhet të ketë diplomën e nivelit "Bachelor" dhe "Master" brenda kësaj fushe.

3.5 PROGRAMI I SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Ligji ekzistues "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"është Ligji n. 9355, dt 10.03.2005.

Bazuar në Projektligjin për Shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, që shfuqizon në disa nene të tij ligjin e 2005, shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuara të përfituesve.

2. Llojet e shërbimeve shoqërore janë, si më poshtë:

a) Shërbimet parashoqërore;

b) Shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit;

c) Shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat;

ç) Shërbimet shoqërore në situatë emergjence;

d) Shërbimet e përkujdesjes alternative përfëmijët pa kujdes prindëror;

dh) Shërbimet e specializuara;

e) Shërbimi i këshillimit me telefon ose *on-line.*

3.6 ASPEKTE LIGJORE SIPAS TARGET GRUPEVE

3.6.1 Personat me Aftësi të Kufizuar

Sipas përkufizimit të projektligjit, "Person me aftësi të kufizuar", është, individi, fëmijë ose i rritur, me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë. Janëgrupi shoqëror i dytë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Sipas përcaktimeve në ligjin nr.93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", dhe projektligjit objekt interpretimi, personave me aftësi të kufizuara u vihet në dispozicion një ndihmës personal, individi i për t'i ndihmuar të kapërcejnë pengesat në jetën e përditshme.

Këtyre personave u ofrohet shërbimi në familje. Gjithashtu, u ofrohen shërbimet në qendrat e zhvillimit, të cilat janë shërbime komunitare që synojnë sigurimin dhe përmirësimin e statusit dhe cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç.

Akomodimi afatgjatë u sigurohet gjithashtu këtij grupi shoqëror dhe përkatësisht, individëve që kanë nevojë për kujdes intensiv me qëllim përmbushjen e nevojave themelore, kur ky kujdes nuk u sigurohet dot në familje apo familje kujdestare. Akomodimi i organizuar është një shërbim i kujdesit shoqëror në nivel vendor, i cili i ofrohet për 24 orë në ditë në qendrat rezidenciale për të përmbushur nevojat themelore sociale, kulturore, arsimore, rekreative dhe nevoja të përfituesve të kësaj kategorie, i ofruar nga subjekte publike ose jopublike.

3.6.2 Fëmijët.

Fëmijët dhe fëmijët në nevojë të mbrojtjes së veçantë kur nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe janë në pamundësi apo vështirësi për shkak se janë pa prindër, pa kujdestarë, jashtë familjes ose larg kujdesit prindëror apo kujdestarisë, viktimat apo viktimat e mundshme të abuzimit, trafikimit apo dhunës në familje, si dhe si dhe fëmija i mitur që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 16, të ligjit 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", përbëjnë grupin shoqëror të parë që i ofrohen shërbimet e kujdesit shoqëror.

Ndërhyrja e hershme është një shërbim shoqëror individual që ofrohet në familje, në qendra sociale për ofrimin e shërbimeve në komunitet ose institucionet e arsimit të detyrueshëm dhe konsiston në ndihmë profesionale dhe stimuluese për fëmijët deri në 8 vjeç, asistencë këshilluese për prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes me lidhje gjaku ose për familjen kujdestare me qëllim riintegrimin në shoqëri të fëmijës. Ndërhyrja e hershme përfshin referimin e rastit të fëmijës tek një qendër e shërbimeve shoqërore e specializuar, institucion i arsimit të detyrueshëm apo institucion mjekësor sipas karakteristikave të veçanta të fëmijës.

Përfituesit e shërbimit në streha janë: fëmija, i cili gjendet i pambikëqyrur nga prindërit, në rrezik, apo në situatë rruge; fëmija në nevojë të mbrojtjes së veçantë; d) fëmijët dhe të rriturit, viktima të dhunës në familje, abuzimit, viktima të trafikimit apo viktima të mundshme të trafikimit a në rrezik potencial për jetën; fëmijët dhe të rriturit në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësive nga droga apo alkooli a përjashtimi social.

Institucionet, të cilat me ligj janë përgjegjëse për trajtimin e fëmijëve të shfrytëzuar ose të trafikuar, janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet specifike për të ndihmuar dhe mbështetur fëmijët, viktima të shfrytëzimit ose trafikimit, deri në shërimin e tyre fizik dhe psiko-social, pas një vlerësimi të veçantë të rrethanave të secilit fëmijë, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme, sipas ligjit nr.9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"".

1.Fëmijës së privuar në mënyrë të përkohshme/të përhershme nga mjedisi familjar ose kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis i sigurohet një përkujdesje alternative.

2. Përkujdesja alternative mundtëjetë:

a) vendosja në një familje alternative ose në një institucion të përkujdesjes për fëmijë;

b) vendosja në një familje birësuese.

3.Shërbimet e përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror ofrohen në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të fëmijës, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

4. Procedura e evidentimit të familjes kujdestare organizohet dhe mbikëqyret nga strukturat e shërbimeve shoqërore të organeve të njësive të qeverisjes vendore, të cilat ngrenë pranë tyre komisionet multidisiplinare për vlerësimin e rasteve. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

3.7 PAKTI SOCIAL

Pakti Social është një mekanizëm për të ofruar Shërbime Shoqërore të Integruara sipas nevojave të kategorive të ndryshme shoqërore.

Pakti Social është qasja e re e Qeverisë Shqiptare për të siguruar dhe ofruar shërbimet e kujdesit shoqëror në të gjithë Shqipërinë, për të gjithë individët dhe familjet që kanë nevojë për to. Pakti Social është një mekanizëm që synon të bëjë bashkë të gjitha agjensitë që veprojnë në këtë fushë, me qëllim përmbushjen e objektivave madhorë për një shoqëri ku çdo qytetar/e të këtë akses të barabartë në shërbimet e ofruara nga shteti dhe/ose ofruesit e tjerë të licencuar prej tij.

Në frymën e këtij Pakti, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, si institucioni udhëheqës dhe koordinues i reformës së shërbimeve sociale do të lidhë marrëveshje institucionale me Bashkitë si partnerët kryesorë, të cilëve Strategjia e Mbrojtjes Sociale dhe Ligji Nr 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", dt 06.12.2016, u njeh një rol parësor në planifikimin, shpërndarjen dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në zbatim të këtij ligji Bashkia Kukës do të nënshkruaj këtë Pakt Social, duke u angazuar që brënda vitit 2018, do të realizojë :

- Ngritjen dhe funksionimin e Njësisë së Vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve në territorin e Bashkisë. Kjo strukturë e posacme do të përbëhet nga 5 Punonjës Socialë dhe Psikologë të kualifikuar.
- Hartimin dhe miratimin e Planit Social për shërbimet e Kujdesit Shoqëror dhe buxhetimin e tij.
- Ngritjen e Fondit Social së bashku me MMSR, Donatorët dhe Partnerët Ndërkombëtarë.

- Funksionimin me perparësi te Mekanizmit të Referimit të Rasteve të Dhunës për ti siguruar mbrojtje dhe zgjidhje Grave dhe Fëmijeve të dhunuar në familje.
- Funksionimin e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve si një strukturë themelore per mbrojtjen e Femijeve.
- Ngritjen e një Ndërmarrjeje Sociale për punësimin e individëve në Ndihmë Ekonomike dhe kategorive në nevojë;
- Një Shërbim të emergjencës për të gjitha kategoritë në nevojë, i cili konsiston në vlerësimin e rastit brenda 72 orëve dhe referimin e rastit tek shërbimet e tjera.

Nën një këndvështrim planifikimi afatgjatë Pakti Social parashikon ngritjen e shërbimeve sociale, bazuar në shportën e shërbimeve bazë, sipas përcaktimit të ligjit "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Nr 121/2016, dt 06.12.2016 :

- Ngritjen e Njësive të Operatorëve Social për Asistencën Shtëpiake e cila do të funksionojë në Bashki për cdo të moshuar me probleme social ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara. Këto Njësi do të ofrojnë Shërbime individuale në familje (asistencë shtepiake, përkujdesje vetjake, këshillim psikologjik, social dhe ligjor), për të moshuar dhe PAK në nevojë, viktima të dhunës etj.
- Shërbim ditor dhe komunitar - që ofrojnë këshillim psikologjik, social dhe ligjor, shërbime multidisiplinore të specializuara, përkujdesje, shërbime rehabilitimi, shërbime prindërimi, për të gjitha kategoritë në nevojë.
- Shërbim të emergjencës për të gjitha kategoritë në nevojë, i cili konsiston në vlerësimin e rastit brenda 72 orëve dhe referimin e rastit tek shërbimet e tjera.
- Shërbim multidisiplinar për fëmijët në nevojë, grate dhe vajzat, që përfshijnë shërbime emergjence dhe shërbime të specializuara.
- Shërbim multidisiplinar për te rritur PAK dhe të moshuar në nevojë, që përfshijnë shërbime emergjence dhe shërbime të specializuara.
- Shërbime alternative, me të paktën 10 familje kujdestare të përkohshme për fëmijët në nevojë dhe fëmijët PAK. Këto shërbime do të ofrohen sipas legjislacionit në fuqi.
- Shërbim për nënat vajza dhe fëmijët e tyre (qender emergjence-krize) – strehëz,ose apartament për qëndrim të përkohshëm deri në sistemimin përfundimtar të tyre.
- Shërbim afatgjatë rezidencial/Strehëz për të moshuarit, nënat – vajza, gratë e dhunuara, gratë e trafikuara, të alkoolizuar dhe përdorues droge, personat me aftësi të kufizuar.

- Realizimi i përshtatshmërise për PAK në objektet dhe hapësirat në territorin e Bashkisë.
- Në kuadrin e zbatimit të Pkatit Social dhe në zbatim të Ligjit Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Mirëqënies Sociale dhe Rinisë angazhohet që brënda vitit 2018, do të realizojë:
- Hartimin e Udhëzuesve për Vlerësimin e Nevojave dhe për hartimin e Planit Social.
- Hartimin e Paketës Rregullatore për ngritjen e Fondit Social.
- Hartimin e Protokolleve të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të rasteve për cdo punonjës social të Bashkise.
- Hartimin ei Modeleve të Ndërmarrjeve Sociale.
- Hartimin e Paketës Rregullatore për ofrimin e Shportës se Shërbimeve Baze.
- Hartimin ei Paketës Rregullatore për prokurimin e Shërbimeve Sociale.
- Ngritjen e Mekanizmit financiar për mbrojtjen dhe transformimin e shërbimeve rezidenciale.
- Rishikimin e Paketës së plotë të shërbimeve alternative për Kujdestarinë e Përkohshme.
- Përforcimin e rolit të Inspektoriatit si struktura inspektuese për të gjitha shërbimet e Kujdesit Shoqëror.
- Hartimin e Paketës Rregullatore dhe sanksioneve për zbatimin e Standardeve të Shërbimeve Shoqërore.
- Hartimin e Standardeve të Reja Komunitare për shportën e shërbimeve.

3.8 URDHRI I PSIKOLOGU

Urdhri i Psikologut është një ent publik, profesional, i pavarur dhe që përfaqëson e mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të këtij Urdhri, ashtu siç organizon veprimtarinë dhe marrëdhëniet midis tyre. Misioni i tij është nxitja dhe ruajtja e standardeve të larta në ushtrimin e profesionit në fushën e psikologjisë dhe mbrojtja e përfituesve të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit të psikologut.Kriteret e anëtarësimit në Urdhrin e Psikologut lidhen me shtetasin shqiptar, me diplomën e studimeve të larta në të dyja nivelet për Psikologji.

Organ drejtues i Urdhrit është Asambleja Kombëtare, e cila drejton të gjithë Urdhrin e Psikologut. Urdhëri ka një Këshill Kombëtar me anëtarë të përcaktuar nga Asambleja Kombëtare. Licencat që jepen, prashikohet të jenë të llojeve të ndryshme dhe të gjitha këto të dakordësuara brenda Asamblesë dhe Këshillit Kombëtar.

Për kryerjen e praktikës profesionale parashikohet një rregullore e veçantë, e cila do të bëhet me marrëveshje edhe me ministritë e linjës, sepse psikologu nuk është një profesion që ushtrohet vetëm në një fushë. Pas miratimi të ligjit dhe nisjes së zbatimit të tij, psikologët do të licencohen dhe ata janë të listuar në një listë të certifikuar.

Ligjin për Urdhrin e Psikologëve në Republikën e Shqipërisë, 2016, përcakton fushat e ushtrimit të profesionit të psikologut dhe gjithashtu kushtet dhe kriteret për ushtrimin e profesionit të psikologut.

4. NEVOJAT LOKALE PËR ZBATIMIN E PLANIT SOCIAL

4.1 ORGANIZIMI STRUKTUROR I NEVOJSHËM I DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL DHE KOMUNITAR

Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar në Bashkinë e Elbasan ndodhet në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Strategjike, Sociale, Shërbimeve Komunitare dhe Inovacionit.

Kjo drejtori ka të nevojëshme të ketë në varësi të saj tre sektorë:

1.Sektorin e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore;

2.Sektorin e Kujdesit të Shtresave në Nevojë dhe Moshës së Tretë;

3.Sektorin e Mbrojtjes dhe Kujdesjes Sociale (Ndihma Ekonomike).

Misioni i drejtorisë:

- Të identifikojë familjet më të varfëra në territorin e bashkisë dhe të planifikojë dhënien e ndihmës ekonomike sipas kritereve ligjore.
- Të planifikojë dhe të administrojë fondet për trajtimin e personave me aftësi të kufizuar (të verbër, me paaftësi mendore dhe fizike, para e tetraplegjike) si dhe pagesat për invalidët e punës.
- Të identifikojë nevojat e grupeve sociale në rrezik si fëmijët, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit dhe minoritetet për shërbime sociale dhe në përputhje me mundësitë e në bashkëpunim me OJF-të u ofron këto shërbime.

Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar në Bashkinë Elbasan ka aktialisht në total 35 punonjës, prej të cilëve 16 specialsit dhe 7 drejtues të cilat janë të vendosur në zyrat qëndrore të Bashkisë dhe 12 specialist/ administrator janë shpërndarë në njësitë administrative. Përsa i përket punonjësve në Njësitë Administrative informacioni në lidhje me stafin që shërben aty, përfshin administratorin e njësisë, punonjësin e gjëndjes civile, si edhe 2-4 punonjës të One Stop Shop.

Sektori me numrin më të madh të punonjësve është ai i Ndihmës Ekonomike i cili ka aktualisht 24 punonjës, sugjerohet të rritet në 28 Punonjës si dhe ndarja e shërbimeve sipas kompetencave të vendit të punës.

Bazuar në procesin e konsultimit që u u zhvillua në kuadrin e hartimit të këtij Plani Social sugjerohen disa ndryshime në Strukturën e Drejtorisë së Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si me poshtë në Tabelën.2

Tab 2. Struktura e Sugjeruar e Drejtorisë së Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar në Bashkinë Elbasan



Në lidhje me **shërbimet për përkujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve**, sugjerohet që Shërbimi Social Elbasan, të ketë punonjës NjMF-je për të paktën dy njësi administrative, pra 2 njësi adminstrative dhe 6 punonjës në Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Përvec planifikimit për ngritjen e këtyre njësive, tavolinat e rrumbullakëta të organizuara nga Shërbimi Social për menaxhimin e rasteve, ku marrin pjesë përfaqësues nga sektori i Aftësisë së Kufizuar, Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Dhunës në Familje, janë shndërruar në takime periodike, prej 3-muajsh ku cdo përfaqësues paraqet rastet, kryesisht urgjente, për t'u menaxhuar. *"Deri më tani, kjo nismë ka funksionuar mirë në këtë drejtim por ka hapësirë për tu përmirësuar"*, shprehen drejtuesit e shërbimeve sociale në Bashki.

Gjithashtu për të ardhem sugjerohet që të strukturohen 'Grupe Vlerësimi' me specialsit nga Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve e Barazisë Gjinore dhe nga Sektori i Shtresave në Nevojë dhe Moshës së Trete. Këto grupe sugjerohet të mblidhen në mënyrë periodike për të vlerësuar dhe për të ofruar zgjidhje për

raste të ndryshme të cilat prezantojnë problematikë komplekse dhe kërkojnë specialist të fushave të ndryshme, që referohen pranë kësaj drejtorie.

Për periudhën 2017 – 2018 parashikohet që në strukturën e drejtorisë të ngrihet dhe të funksionojë **Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve** si strukturë e posacme do të përbëhet nga 5 Punonjës Socialë dhe Psikologë të kualifikuar.

Ndërsa në një hark kohor me afatgjatë 2017 – 2022 parashikohet ngritja e **Njësisë së Operatorëve Social për Asistencën Shtëpiake** e cila do të funksionojë për cdo të moshuar me probleme social ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara. Kjo Njësi do të ofrojë Shërbime individuale në familje (asistencë shtepiake, përkujdesje vetjake, këshillim psikologjik, social dhe ligjor), për të moshuar dhe PAK në nevojë, viktima të dhunës etj.

Drejtoria e Shërbimit Shërbimit Social dhe Komunitar në Bashkinë Elbasan ka për detyrë:

- Identifikimi i nevojave për territorin që mbulon;
- Vlerësimi i nevojave në bazë të hartës së vulnerabilitetit;
- Hartimi i Planit Social;
- Programimi buxhetor;
- Planifikimi dhe sigurimi i Shportës bazë të shërbimeve shoqërore;
- Ngritja e Shportës bazë të shërbimeve shoqërore:
- Kalojnë funksionin e realizimit të shërbimeve tek sektori privat me kontratë;
- Krijojnë dhe shfrytëzojnë shërbimet (publike);
- Bashkëfinancojnë shërbimet e ofruara publikisht ose privatisht (shumica e fondeve duhet të vijë nga niveli qendror - % e fondeve vendore mund të ndryshojë sipas bashkive më shumë ose më pak të zhvilluara).
- Bashkërendojnë me SHSSH-në për shërbimet e kujdesit social të nevojshme;
- Rekrutojnë personelin e njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve.

Në Njësitë Administrative propozohet të ngrihen **"Njësitë për Vlerësimin dhe Referimin e Rasteve"** (**NJVNRR**) të përbërë nga sektori i pagesave në cash (ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar etj) dhe sektori i përkujdesit dhe përfshirjes sociale (shërbimet sociale në komunitet, rastet e dhunës në familje, rastet e abuzimit dhe problematikave të fëmijëve). Propozohet të përfshihen në këtë njësi, njësitë për mborjtjen e fëmijëve dhe punonjësi i dhunës në familje, si dhe të përcaktohen nëpunësit zbatues për programet e riintegrimit social.

(i) Funksionet kryesore të NJVNRR/sektori i përkujdesit social janë identifikimi i rasteve; këshillimi dhe hartimi i planeve individuale të përkujdesjes; ndërmjetësimi dhe referimi në shërbime sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar; si edhe ndjekja, monitorimi dhe vlerësimi i rasteve.

Kjo njësi do të funksionojë si një zyrë që ofron të gjitha shërbimet me një ndalesë dhe të shërbejë si një pikë kryesore hyrjeje për qytetarët që mundëson referim të menjëhershëm të rasteve në bashkëpunim me Drejtoritë e Shërbimeve shoqërore në nivel bashkie. Kjo mund të shërbejë për të përmirësuar bashkërendimin dhe mekanizmat e referimit si edhe administrimin e rasteve.

(ii) Përllogaritja e kostove të ngritjes së sektorëve të vlerësimit të nevojave dhe referimit:

Kostot e përllogaritjes së sektorëve (NVNRR) do jenë në përputhje me modelin që do të zgjidhet.

Në këtë fazë mund të jepet vetëm përafërsisht kostoja për ngritjen e NVNRR-ve në nivel kombëtar. Kostot vjetore të forcës punës çmohen se do të jenë 1,66 milion euro për të gjithë vendin, në bazë të këtyre supozimeve:

- Sipas standardeve rajonale nevojitet një punonjës social për 10.000 banorë (këtu referuar garantimit të shportës së shërbimeve shoqërore, pasi me pagesat Cash parashikohet të vazhdojnë administratorët shoqërorë).

Baza ligjore e veprimtarisë

Problematika që trajton Drejtoria e Shërbimeve Sociale mbeshtetet në Ligjin nr.9355,dt.10.03.2005 "Për Ndihmën dhe Shërbimet shoqërore", V.K.M. nr.787, datë 14.12.2005"Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike" ligji nr 9970 datë 24.07.2008 "Për barazine gjinore në Shoqëri" ,ligji nr 9669 datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare ". V.K.M.nr 204 datë 16.04.2004 "Për masën dhe kriteret e përfitimit të paaftësisë nga personat me statusin e invalidit të punës" si dhe akteve nënligjore, V.K.M nr 618 datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kritereve ,dokumentacionit dhe masës së përfitimit për personat me aftësi të kufizuar". Ligji nr 10347 datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve".

Ligji 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore"; Ligji Nr.9355 date 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar si dhe ligjet që rregullojnë çështje të mbrojtjes së fëmijëve, për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, kundër diskriminimit, statuset e veçanta për të verbërit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, invalidët e punës etj, si dhe Vendimet e këshillit të ministrave apo Udhëzime të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë sipas fushave përkatese.

Misioni i drejtorisë:

- Të identifikojë familjet më të varfëra në territorin e bashkisë dhe të planifikojë dhënien e ndihmës ekonomike sipas kritereve ligjore.
- Të planifikojë dhe të administrojë fondet për trajtimin e personave me aftësi të kufizuar (të verbër, me paaftësi mendore dhe fizike, para e tetraplegjike) si dhe pagesat për invalidët e punës.
- Të identifikojë nevojat e grupeve sociale në rrezik si fëmijët, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit dhe minoritetet për shërbime sociale dhe në përputhje me mundësitë e në bashkëpunim me OJF-të u ofron këto shërbime.

Më konkretisht këtë mision e përmbush nëpërmjet:

- Përgatitjes së kërkesave për ndihmë dhe justifikimit të përdorimit të saj.
- Paraqitjes së materialeve pranë Këshillit Bashkiak, sipas afateve të përcaktuara në ligj.
- Verifikimit të dosjeve të pretenduesve për ndihmë ekonomike dhe përfitim paaftësie (paaftësi, verbëri, paraplegjikë) për saktësinë e tyre.
- Sqarimit të pretenduesve për Ndihmë Ekonomike, për të drejtën e përfitimit dhe i ndihmon në plotësimin e dokumentacionit përkatës.

4.2 SHPORTA E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Shporta e shërbimeve të ofruara në nivele bashkie përfshin shërbimet si më poshtë:

Shërbime individuale në familje, për të moshuar dhe PAK në nevojë, viktima të trafikimit dhe të mundshme të trafikimit. Këto shërbime ofrojnë mbikqyrje e funskioneve fizike, emotive, sociale, asistencë shtepiake, përkujdesje vetjake, këshillim psikologjik, social dhe ligjor sipas rastit.

Shërbim ditor për të gjitha kategoritë në nevojë. Këto shërbime ofrojnë këshillim psikologjik, social dhe ligjor, si dhe përkujdesje vetjake e ushqim.

Shërbim alternative, kujdestari e përkohshme për fëmijët në nevojë dhe fëmijët PAK. Këto shërbime ofrohen sipas legjislacionit në fuqi.

Shërbime komunitare për të gjitha kategoritë në nevojë. Këto shërbime përfshijnë shërbime multidisiplinore të specializuara, për shembull këshillim psikologjik, ligjor, shërbime rehabilitimi, prindërimi etj.

Shërbimet e emergjencës për të gjitha kategoritë në nevojë, i cili konsiston në vlerësimin e rastit brenda 72 orëve dhe referimin e rastit tek shërbimet e tjera.

Shërbime për nënat vajza dhe fëmijët e tyre – qëndrime të përkohshme në strehëza, ose apartamente deri në sistemimin përfundimtar të tyre.

Shërbimet e specializuara në nivel qendror për fëmijët e abuzuar, gratë e dhunuara. Këto shërbime ofrohen nga ekspertë të specializuar sipas fushave përkatëse, të aftë për të trajtuar raste specifike.

Shërbimet afatgjata rezidenciale për të moshuarit, nenat – vajza, gratë e dhunuara, gratë e trafikuara, te alkoolizuar dhe përdorues droge, personat me aftësi të kufizuar. Këto shërbime ofrojnë qëndrim, akomodim, ushqim, arsim, kulturim, shërbime shëndetësor, këshillim ligjor, psikologjik dhe social.

4.3 PËRSHKRIMI I FUNKSIONEVE DHE KOMPETENCAVE SIPAS STRUKTURËS SË SUGJERUAR

4.3.1.Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore:

Në fushën e mbrojtjes së fëmijëve:

- Bën identifikimin, vlerësimin dhe koordinon veprimet dhe shërbimet me synim mbrojtjen e fëmijëve në rrezik brenda territorit të bashkisë. Mbrojtja e fëmijëve nga neglizhimi, abuzimi, dhuna, shfrytëzimi, përjashtimi social, trafikimi, si dhe nga fenomene të tjerë që cënojnë mirëqenien e tyre, në bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të ngushtë më personelin e bashkisë, partnerët lokal që veprojnë në zonë, si dhe me të gjithë aktorët e tjerë të cilët kanë rol dhe përgjegjësi në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.

- Kryen vlerësimin fillestar të fëmijëve të referuar si në rrezik apo në nevojë, të hartojë planin e ndërhyrjes, të menaxhojë rastin dhe ta ndjekë atë në bashkëpunim me aktorë përkatës të mbledhur në takimin për mbrojtjen e fëmijëve;
- Bashkëpunon dhe koordinon me të gjithë strukturat brenda zyrës së Shërbimit Social në Bashki dhe aktorë të tjerë publikë apo dhe jo publikë, me qëllim përmirësimin e situatës të fëmijëve dhe të familjeve të tyre, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të rrjetit mbrojtës dhe shërbimeve të komunitetit.
- Thërret rregullisht, i mbështetur nga Supervizori (Drejtori), ekipin Multidisiplinar për të adresuar dhe koordinuar ndërhyrjen për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.
- Konsultohet dhe këshillohet rregullisht me supervizorin për të përcaktuar nivelin e rrezikut për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, konsultimin për planin e ndërhyrjes, si dhe, zbatimin e plotë të këtij plani ndërhyrjeje.
- Bashkëpunon me Shërbimin Social Rajonal, si dhe me shërbimet sociale në territorin e bashkisë, për të siguruar referimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë për shërbime sociale në shërbime të specializuara apo që nuk ofrohen në zonë.
- Siguron dokumentimin e të dhënave të sakta e faktike dhe dosje personale për të gjithë fëmijët e identifikuar dhe referuar pranë NJMF, (sipas formatit të Protokollit të Punës) dhe bazës së të dhënave elektronike).
- Raporton rregullisht pranë Agjencisë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.
- Organizon në bashkëpunim me aktorë të tjerë, aktivitete ndërgjegjësuese në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Merr pjesë në programet e trajnimeve të ofruara në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe të zhvillojë kompetencat psikosociale dhe metodologjike në punën me fëmijët.
- Adreson, advokon dhe lobon në nivel institucional lokal dhe rajonal për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Kontribuon me ide, të dhëna dhe propozime në aktivitetet për hartimin e Strategjisë së Shërbimeve Sociale për Bashkinë apo strategjive të tjera sipas nevojës.
- Promovojë çështjet që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet aktiviteteve parandaluese, sensibilizuese, edukative.

Në çështje të barazisë gjinore dhe kundër dhunës në marrëdhëniet familjare:

- Lehtëson dhe mbështet bashkëpunimin e organeve të qeverisjes vendore me institucionet lokale për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje.

- Siguron ekspertizë teknike për bashkinë për çështje të barazisë gjinore dhe marrjen e masave për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje.

- Mbështet organet e qeverisjes vendore dhe lehtëson bashkëpunimin e ngushtë të tyre me organizatat jofitimprurëse lokale dhe organizma akademike për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme si dhe për programe në mbrojtje të viktimave të dhunës në territorin që ato mbulojnë;

- Bashkëpunon me strukturat përkatëse në MMSR për çështjet e barazisë gjinore dhe mbështet organet e qeverisjes vendore për:

  a) mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave vendore të ndara sipas gjinisë duke respektuar formatin e miratuarnga MMSR si autoriteti përgjegjës;

  b) Përgatitjen dhe dhënien e informacionit periodic për aktivitetet e kryera nga bashkia në kuadrin e promovimit të barazisë gjinore dhe statusit të gruas shqiptare si dhe luftën kundër dhunës në familje;

  c) Të dhëna statistikore për nivelin e dhunës në familje, në bashki/komunë;

- Inicion dhe merr pjesë aktive në aktivitetet dhe fushatat ndërgjegjësuese për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje, të organizuar nga bashkia ose që organizohen në bashkëpunim me MMSR dhe shoqërinë civile (takime, ëorkshope, diskutime në media).

- Përgatit informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për pasqyrimin e çështjeve gjinore në ëebsite, buletinet apo mjetet e tjera të informimit të bashkisë .

Nënpunësi gjinor gjithashtu mbulon dhe koordinatorin vendor për referimin e rasteve te dhunës në marrëdhëniet familjare i cili :

a) drejton punën e ekipit teknik ndërdisiplinor, ndërmerr iniciativën dhe organizon takimet e këtij ekipi, si dhe informon për ecurinë e punës së tij Komitetin Drejtues "Për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje".

b) koordinon ekipin teknik ndërdisiplinor për rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe siguron burime ose shërbime reference, për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore falas, këshillim dhe të tjera mbështetje;

c) shërben si ndërmjetës me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetesore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe të tjera institucione/organizata për të dhënë informacion, për t'i lidhur viktimat me shërbimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre;

d) asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave që duhet të ndiqen për marrjen e një Urdhëri Mbrojtjeje/Urdhëri të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe për hapat që duhen ndjekur nëse urdhëri shkelet;

e) shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe pranë shërbimeve të tjera;

f) sigurohet që dosjet dhe dokumentacioni rreth klientëve të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar;

g) Përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje të trajtuara nga ekipi teknik ndërdisiplinor, në një bazë elektronike të mbajtjes së të dhënave, si dhe ndan një herë në muaj një informacion mbi rastet e trajtuara me anëtarët e këtij ekipi.

h) organizon dhe monitoron takime për menaxhimin e rasteve;

i) sigurohet që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuara nga gjykata, që ato të ndjekin hapat e duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës, si dhe sigurohet që të kryhen të gjitha llojet e ndërhyrjeve të nevojshme në përputhje me ligjin;

j) koordinon organizimin e trajnimeve nga struktura përgjegjëse për dhunën në familje, për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin;

k) mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, profesionistëve dhe organizatave joftimprurëse rreth dhunës në familje, dhe shërbimeve me materiale ose botime te ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuese për dhunën.

l) paraqet raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara Komitetit Drejtues "Për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje", në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.

m) propozon në strukturën e shërbimeve sociale pranë njësisë së qeverisjes vendore, krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në marrëdheniet familjare.

4.3.2 Sektori i Shtresave në Nevojë dhe Moshës së Tretë:

Mbulon kryesisht problematika të shërbimeve sociale që lidhen me shtresan ne nevojë në përgjithësi dhe me etnitë (rom dhe egjiptian) dhe moshën e tretë në vecanti.

Është një sektor i krijuar rishtazi nga ndarja e sektorit të Programimit Social.

Synimi është që ti gjendet më pranë këtyre shtresave në nevojë dhe të mbulojë hapësirën e re të krijuar nga reforma administrative-territoriale.

Per etnitë dhe moshën e tretë:

- Në përputhje me strategjinë përkatëse identifikon dhe monitoron situatën e personave të moshuar dhe etnive (Rom dhe egjiptiane).
- Identifikon të moshuar të vetmuar e pa përkrahje dhe pas verifikimit të rastit bën referimin tek OJF-të që ofrojnë shërbime sociale për këtë grup moshë.
- Ndjek procedurat e vendosjes, shërbimeve dhe zbatimit të standarteve në Qendrën Sociale Balashe.
- Organizon tryezat teknike në lidhje me problematika, aktivitete dhe vendosje në qendra të perkujdesit social për target grupet moshë e tretë dhe etnitë,
- Koordinim dhe kontakte me OJF-të që operojn në territorin e Bashkisë Elbasan, por jo vetëm, që kanë në fokus dhe ofrojnë shërbime për këto target grupe.
- Identifikim dhe menaxhim rasti dhe referim sipas nevojave që paraqet secili rast.
- Vlerësimi i nevojave të të moshuarve dhe personave të komunitetit rom e egjiptian duke i vizituar në familje për tu njohur më nga afër me situatën në të cilën jetojnë.
- Menaxhim në mbajten e dokumentacioneve të dosjeve për secilin rast.
- Mbledhje e dokumentacionit të nevojshëm për të moshuar që kërkojnë të akomodohen në qendra të përkujdesit social dhe dërgimi i tyre në Shërbimin Social Shtetëror.
- Mbledhje e dokumentacionit të kërkuar për fëmijë jetim (me baba të vdekur) për të përfituar pension jetimi nga Shoqata ALSAR.
- Vizita në qendra ditore të Bashkisë Elbasan por edhe të OJF-ve të ndryshme që ofrojnë shërbime për të moshuar dhe etnitë.
- Informim i anëtarëve të komunitetit, profesionistëve dhe organizatave joftimprurese rreth problematikave që ka mosha e tretë/etnite, dhe shërbimeve me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuese.

4.3.3 Sektori i Mbrojtes Sociale , PAK dhe Ndihmës Ekonomike:

- Në përputhje me strategjinë përkatëse identifikon dhe monitoron situatën e personave me aftësi të kufizuar, PAK dhe Ndihmën Ekonomike në të gjitha nivelet.

- Monitoron kërkesat që vijnë nga OJF-të për ndërtimin e një shoqërie pa barriera dhe punësimin e kësaj kategorie në rrezik social.
- Identifikon persona me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe sipas rastit pas verifikimit në familje i referon tek mjeku i Zyrës Rajonale të Sh.S.Sh-së për përfitimet ligjore nga KMCAP sipas statusit përkatës ose tek OJF-te kur personi ka nevojë për shërbime të përkujdesit social.
- Ndjek procedurat e vendosjes, shërbimeve dhe zbatimit të standarteve në Qendrën Sociale Balashe.
- Propozon rendin e ditës dhe drejton tryezën teknike të grupit të personave me aftësi të kufizuar,
- Përmes bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe komunitetin nxit dhe promovon të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
- Organizon fushata ndërgjegjesuese në ditët ndërkombëtare te PAK.
- Bashkëpunon me OJF-të që kanë ne fokus PAK për aktivitete sociale.

Pagesat kesh për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar

Aspekt i rëndësishëm i tërësisë së shërbimeve të ofruara nga Bashkia për Kujdesin Social është ai i kryer për ***familjet në ndihmë Ekonomike***, personat me aftësi të kufizuar si dhe invalidët e punës.

Ndihma ekonomike bazohet në sistemin elektronik të aplikimit dhe vlerësimit të pikezuar mbi bazën e 52 treguesve/indikatorëve të matjes së varferisë. Aplikimi bëhet ne zyrat vendore ndërsa vleresimi nga Shërbimi Social Shteteror dhe Fondet disbursohen nga buxheti i shtetit.

Ky sektor ka aktualisht një përgjegjës dhe 24 Specialist.

Për vitin 2016 ka patur rreth 6700 familje aplikuese per perfitimin e ndihmes ekonomike, prej te cilave 2500 ne zonen urbane dhe 4200 familje ne zonen rurale. Nga këta aplikes aktualisht rezultojnë 5800 familje që aktualisht perfitojnë ndihme ekonomike prej te cilave 1800 ne zonën urbane dhe 4000 familje në zonën rurale.

Ndihma Ekonomike referuar ndryshimeve ligjore, tanimë bazohet në një ***Sistem Elektronik Aplikimi dhe Vlerësimi*** mbi bazën e disa variablave të përcaktuar si indikatorë të nivelit të varfërisë dhe ballafaqimit të tyre në mënyrë elektronike më të dhënat e institucioneve të lidhura me këtë proces.

Bazuar në ndryshimet ligjore dhe VKM nr.904 datë 12.12.2012 kanë të drejtë të aplikojnë për ndihmë ekonomike të gjitha familjet banorë të teritorit të bashkisë. Por përfitojnë apo vlersohen si përfitues nga ky sistem familjet pa të ardhura nga punësimi, nga sistemi i pensioneve, nga aktiviteti ekonomik privat apo nga pasuria.

Të dhënat e institucioneve të tilla si: Drejtoritë e punës, Sigurimeve shoqërore, Tatim-taksave, Zyrës së Pronave dhe drejtorisë së transportit kryqëzohen në mënyrë elektronike me të dhënat e tjera të çdo familje aplikanti.

Aplikimi për ndihmën ekonomike bëhet pranë çdo njësie administrative apo lagje qyteti nga data 1-10 e çdo muaji. Pas kësaj bëhet vlereësimi elektronik dhe ballafaqimi me të dhënat e institucioneve nga Shërbimi Social Shtetëror dhe në fund të çdo muaji Drejtoria Rajonale e Sh.S.Sh sjell vendimin perkatës për familjet përfituese dhe masën e pagesës.

-Pagesa llogaritet sipas strukturës së familjes si më poshtë:

Kryefamiljarin dhe personin mbi moshë pune me 1800 (njëmijë e tetëqind) lekë në muaj;

Anëtarin në moshë pune të familjes me 1260 (njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë;

Anëtarin nën moshë pune 900 (nëntëqind) lekë në muaj.

Përveç kësaj trajtohen:

Fëmijët me status jetimi 3000 (trëmijë) lekë;

Viktimat e dhunës dhe trafikimit 3000 (trëmijë) lekë;

Fëmijët e lindur si trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë 3000 (trëmije) lekë;

Familjet kujdestare të fëmijëve jetimë 9000 (nëntëmijë) lekë;

Kompensim për energjinë elektrike 1288 (njëmijë e dyqin e tetëdhjetë e tetë) lekë;

Për fëmijët në arsimin e detyruar 300 (treqind) lekë për çdo fëmijë;

Për vaksinimet e fëmijëve 100 (njëqind) lekë për çdo vaksinë.

Sipas ndryshimit të fundit ligjor përfitimi i ndihmës ekonomike do të jetë i kufizuar në kohë deri në 5 vjet.

4.4 SHPËRNDARJA TERRITORIALE E SHËRBIMEVE SOCIALE

4.4.1 Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Elbasan:

Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 141,714 banorë me densitet prej 162.51 banorë për km^2, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 205,892 vetësh dhe densitet prej 236.11 banorë për km^2. Bashkia e Elbasanit ka një sipërfaqe prej 872,03 km^2.

Kjo bashki përbëhet nga 12 njësi administrative, të cilat janë: Elbasan, Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirgjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Zavalinë dhe Papër. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Elbasanit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra.

-Shërbimet publike

Qeveria Qendrore është edhe ofruesi më i madh i shërbimeve sociale për individë e familjeve në nevojë, nëpërmjet programeve të asistencës sociale në para, përkujdesit shoqëror, arsimimit, kujdesit shëndetësor dhe punësimit. Ajo menaxhon, financon e monitoron zbatimin e politikave sociale nëpërmjet Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorisë Arsimore Rajonale, Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik, Zyrës së Sigurimeve Shoqërore, Zyrës së Punës e Qendrës Lëvizëse të formimit profesional, nëpërmjet të të cilave ofron mbështetje në para për familje të varfëra e individë me aftësi të kufizuar, shërbime të kujdesit shëndetsor parësor dhe terciar, shërbime arsimore, shërbimet e punësimit e formimit profesional. Bashkia jonë ka qenë e përfshirë në pilotimin e skemës së re të ndihmës ekonomike dhe shpreh pakënaqësinë e saj për këtë skemë të re, edhe pse ajo tani ka vazhduar aplikimin e saj në të gjithë Shqipërinë.

Sipas të dhënave të studimit të UNICEF2013[7], Elbasani rezulton të jetë një nga bashkitë që e ka nivelin e varfërisë më të ulët, por numrin e përfituesve të ndihmës ekonomike më të lartë, përkatësisht 10.7% e popullsisë në varfëri dhe 13.7% në Ndihmë Ekonomike.

Me zbatimin e ligjit të ri për përfitimin e ndihmës ekonomike, për të cilën bashkia Elbasan ka qenë bashki pilot, *shumë familje janë përjashtuar nga skema dhe kjo për shkak të kritereve tejet strikte, të cilat nuk lejojnë fleksibilitet edhe pse janë në varfëri. Pikëzimi në sistemin online trajton njësoj si një familje nga qyteti që nuk ka të ardhura fare ashtu edhe një familje nga fshati që mund të ketë tokë e të merret me blegtori e bujqësi. Sistemi konsiderohet rixhid dhe shumë familje në varfëri të vërtetë që pas aplikimit të sistemit online kanë mbetur jashtë skemës së ndihmës eknomike. Ky problem është ngritur vazhdimisht nga punonjësit e shërbimit social.*

Nga ana tjetër, nga eksperienca e Bashkidë Elbasan referohet që pikëzimi favorizon familjet eë mëdha dhe kësisoj familjet e vogla mbeten shpesh-herë pa përfituar, pavarësisht se nevojat e familjes së vogël mund të jenë më persistente krahasuar me nevojat e familjes së madhe. Ky është një aspekt për t'u rishikuar sërish sa i përket skemës së re të ndihmës ekonomike, pasi mjaft familje që janë në nevojë nuk përfitojnë pikërisht prej rregullave strikte që janë vendosur për të bërë klasifikimin.

Qeveria Vendore është një aktor kyç, në sigurimin e shërbimeve sociale dhe kopetencat e saj janë duke u rritur hap pas hapi. Aktualisht Bashkia Elbasan operon në fushën e mbrojtjes sociale dhe përkujdesit shoqëror nëpërmjet, Sektorin e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore; Sektorin e Kujdesit të Shtresave në Nevojë dhe Moshës së Tretë; Sektorin e Mbrojtjes dhe Kujdesjes Sociale (NdihmaEkonomike), Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Njësisë për të Drejtat e Fëmijëve .

[7] *UNICEF (2013) Shërbimet e përkujdesit social në nivelin rajonal: Analizë dhe rekomandime.*

Banesat sociale janë shpërndarë të gjitha dhe kësisoj Drejtoria e strehimit nuk ka më banesa sociale në dispozicion për këtë vit. Meqënëse këto banesa sociale i ka pasur drejtoria e strehimit, që koordinohet me drejtorinë e shërbimt social për trajtimin e rasteve të veçanta, 96 banesa prej tyre janë shpërndarë që para dy vitesh, por kriteri për të pasur një minimum të ardhurash përjashtoi familjet e regjistruara tek programi i ndihmës ekonomike. Për ta balancuar paksa këtë situatë, bonusi social ku 50% të qerasë e paguan bashkia, ka familje të varfëra të cilat mund të aplikojnë dhe të përfitojnë.

-Shërbimet Jo-publike

Disa Shërbime Sociale ofrohen në territorin e Bashkisë Elbasan nga organizata jo-qeveritare që janë në shërbim të komunitetit. Kryesisht këto shoqata ofrojnë shërbime rezidenciale dhe ditore me qëllim fuqizimin e grupeve vulnerabël. Bashkia u është shumë mirënjohëse të gjithë organizatave të cilat japin kontributin e tyre në territorin tonë.

Tab. 3 - Shërbime Sociale ofrohen në Bashkinë Elbasan nga organizata jo-qeveritare

Institucioni / Organizata	Tipologjia e shërbimit	Grup-mosha	Adresa
	Shërbime ditore 6-14 vjeç dhe shërbime ditore për të moshuarit	Shërbime sociale për të moshuar	Menca e Konviktit të shkollës së Muzikës "Onufri"
	Shërbime për fëmijët, romt dhe gjyptianët, grate dhe PAK	Shërbime sociale për grup mosha të ndryshme sipas kaegorive	Bul. Gjergj Fishta, Kulla "Begeja", Kati 4
	Shërbime ditore për të moshuarit dhe PAK	Shërbime sociale për të moshuar	Lagja Shën Koll, Rruga Balashe
	Shërbime terapeutike për fëmijë me nevoja të veçanta për moshat 0-15 vjeç.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-15 vjeç	Blv: Aqif Pasha, Lagjja 28 Nentori ,Pallati nr 422, kati 1
	Shërbime rezidenciale për moshat 0-3 vjeç.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç	Rruga "Isuf Kondakçi" Lagjia Syrja Dylgjeri
	Shërbime ditore për moshat 6-14 vjeç, qendër këshillimi për të rinjtë dhe familjarët.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç	Rruga Elbasan Librazhd ish parku i mallrave.
	Shërbime ditore dhe rezidenciale për moshat 6-14 vjeç, qendër këshillimi, strehëz krizash e rastesh urgjente.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç	Rruga "Ali Arapi" N 19. Lagjia Aqif Pasha
	Shërbime ditore për moshat 6-14 vjeç qendër këshillimi strehëz krizash e rastesh urgjente.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç	Rruga "Ali Arapi" N 19. Lagjia Aqif Pasha

	Shërbime rezidenciale për moshat 0-3 dhe 6-14 vjeç.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç	"Mollas"
	Shërbim rezidencial për moshat 6-14 vjeç dhe shërbime ditore për moshat 0-3 vjeç dhe qendër këshillimi për të rinjtë.	Shërbime sociale për fëmijë 0-3 vjeç dhe 3-14 vjeç	Lagja:Dyli Haxhire tek Ish fusha e drureve
	Qendër këshillimi për familjare dhe qendër krizash.	Shërbime multidisiplinare për familjet me probleme sociale dhe përkomunitetin	Rruga "28 Nëntori" P 77/5 Lagjia Aqif Pasha.
	Qendër këshillimi strehëz krizash e rastesh urgjente.	Shërbime multidisiplinare për familjet me probleme sociale dhe për komunitetin	Rruga "Ali Arapi" N 19. Lagjia Aqif Pasha
	Qellimi Strategjik: Mbrojtja e Fëmijëve është prioritet në familjet, jeten në komunitet, punen e shoqërisë civile dhe planet e qeverisë në termat e strukturave dhe iniciativave te ndërmarra.		L. Aqif Pasha, Rr. Vasil Taja, Nr. 9, Elbasan, 3001, Albania
	Zhvillim komuniteti, ndihma emergjente,iniciativa strategjike, ndërgjegjësim publiku		World Vision Albania, Librazhd ADP / Lagja : Nr.3 Ish Baza e Bujqësis, Librazhd.

Burimi i të dhënave: Drejtori i Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, Bashkia Elbasan

4.4.2 Shërbimet e përkujdesit Social per Vitin 2016 sipas kategorive

1. <u>Fëmijët</u>:

Për vitin 2016 janë realizuar këto arritje:

Janë menaxhuar në total 102 raste të fëmijëve në rrezik të përmbledhura në Tabelen 4 sipas kategorive përkatëse.

Tab. 4 – Menaxhimi i rasteve të dhunës tek fëmijët

• *dhunë në familje*	19
• *trafikim*	3 rrezik
• *fëmijë në situatë rruge*	17
• *probleme ekonomike*	32
• *aftësi e kufizuar*	2
• *mosregjistrim*	5
• *braktisje shkollore*	13
• *Tjetër –Braktisur nga prindërit*	11

Tab.5 – Rastet e fëmijëve në ndjekje sipas llojit të abuzimit

Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të abuzimit	
• *abuzim fizik*	26
• *abuzim psikologjik*	18
• *neglizhim*	58

Burimi i të dhënave: Drejtori i Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, Bashkia Elbasan

Menaxhim i rasteve te grave të dhunuara prej të cilave :

52 raste në total të menaxhuara

40 raste të pajisura me Urdhër Mbrojtje

12 raste të fëmijëve të pajisur me Urdhër Mbrojtjen

12 raste të dhunës në familje të pa pajisur me Urdhër Mbrojtje por në rrezik

Identifikimi dhe verifikimi i rasteve në nevojë është realizuar përmes :

- *Skuadrave të terrenit,* të cilat janë ngritur për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge në një kalendar daljesh në terren për të monitoruar situatën e fëmijëve që shfrytëzohen për lypje. Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar dhe menaxhuar 17 fëmijë në situatë rrugë.

- *Vizitat në familje* kanë qenë një tjetër mënyrë për verifikimin e rasteve të të gjitha target grupeve në nevojë qoftë fëmijë.

Takimet e Grupeve Multidisiplinare dhe tavolinave teknike.

Periodiciteti i këtyre takimeve është në varësi të ecurisë së rastit. Zakonisht shërbimet sociale ndjekin një periodicitet takimesh 3 mujore për çdo rast.

Takimet e Komisionit të Vlerësimit të Nevojave

Takimet e Komisionit të Vlerësimit të Nevojave ka të bëjë me ofrimin e kujdesit alternativ për fëmijët jashtë kujdesit prindëror dhe vendosjen e tyre në familje kujdestare, apo kur kjo nuk është e mundur në qendra rezidenciale. Kjo është realizuar përmes funksionimit të Komisionit të Vlerësimit të Nevojave përmes të cilit është bërë e mundur vendosja e 5 fëmijëve në Qendra Rezidenciale dhe 9 fëmijëve në familje kujdestare.

Aktivitete Sensibilizuese:

- Aktiviteti në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Diskriminimit.
- Fushata kombëtare Unë Mbroj Fëmijët Prill-Maj-Qershor
- Aktiviteti përmbylles i Fushatës "Unë Mbroj Fëmijët"(aktorët lokale)
- Organizimi i kampeve Verore në bashkëpunim me shoqatat lokale Ndihmë për femijët, Worls Vizion, Ndihmë për Ballkanin, Animatorët Orionin, kampet verore për fëmijë ku u përfshinë rreth 1000 fëmijë.

Fëmijët jetim:

-Numro i fëmijëve që jeton me një prind _124

-Numri i fëmijëve pa asnjë prind _23

-Institucionet për fëmijët jetim dhe lloji i shërbimeve që marrin: Fëmijët jetim të braktisur nga prindërit dhe jetim biologjik marrin shërbim nga 2 qendra rezidenciale. Këta fëmijë marrin paketën e shërbimit rezidencial.

Tab. 6 - Fëmijët me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike viti 2016

Grup-mosha	Aftësi e kufizuar e lindur	Aftësi ekufizuar e fituar gjatë jetës
0-3 vjec	233	32
4-18 vjec	471	334
Totali	704	366

Burimi i informacionit: Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunës në Familje, Bashkia Elbasan

Tab. 7 - Fëmijët që përfitojnë nga shërbimet sociale

Fëmijët	Numri afërsisht 60000 fëmijë në nivel Bashkie
Fëmijët që punojnë	32 (të identifikuar nga NJMF)
Fëmijët e trafikuar apo në rrezik trafikimi	11 raste në rrezik trafikimi (identifikuar nga NJMF)
Fëmijë të paregjistruar	5 fëmijë (të identifikuar nga NJMF)

Burimi i informacionit: Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunës në Familje, Bashkia Elbasan

-Shërbimet që ofrohen për fëmijët:

Shërbime publike:

Bashkia Elbasan aktivitetin në ndihmë të fëmijeve e mbështet në disa nga dokumentat kryesore në këtë fushë siç janë: neni 54 i Kushtetutës së Shqipërisë; Konventa për të Drejtat e Fëmijëve miratuar nga Asambleja e Përgjithëshme e OKB në 20 Nëntor 1989 dhe ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 1992; ligji nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"dhe "Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar i Veprimit për fëmijet për periudhen 2005-2010".

Risi është krijimi i Zyrës per Mbrojtjen e Fëmijëve si pjesë e sektorit të programimit social dhe Drejtorisë së Kujdesit Social. Ngritja e kësaj zyre bën që shërbimet sociale publike të luajnë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e fëmijeve dhe gjithashtu të bëhet i mundur dhe krijimi i një sistemi informacioni mbi situatën, nevojat e fëmijëve me probleme sociale si dhe shërbimet e ofruara ndaj tyre. Zyra e Mbrojtjës së Fëmijëve në bashkinë Elbasan në zbatim edhe të ligjit Nr.10 347 datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" është një ofrues publik shërbimesh sociale për fëmijët, qoftë drejtpërdrejt apo të koordinuara në rrjet, të cilat synojnë të përmbushin dhe respektojnë parimet dhe kriteret e përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë, në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës dhe akte të tjera për respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Q.K.R. (Qendra Komunitare Rome) – (lagja e romëve në Rrapisht)

Kjo qëndër është ngritur në vitin 2004 nga fondacioni "Soros", aktualisht menaxhohet dhe drejtohet nga Bashkia Elbasan. Ofron mbështetje edukative dhe arsimore për fëmijët dhe të rinjtë për njohjen e gjuhës Rome dhe Shqipe si dhe zhvillon elemente të traditës të komunitetit nëpërmjet kurseve dhe aktiviteteve komunitare.

Arsimi

Arsimi parashkollor i cili përfshin fëmijët e moshës 3-6 vjeç përfaqësohet nga 21 kopështe publike të cilët janë në funksion të plotë. Numri i fëmijëve që frekuentojnë këto kopshte është rreth 2204 fëmijë prej të cilëve 1042 janë vajza. Kopshtet jo-publike janë një tjetër shërbim që i ofrohet fëmijëve të

qytetit, janë 5 kopshte jo-publike me 370 fëmijë prej të cilëve 192 janë vajza. Tendenca është për një përfshirje sa më të madhe të fëmijëve frekuentues.

Arsimi i detyruar realizohet në shkollën 9-vjeçare. Aktualisht funksionojnë 19 shkolla qendër dhe 2 shkolla vartesë me 10.539 nxënës dhe 3 shkolla të sistemit jo-publik me 580 nxënës të cilët përbëjnë në total afro 9% të popullsisë.

Arsimi special përfaqësohet nga shkolla 9-vjeçare "Zëra Jete" e cila ofron mësim për 75 nxënës me aftësi të kufizuara me programe të veçanta sipas aftësisë së tyre.

Arsimi i mesëm përfaqësohet nga 18 shkolla 5 prej të cilave jo-publike; të cilat i ndjekin 8237 nxënës, që përbëjnë 6.6% të popullsisë e ku 3726 janë femra. Ndërkohë që 6 shkolla janë të profilizuara në mbi 16 specialitetë, ndërsa të tjerat kanë sistemin e përgjithshëm.

Shëndetësia

Sistemi shëndetësor përbëhet nga shërbimi parësor; shërbimi spitalor dhe ai farmaceutik. Shërbimi parësor përbën pjesën më të rëndësishme dhe përfaqësohet nga qendrat shendëtesore dhe ambulancat e lagjeve të cilat kanë dhe kontaktin e parë me të sëmuret. Ky shërbim lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e objektivave në fushën e përkujdesjes për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Ndërsa shërbimi spitalor përfaqësohet nga Spitali civil me repartet sipas specialiteteve ku përfshihet dhe Pediatria (reparti për fëmijet) dhe spitali Psikiatrik "Sadik Dinci" me repartet përkatëse sipas grup-semundjeve mendore dhe psiqike.

Shërbimi i trajtimit të fëmijëve me ç'rregullime të spektrit autik

Shërbimi i qendrës autike për fëmijët me ç'rregullim të spektrit autik (ÇSA)"Fluturo për Jetën" ka si qëllim të ofrojë një shërbim ndihme, përkrahje dhe në raport me shërbimet e përshtatshme për të ndihmuar procesin e integrimit social dhe të zhvillojë një funksion psiko-edukativ mbi çdo fëmijë në veçanti. Ky shërbim shtrihet jo vetëm në qendër por dhe në çdo familje që ka nevojë për këtë shërbim (lokalizuar në qytetin e Elbasanit). Qëllim kryesor është integrimi i fëmijëve me ÇSA në çerdhe, kopshte dhe shkolla dhe informimi i edukatorëve dhe mësuesve rreth këtij ç'rregullimi dhe se si t'i integrojnë fëmijët me ÇSA në ambjentet sociale.

Shërbimet që ofron qendra janë:

- Terapi individuale me programin e ABA, ka si qëllim integrimin e fëmijëve me ÇSA në komunitet
- Terapi individuale dhe në grup
- Shërbimin e logopedisë
- Shërbimin e fizioterapisë
- Shërbimin e psikologëve vullnetarë për të shoqëruar fëmijët nëpër çerdhe, kopshte apo dhe shkolla
- Informimin dhe sensibilizimin e komunitetit.

- Këshillimin e prindërve, që ka si qëllim mbështetjen e tyre psiko-emocionale.

Shërbimet jo-publike

Në qytetin e Elbasanit funksionon një rrjet i gjerë i ofruesve jo-publik të shërbimeve për fëmijë. Kontributi i tyre është i rëndësishëm për komunitetin e këtij qyteti.

➢ **Shoqata "Tjetër VIZION"** Shërbimet që ofron për fëmijët:

-Shërbim rezidencial për fëmijët viktima të trafikimit

-Shërbim emergjence për fëmijët viktima të trafikimit

➢ **Fondacioni Ndihmë për Fëmijët** është

- Një organizatë kombëtare pro-aktive në sektorët e arsimit, integrimit social dhe zbutjes së varfërisë, duke mbështetur fëmijët në nevojë, familjet dhe komunitetet e tyre përmes zbatimit efektiv të projekteve dhe programeve të financuara nga qeveria, donatorët ose nga të ardhurat e saj të cilat kontribuojnë në strategjitë lokale dhe kombëtare dhe integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

➢ Fondacioni **World Vision ,** ofron shërbime për fëmijët dhe të rinjtë në drejtim të:

- Mbrojtjes
- Edukimit
- Ndihmë për familjet në nevojë (sponsorship)
- Programi i te rinjve

➢ **Fondacioni Ndihmë për ballkanin (A2B)** Shërbimet që ofron:

- Qendrat ditore për fëmijë **"Një jetë tjetër"** dhe **"Shpresë për të ardhmen"**
- Qendër ditore për femijë dhe të moshuar
- Shërbime familjare /mbështetje familjeve në nevojë
- Kudejstari në distancë
- Ndihmë Humanitare
- Ndihmë Financiare
- Këshillim, Shërbime në Komunitet

➢ **Fondacioni "Orët fatlume "Ndihma e Vailheimit për Shqipërinë** Shërbimet që ofron:

- Shtëpia e fëmijës,rezidenciale "Orët Fatlume", per femije nga 6-14 vjec

- Kopshti i fëmijëve "Fritz Sommer"

➢ **Fondacioni : Motrat e Nënë Terezës** Shërbimet që ofron:

- Qendër rezidenciale për fëmije nga 0-6 vjeç.
- Ndihmë humanitare dhe mjekësore

➢ **Fondacioni: "Qendra e bashkëpunimit ndërkombëtar"** (IC) Shërbimet që ofron:

- Ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes financiare mujore në ushqime për fëmijët të cilat kanë humbur njërin apo të dy prindërit, me apo pa status jetimi dhe familjet me probleme të theksuara sociale- ekonomike për të përmirësuar gjendjen e tyre.
- Kurse të gjuhës angleze dhe arabe.
- Kurse kompjuteri.

➢ **Fondacioni : PAUL RITZAU** Shërbimet që ofron:

- Mbështetje për njerëzit të cilët si pasojë e gjendjes së tyre trupore, mendore apo shpirtërore janë të varur nga ndihma e të tjerëve apo janë në një gjendje mjaft të rëndë ekonomike.
- Suport në medikamente për fëmijët e sëmurë.
- Nxitja dhe përmirësimi i përkujdesjes shëndetësore p.sh. me anë të ndihmës në pajisjen e spitaleve, ambulancave mjekësore, përkujdesjes së pacientëve si dhe mbështetje për mjekët dhe infermierët.

➢ **Qendra " Future for You"** është organizatë jo-fitimprurëse që ofron mbështetje për fëmijët me aftësi ndryshe:

- Qendra ofron këshillim dhe informacion për prindërit dhe kujdestarët e personave me Sindromën Daën.

➢ **Fondacioni "Të rinjte në mision"** ***(Rrapisht lagja Rome):***

Ka si objektiv forcimin dhe integrimin e fëmijeve dhe të rinjve rom, në mënyrë që antarët e këtij komuniteti të jenë pjesëtare të respektuar të shoqërisë e duke ruajtur kulturën e tyre dhe duke qenë të lirë për ta shprehur atë. Shërbimet që ofrohen:

- Drekë për fëmijët Rom
- Aktivitete psiko-sociale dhe kulturore-artistike.
- Asistencë sociale për fëmijët dhe familjet.

2. Ndihma Ekonomike

Për vitin 2016 janë trajtuar një numër në rritje të familjeve nga 5350 familje në Janar në 6470 familje në Dhjetor 2016 me një fond gjithsej 245,256,883 lekë.

Gjatë kësaj kohe përgjithësisht kanë fituar rreth 90% e aplikantëve dhe 10% janë refuzuar.

Tab. 8 – Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike ndër vite

Indikatorët/Vitet	2013	2014	2015	2016
Nr. i familjeve që aplikojnë për ndihmë ekonomike	8560	7250	7950	7822
Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike	8223	6974	7494	6470
Femra	378	197	328	817
P.Etnitë(rom)	187	175	189	195
PAK	216	139	136	159
Jetim	10	19	19	17

Burimi i informacionit: Sektori i Ndihëms Ekonomike, Bashkia Elbasan

Tab. 9 - Të dhëna për ndihmën ekonomike ndër vitet 2013-2016

Viti	Numri mesatar i familjes në ndihmë ekonomike	Fonde faktike vjetore	Përqindja e dhënies së fondeve	Paga mesatare e familjeve
2013	2452	124.500.203	100	4231
2014	2138	112.104.105	100	4369
2015	5523	236.087.121	100	3562
2016(Tetor)	5941	253.765.480	100	4271

Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar.

3. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar.

Bazuar ne ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" me vendim të veçantë të këshillit bashkiak mund të përdoret deri në 3% (nga 1.09.2016 bëhet 6%) të fondit të deleguar për të trajtuar familje të varfëra të cilat për shkak të kushtëzimeve të sistemit elektronik nuk perfitojnë nga ndihma e zakonshme por që janë shumë të varfëra.

Kështu Bashkia Elbasan bazuar ne VK Bashkiak nr.42 datë 25.10.2011 nisur dhe nga problematika të varfërisë shumë prezente ka vazhduar të trajtojë një numër të konsiderueshëm familjesh me këtë mënyrë.

4. Ndihma ekonomike nga të ardhurat e bashkisë.

Është një procedurë e përcaktuar edhe në ligj dhe e diktuar nga varfëria dhe papunësia e lartë si dhe nga problemet sociale nga më të ndryshmet si dhe nga kushtëzimi i përdorimit të 3% të fondit të deleguar. Këtë vit këshilli bashkiak ka vënë në dispozicion rreth 2.5 milion lekë për këtë qëllim dhe kanë përfituar rreth 65 familje shumë të varfëra e me probleme sociale qe nuk përfitojnë nga programi elektronik i ndihmës së zakonshme.

-Ndihma ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë:

Kriteret specifike të bashkisë për familjet që do të trajtohen me këto fonde:

1.Familje shumë të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.

2.Familje me mungesë dokumentacioni për shkaqe të ndryshme (psh gjendje civile në një tjetër qytet etj).

3.Familje me problem sociale ku mungon njeri prej bashkëshortëve (braktisje e familjes)

Tab. 10 - Fond i pagesës së dhënë nga bashkia sipas muajve dhe numrit të familjeve gjatë vitit 2016

Muajt	Nr. i familjeve	Fondi i pagesës
Mars	**81**	**210.000**
Prill	**81**	**210.000**
Maj	**81**	**210.000**
Qeshor	**65**	**210.000**
Korrik	**65**	**210.000**
Gusht	**65**	**210.000**
Shtator	**65**	**210.000**
Totali		**1.470.000**

Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, Bashkia Elbasan

5. Aftësia e kufizuar

a.Përfshin në programin e saj dhënien e pagesave kesh për personat e përcaktuar si me aftësi të kufizuar nga ana fizike dhe mendore që nuk lidhen me shkaqe punësimi, nga komisioni përkatës (KMCAP) që funksionon pranë drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore. Baza ligjore VKM nr.618 datë 7.09.2006. Për personat me kufizime të rënda perfitohet pagesa edhe për një kujdestare (Grupi i parë).

b.Pagesat për shkak të verbërisë.

Baza ligjore VKM nr.277 datë 18.06.1997 "Përfitimet nga statusi i të verbërit".

Vlerësimi i nivelit të aftësisë së tyre bëhet nga KMPV që funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Shërbimit Social Shteteror.

Pgesa aktuale është 11.510 lekë në muaj.

Nga ana e Bashkisë Elbasan gjatë ketij viti janë trajtuar 608 persona dhe 152 kujdestare.

c.Pagesat per personat paraplegjike dhe tetraplegjike.

Janë persona që trajtohen mbi bazën e VKM nr.31 datë 20.01.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit para e tetraplegjike".

Vlerësimi i tyre bëhet nga KMCAP vendore dhe konfirmohen nga Shërbimi Social Shtetëror (persona që nuk levizin për shkak mosfunksionimit të dy anësive ose te katër anësive).

Pagesa aktuale është 10.140 lekë për personin me këtë aftësi të kufizuar dhe 10.650 lekë peë kujdestarin.

Këta persona përfitojnë edhe pagesë për pajisje higjeno-sanitare në masën 16.000 lekë në muaj për person.

Gjatë vitit 2016 janë trajtuar 299 persona e 298 kujdestare.

Tab. 11. Numri i personave me aftësi të kufizuar dhe fondet e dhëna në vitet 2013-2016

Vitet	Nr. e personave me AK	Fondet nga Buxheti i Shtetit
2013	3025	467.921.575
2014	2688	592.596.850
2015	4759	654.218.421
2016(Tetor)	4850	700.116.254

Burimi i informacionit:Drejtoria e Shërbimit te Kujdesit Social dhe Komunitar.

Në fushën e aftësisë së kufizuar për 2016 kemi:

15 raste të fëmijëve jetimë nga babai dërguar tek shoqata ALSAR

Për 3 të moshuar është ndjekur gjithë procedura deri në vendosje në Qendra rezidenciale.

Vizitat në familje kanë qenë një tjetër mënyrë për verifikimin e rasteve të të gjitha target grupeve në nevojë qoftë të moshuar apo persona me AK apo pjestarë të komunitetit rom apo egjiptian.

Gjatë këtij viti janë realizuar rreth 22 vizita në familje për rastet e identifikuara.

Aktivitete Sensibilizuese:

- Aktiviteti në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër diskriminimit.
- Aktiviteti me rastin e 8 Prillit promovimi i të drejtave të komunitetit Rom

d. Pagesat për Invalidët e Punës.

Baza ligjore VKM nr.869 datë 18.06.20018 "Për përfitimet në formë të ndihmës ekonomike nga statusi i invalidit të Punës".

Janë përfitues ata persona që janë përcaktuar si të tillë nga KMCAP-i rrethit për shkaqe që lidhen me punësimin (Pra për shkak të kontributeve të sigurimeve shoqërore); por që përvec trajtimit nga ky institucion marrin edhe një pagesë shtesë në formën e ndihmës ekonomike pranë njësive vendore.Pagesat e tyre variojnë nga 2200 lekë në muaj në 2700, 3300 dhe 4000 lekë në muaj sipas grupeve të invaliditetit.

Tab. 12 - Numri i invalidëve të punës dhe fondet e dhëna gjatë viteve 2013-2016

Vitet	Nr. i personave invalid pune	Fondet nga Buxheti i Shtetit
2013	**3697**	**129.797.100**
2014	**3929**	**153.258.800**
2015	**5521**	**178.629.000**
2016(tetor)	**5437**	**159.892.200**

Burimi i informacionit:Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar.

Tab. 13 - PAK sipas grup-moshave dhe shpërndarja sipas kategorive të sëmundjeve

Grup-mosha	Sëmundje e lindur	Sëmundje e fituar	Me ndihmë ekonomike	Gjithësej në kujdestari
0-3 vjec	**233**	**32**	**25**	**25**
4-18 vjec	**471**	**334**	**156**	**140**
19-21	**229**	**129**	**60**	**30**
22-60	**1456**	**964**	**260**	**239**

Mbi 60-	3	95	58	29
Totali	2392	1554	559	463

Burimi i informacionit:Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, Bashkia Elbasan

Për të gjithë programin e aftësisë së kufizuar për vitin 2016 janë shpenzuar gjithësej 704,884,243 lekë

-Shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuar sipas Sektorit të Shtresave në Nevoje dhe Moshës së Tretë.

Shërbimet Publike:

- Qendra Sociale Balashe
- Qendra e Autizmit
- Shkolla Speciale 'Zera Jeta'

Shërbimet jo-publike:

- Q.Sh.I.Nj.N.V (Qendra Shqiptare per Integrimin e Njerezve me Nevoja te Vecanta)
- Sh .Verbër Shqiptare
- Sh.Para e Tetraplegjikëve
- Future For You

6. Gratë.

Tab. 14 - Ndarja e grave sipas problematikave për 2016

Problematikat	Numri
Gra viktima të dhunës në shtëpi	42 raste të pajisura me UM (identifikuar nga Nënpunsi Gjinor pranë Sektorit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunës në Familje.
Gra viktima të prostitucionit	5 raste (identifikuar nga Nënpunsi Gjinor pranë Sektorit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunës në Familje)

Burimi i informacionit: Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunës në Familje, Bashkia Elbasan

-Shërbimet që ofrohen për gratë:

Shërbimet Publike: Nëpunëse për barazinë gjinore dhe dhunën në familje që ndodhet pranë Sektorit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunës në Familje, që adreson dhe zgjidh çështjet problematike të grave.

Shërbimet Jo-Publike:

- **Tjetër Vizion. Shërbimet që ofron për gratë:** Qendra për gra dhe vajza në vështirësi, e përbërë nga:
  - Qendra ditore për gra e vajza (lagjia "Aqif Pasha", Rr. "Ali Arapi", nr.19 Elbasan)
  - Qendra profesionale e liçensuar nga QKR (kurse parukerie, kurse rrobaqepsie, kuzhine dhe gjuhë të huaj, lokalizuar në lagjen "Aqif Pasha", Rr. "Ali Arapi", nr.19 Elbasan)
  - Ndërmarrja Sociale: qendra për asistencë teknike dhe bujqësore, lokalizuar në njësinë administrative Mollas.
  - Laboratorin për matjen e cilësisë së ujit, ajrit, tokave dhe prodhimeve të bimëve in-vitro (lokalizuar në lagjen "Aqif Pasha", Rr. "Ali Arapi", nr.19 Elbasan)

Shoqata Tjetër Vizion është anëtare e *Komitetit Rajonal Antitrafik* dhe *Grupit Multidisiplinar* në nivel Bashkie e qarku që trajton çështje si dhunën në familje dhe çdo lloj problemi social të grupeve të marxhinalizuara.

- **Fondacioni "Ndihmë për fëmijët"** (NPF) që prej vitit 1998 ofron shërbime sociale të decentralizuara për gratw, fëmijët, familjet dhe komunitetet në nevojë në lidhje me arsimimin, formimin profesional, punësimin dhe aktivitete të gjenerimit të të ardhurave si dhe ngritje të kapaciteteve të punonjësve të sektorit të shërbimit social publik vendor.

- **Shoqata "Ndihma e Weiheimit për Shqipërinë"**

Aktualisht Shoqata "Ndihma e Weiheimit për Shqipërinë" e ushtron veprimtarinë e vet në disa projekte të ndryshme për grate si më poshtë:

- Qendra rezidenciale për vajza Shtëpia "Antonia"
- Qendër formimi profesional për gra e vajza

- **Forumi i Gruas, Elbasan**

Forumi i Gruas Elbasan ofron prej vitesh shërbime konkrete për gratë me probleme dhune. ***Qendra e Këshillimit, Studio Avokatore*** dhe ***Qendra e Kujdesit Ditor*** (strehëza e emergjencës) janë të vetmet që ofrojnë këtë shërbimnë Qarkun e Elbasanit, ndërsa ***Qendra e Kujdesit Ditor*** është shërbim i vetëm i këtij lloji në gjithë Shqipërinë.

-Qendra e Këshillimit, ofron shërbime falas në ndihmë të grave/vajzave me probleme dhune dhe social-ekonomike në Qarkun e Elbasanit, por edhe nga qarqet e tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj. Shërbimet e ofruara nëpërmjet psikologes/ punonjëses sociale, janë:

- Ndërmjetësim me familjarët dhe përfituesit për gjetjen e alternativave drejt zgjidhjes së problemeve.

- Ndërmjetësim në qendrën e Formimit Profesional, në Biznesin Lokal.
- Informim, orientim dhe referim të rasteve për shërbime të tjera alternative të nevojshme të ofruara nga aktorë të tjerë vendorë (publikë dhe jopublikë).

-Studio Avokatore

- Konsulencë juridike, e cila jepet në rastet kur përfituesja kërkon të sqarojë një problem ligjor.
- Hartimi i akteve juridike, drejtuar gjykatës për fillimin e çështjeve gjyqësore (kërkesë padi, kërkesa ankimore, etj.) apo drejtuar institucioneve publike për sigurimin e informacionit të nevojshëm për proces gjyqësor (prova shkresore)
- Mbrojtje ligjore me avokat për të gjitha përfitueset, që janë viktima të dhunës në familje

-Qendra e Kujdesit Ditor (sheltër emergjence) është e vetmja në gjithë Shqipërinë. Kjo qendër lindi si nevojë e asistimit dhe mbështetjes së grave të dhunuara, të cilat denoncojnë dhunuesit e tyre, janë në rrezik dhe kërkojnë të pajisen me Urdhërin e Menjëhershëm të Mbrojtjes.

➢ **Në Dobi të Gruas Shqiptare, Elbasan**

Shoqata "Në Dobi të Gruas Shqiptare" operon në Qytetin e Elbasanit duke ofruar shërbime sociale, rritje kapacitetesh dhe integrim të komuniteteve në nevojë:

- Mbështetje social-psikologjike për gratë dhe vajzat nëpërmjet bisedave në grup dhe individuale.
- Përkujdesje shëndetësore.
- Kurse profesionale (rrobaqepësi, parukeri, kuzhinë, kompjuter)
- Nxitje për punësim duke bashkëpunuar me agjensinë e punësimit, me bizneset, pushtetin lokal.
- Fuqizimi dhe integrimi i komunitetit rom (grave rome) dhe parandalimi i konflikteve
- Fushata sensibilizuese (kundër dhunës në familje, abuzimit me fëmijët, trafikimit të qënieve njerëzore)
- Kurse informative me juristë (të drejtat e njeriut, të fëmijëve, kodin e familjes)
- Aktivizimi i prindërve (në përgatitjen e ushqimit për fëmijët, në pastrimin dhe mirëmbajtjen e qendrës)

Edhe NPF jep shwrbime pwr fuqizimin e grave dhe vajzave rome dhe egjyptiane si lehtwsim pwr formim profesional, punwsim, fuqizim ekonomik pwrmes aktiviteteve pwr gjenerim tw ardhurash.

➢ **Fondacioni Ndihmë për Ballkanin (A2B) Shërbimet për gratë:**

- Shërbime familjare.
- Mbështeje ekonomike për gratë e veja apo të divorcuara.

4.5 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime sociale

Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitari në Bashkinë Elbasab ka bërë dhe bën përpjekje e maksimale për të përmbushur nevojat e popullatës për shërbime sociale duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet lokale apo dhe qëndrore, por hendeku i plotësimit të këtyre nevojave është akoma në dukje.

Një kontribut të madh në plotësimin e nevojave sociale të popullatës kanë dhënë organizatat jo-qeveritare që veprojnë në territorin e Bashkisë së Elbasanit. Trajtimi i probleme sociale që ka bashkia jonë kërkon kohë dhe ne jemi një bashki suksesi në trajtim e këtyre problemeve për faktin që kemi arrit të hartojmë një Plan Social që evidenton nevojat e komunitetit dhe parashtron ndërhyrjet si nga ana e institucioneve të shtetit ashtu edhe nga organizatat jo-qeveritare.

Shërbimi social i bashkisë do marrë një vëmendje më të madhe në vazhdim për faktin se në çdo njësi administrative do të ngrihen **"Njësitë për Vlerësimi dhe Referimin e Rasteve"** të përbërë nga sektori i pagesave cash (ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar etj) dhe sektori i përkujdesit dhe përfshirjes sociale (shërbimet sociale në komunitet, rastet e dhunës në familje, rastet e abuzimit dhe problematikave të fëmijëve). Propozohet të përfshihen në këtë njësi, njësitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësi i dhunës në familje, si dhe të përcaktohen nëpunësit zbatues për programet e riintegrimit social. Me ngritjen e kësaj njësie vetë bashkia dhe organet e saj do jenë më afër problemeve të komunitetit, me qëllim zgjidhjen e tyre.

Funksionet kryesore të NJVNRR/sektori i përkujdesit social janë identifikimi i rasteve; këshillimi dhe hartimi i planeve individuale të përkujdesjes; ndërmjetësimi dhe referimi në shërbime sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar; si edhe ndjekja, monitorimi dhe vlerësimi i rasteve. Kjo njësi do të funksionojë si një zyrë që ofron të gjitha shërbimet me një ndalesë dhe të shërbejë si një pikë kryesore hyrjeje për qytetarët që mundëson referim të menjëhershëm të rasteve në bashkëpunim me Drejtoritë e Shërbimeve Shoqërore në nivel bashkie. Kjo mund të shërbejë për të përmirësuar bashkërendimin dhe mekanizmat e referimit si edhe administrimin e rasteve.

Hapja e kësaj njësie paraqet për bashkinë një sfidë për të bërë menaxhimin e saj sipas standarteve, nisur që tek stafi apo edhe tek shërbimet që duhet të ofrojë. Bashkia do të rrisë numrin e punonjësve që ofrojnë shërbime të kujdesit social për të zgjidhë sa më shpejt që është e mundur problemet në komunitet. Punonjësit socialë do të jenë figurat profesionale në njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, që do të jenë përgjegjës për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve.

Punonjësit socialë do të jenë anëtarë të Urdhrit të Punonjësve Socialë dhe kësisoj do të përmbushin detyrimet për sa i përket kualifikimeve, etikës dhe cilësisë së ushtrimit të profesionit në dhënien e shërbimeve të përkujdesit social. Kualifikimi nënkupton kualifikimin bazë që jep të drejtën për anëtarësimin në urdhër dhe kualifikimin në vazhdim nga programe të miratuara nga MMSR.

Nevojat e stafit ekzistues

Nisur nga vlerësimet që janë bërë për stafin e Bashkisë Elbasan, rezulton të jetë një bashki me staf të kualifikuar dhe të dedikuar në shërbimet që ofron. Megjithatë nevoja për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e tyre mbetet e përhershme për faktin e ndryshimeve që ndodhin me kalimin e viteve dhe në kuadrin e reformës territoriale.

Përmirësimi i mekanizmave dhe kapaciteteve profesionale nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin është një mundësi e mirë për bashkinë që të ofroj shërbime sa më koherente dhe me standarte. Plotësimi i nevojave të popullatës është prioriteti i punës së Drejtorisë së Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, duke qenë se edhe nevojat ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin, stafi shprehet i gatshëm që ti mbulojë këto nevoja me një shërbim të kualifikuar.

Një sfidë tjetër që paraqitet është menaxhimi apo monitorimi i bashkisë për organizatat që ofrojnë shërbime të kujdesit social. Bashkia ka në fokus të saj plotësim e nevojave sociale dhe normalisht mirëpret organizatat jo-qeveritare që të japin kontributin e tyre duke ju garantuar terrenin. Por bashkia nga ana tjetër merrë përgjegjësinë që këto organizata që ofrojnë shërbime të kenë staf të kualifikuar për plotësimin e nevojave të popullatës në mënyrë profesionale.
Ajo çfarë vërehet është që organizatat që veprojnë në Bashkinë Elbasan është se shoqatat të konsoliduara ndër vite kanë staf të kualifikuar për ofrimin e shërbimeve dhe realizojnë trajnime të vazhdueshme për përmirësimin e kapaciteteve të tyre.

4.6 BURIMET FINANCIARE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE NË BASHKINË ELBASAN

Shërbimet Sociale, shpesh herë ndodh që të mos jenë prioritet i politikave qeverisëse dhe kjo shprehet nga buxheti i kufizuar që iu vihet në dispozicion ne total dhe duke e krahasuar si me buxhetin e shtetit ashtu edhe me buxhetin e bashkisë.

Për Bashkinë e Elbasan mund të themi, se ka një rritje në buxhet për sa i përket buxhetit të vënë në dispoziocion për shërbimet sociale dhe kjo rritje është vjetore, megjithëse nuk është shumë e madhe. Ndryshimet në Ligjin e Buxhetit, i kanë deleguar bashkive kompetenca të reja dhe fleksibillitet sa i përket menaxhimit të fondeve sipas nevojave, por për shkak se nuk është miratuar ende si ligj, veprohet me ligjin e vjetër, që do të thotë se bashkia nuk mund t'i përdorë fondet për nevojat e shërbimeve që ka.

Burimet financiare për shërbimet sociale ofrohen pjesa më e madhe nga qeveria qëndrore që janë buxhetet që miraton qeveria për shpërndarje në secilën bashki për plotësimin e këtyre shërbimeve. Qeveria qendrore është ofruesi më i fuqishëm i shërbimeve sociale, nëpërmjet programeve të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, arsimimit dhe kujdesit shëndetësor. Është përgjegjësia e saj të menaxhojë, kordinojë, financojë e mbikëqyrë zbatimin e politikave sociale.

Qeveria vendore është aktor kyç, në sigurimin e shërbimeve sociale dhe kompetencat e saj janë duke u rritë hap pas hapi nëpërmjet decentralizimit, por buxhetet për këto shërbime ngelen akoma shumë të limituara.

Bashkia me vendimet e këshillit bashkiak është përfshirë në realizimin dhe plotësimin e nevojave që paraqet komuniteti për shërbime sociale, në dhënien e pagesave në cash për individët apo familjet në nevojë duke menaxhuar në këtë formë kryesisht buxhete qe vijnë nga buxheti i shtetit.

4.7 SHOQATAT DHE SHËRBIMET E PËRKUJDESJES SOCIALE NË BASHKINË ELBASAN

Shërbimet e përkujdesjes sociale sipas përkufizimit ligjor janë një *"sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësirash, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jo publike, me qëllim sigurimin e mirëqenies dhe përfshirjes shoqërore të individëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror"*. Në Bashkinë e Elbasanit këto lloj shërbimesh, të cilat shkojnë në drejtim të grupeve më të rrezikuara sikurse janë: fëmijët, gratë, të rinjtë, të moshuarit, Personat me Nevoja të Veçanta si edhe etnitë Rome dhe Egjiptiane, ofrohen nga dy sektorë kryesorë: sektori publik dhe sektori jo-publik.

Në të gjithë qarkun e Elbasanit ka 27 OJQ që ofrojnë shërbime sociale: 7 janë lokale; 13 rajonale, 4 kombëtare dhe 3 ndërkombëtare. 10 nga këto OJQ punojnë me fëmijët, 2 me çështjet e rinisë, 6 për personat me aftësi të kufizuar, 1 me të moshuarit, 3 për gratë dhe dhunën në familje, 3 (kujdesi social, fëmijë dhe shërbime në familje) dhe 2 për komunitetin rom.

Në kuadrin e hartimit të këtij Plani Social janë marrë në konsideratë shërbimet e përkujdesjes sociale të ofruara nga sektori jo-publik, apo i njohur ndryshe edhe si sektori i organizatave të shoqërisë civile, meqënese janë ato që ofrojnë shërbimet e tyre në zonën e Elbasanit dhe mbizotërojnë jo vetëm në numër, por edhe në llojshmërinë e shërbimeve që ofrojnë në dobi të personave vulnerabël, krahasuar me sektorin publik, i cili rezulton të jetë më i kufizuar. Kështu, bazuar tek Plani Social i Zonës Elbasan (2011) numri i organizatave të sektorit jopublik arrinte në 18 të tilla, ndërsa në një raport të vitit të fundit (2016) rezulton një rritje e numrit të Organizatave Jo-Fitimprurëse në 22. Pra, sektori jo-publik, përtej sfidave që mund të hasë në ushtrimin e veprimtarisë së tij, duket se e ka të qartë rrugën që duhet të ndjekë dhe po zgjeron territorin e tij, mirëpo fakti që kanë zgjeruar shtrirjen e tyre mund të lidhet edhe me impaktin pozitiv që kanë pasur në shoqëri për përmirësimin dhe zhvillimin e kësaj të fundit. Me të drejtë rrjeti i organizatave të shoqërisë civile është përshkruar si "rrjet i fuqishëm, që vepron në fushën sociale dhe ofron shërbime të mirëfillta dhe cilësore për grupet më të shfaqura ndaj riskut" pasi ka evidenca për punën dhe arritjet që janë bërë në shërbim të përsonave në kushte të vështira socio-ekonomike, por jo vetëm.

Klasifikimi i organizatave në bazë të target-grupeve dhe shërbimeve që ofrohen

Në mënyrë që të njohim shkurtimisht organizatat, ashtu sikurse ato identifikohen nga njëra-tjetra, duhet të mbajmë në konsideratë se këto shoqata kryesisht janë të ndara në bazë të target-grupeve që kanë në fokus të tyre dhe shërbimeve që ofrojnë për këto grupe, por nga ana tjetër nëse i klasifikojmë në bazë të shërbimeve që ato ofrojnë do të kishim një ndarje të organizatave në organizata që ofrojnë

shërbimet ditore; rezidenciale; komunitare, ndonëse nuk ka një ndarje të mirëpërcaktuar, pasi mund të gjenden elementë të gërshetuar në varësi të situatave të ndryshme dhe emergjencës së këtyre të fundit.

Meqënëse klasifikimi i organizatave sipas grupeve target e pëfshin edhe klasifikimin sipas shërbimeve që ofrohen do të mbështetemi tek ndarja sipas target grupeve. Në këtë mënyrë, kemi:

Organizatat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mbrojtje të fëmijëve dhe të drejtave të tyre:

1) Shoqatën **"Tjetër Vizion",** e cila shërben si qëndër rezidenciale dhe ofron shërbime për fëmijë, si qëndër ditore, kujdestari në distancë, ndihmë financiare, këshillim dhe shërbime në komunitet. Kjo shoqatë është hapur në vitin 2002 dhe ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të vazhdueshme, udhëhequr nga misioni i "ofrimit të shërbimeve cilësore në fushën sociale, bujqësore e shëndetësore, për kategoritë në nevojë të shoqërisë, me qëllim përmirësimin e jetës së tyre dhe të mbarë komunitetit."
2) Fondacioni **"Ndihmë për fëmijët"** (NPF) që prej vitit 1998 ofron shërbime sociale të decentralizuara për fëmijët, familjet dhe komunitetet në nevojë në lidhje me arsimimin, formimin profesional, punësimin dhe aktivitete të gjenerimit të të ardhurave si dhe ngritje të kapaciteteve të punonjësve të sektorit të shërbimit social publik vendor.
3) **Shoqata "Në dobi të gruas"**, e cila ofron shërbimet si: qëndër ditore, mbështetje ushqimore, drekë falas për fëmijët e familjeve të varfëra, aktivitete edukuese-argëtuese, njohuri të përgjithshme në matematikë, gjuhë angleze dhe kopjuter. Kjo shoqatë është themeluar në vitin 1993 dhe synon të mbrojë të drejtat e grave dhe të fëmijëve, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore si edhe zhvillimin social të shoqërisë.
4) **Fondacioni "Shtëpia e Shpresës"** që ofron shërbimet e llojit: rezidencial, shërbime ditore, përkujdesje në distancë dhe apartamente të pavarura.
5) **Fondacioni" Ndihmë për Ballkanin" (A2B)**, i cili ofron shërbimet si qëndër ditore, shërbime familjare, kujdestari në distancë, ndihmë-humanitare, këshillim si edhe shërbime në komunitet. Ky fondacion është humanitar dhe ka në fokus të tij ofrimin e shërbimeve për inidvidët, grupet dhe komunitetet më në nevojë, në mënyrë që të zhvillojnë kapacitetet brenda tyre.
6) Fondacioni "Ndihme per femijet" (NPF) qe prej vitit 1998 ofron shërbime sociale te decentralizuara per femijet, familjet dhe komunitetet ne nevoje ne lidhje me arsimimin, formimin profesional, punesimin dhe aktivitete te gjenerimit te te ardhurave si dhe ngritje te kapaciteteve te punonjesve te sektorit te sherbimit social publik vendor.
7) **Organziata "Terre des Hommes"** që ofron shërbime komunitare, mbështetje psiko-sociale, ligjore dhe ekonomike për fëmijët dhe familjet e tyre, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse. Kjo organizatë operon që prej vitit 1993 dhe ka degë të saj edhe në qytete të tjera (Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës etj), të cilat koordinohen dhe bashkëpunojnë në kuadër të ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe komunitetet në nevojë.
8) **Organizata MEDPAK** është organizatë jo fitimprurëse e prindërve të fëmijeve me aftësi të kufizuara në Maj 1993,që mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, me qendër në Tiranë dhe me degë në të gjithë qarqet e vendit, përfshirë dhe Bashkia Elbasan. Shoqata mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara përmes njohjes e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, trajnimit të anëtarëve e më gjërë, sensibilizimit të komunitetit për rritjen e kërkesave

për zbatimin e ligjeve, krijimin e sherbimeve,me qëllim që të arrihet një jetë dinjitoze për të gjithë.

9) **Fondacioni "Orët Fatlume-Ndihma e Vilhelmit në Shqipëri"**, që ofron shërbimet si qëndër ditore, qëndër rezidenciale për fëmijët dhe qëndër rezidenciale për vajzat që kanë mbushur moshën mbi 14-vjeç.
10) **Fondacioni "Dhurata e Dashurisë-Motrat e Nënë Terezës"**, ofron shërbimet qëndër rezidenciale për fëmijët e moshës 0-6 vjeç; ndihma humanitare dhe mjekësore, si edhe aktivitete rekreative si kampet verore.
11) **Fondacioni "Qëndra e Bashkpunimit Ndërkombëtar"**, që ofron shërbime të llojit: ndihmë dhe mbështetje financiare mujore, në ushqime për fëmijët që kanë humbur njërin apo të dy prindërit, qoftë kur janë me status jetimi dhe kanë probleme të theksuara sociale, njëkohësisht përfshihen edhe kurse të gjuhës angleze dhe arabe.
12) **Fondacioni " Paul Ritzau"**, i cili ofron shërbime për njerëit në nevoja ekonomike, të shëndetit fizik apo edhe të shëndetit mendor dhe që janë të varur nga të tjerët. Mobilizimi i bibliotekave të hapura publike dhe mbështetje në ndëritmin e institucioneve shkollore, si edhe nxitja dhe promovimi i përkujdesjes shëndetësore nëpërmjet paisjes së spitaleve me materiale ose përkujdesje për pacientët.

Informacionet më sipër janë për të gjitha ato shoqata të shoqërisë civile që kanë në fokus të tyre punën me fëmijët, megjithatë, nuk është një ndarje arbitrare, sepse problemet sociale dhe kategoritë e grupeve vulnerable janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën dhe prandaj një organizatë që ofron shërbime për fëmijët mund të shfaqet edhe tek organizata që ofrojnë shërbime për grupet e tjera dhe kjo bëhet me qëllim ofrimin e shërbimeve në disa nivele dhe duke përfshirë aktorë që ndikojnë drejtëpërdrejtë apo tërthorazi.

Shoqatat që ofrojnë shërbimet e tyre në drejtim të grave dhe vajzave, të cilat përfshijnë:

1- **"Shoqata në Dobi të Gruas"** e cila në lidhje me këtë target grupofron shërbime për formimin profesional, mbështetje ekonomike, si edhe ndjekje sociale shoqëruar me kurse 9-mujore si parukreri, rrobaqepësi, kuzhinë dhe kompjuter. Pjesë e shërbimeve të ofrura janë edhe njohuritë e përgjithshme në matematikë, anglisht dhe kompjuter; vakt ushqimor pa pagesë në fund të aktivitetit ditor, orë sportive dhe kontroll të vahdueshëm nga mjeku i qëndrës; intershipe në biznese private, ndihma në gjetjen e punës, zhvillimin e aftësive komunikuese dhe sociale, si edhe pjesa e rritjes së ndërgjegjësimit publik.
2- **"Forumi i Gruas Elbasan"**, që ofron shërbimet e këshillimit (të nevojshme për mbështetje emocionale për gratë dhe vajzat viktima të dhunës); informacion juridik dhe mjekësor, si edhe asistencë dhe trajtim psikologjik. Sensibilizimi i komunitetit dhe rritja e ndërgjegjësimit në parandalimin e trafikimit të vajzave është një tjetër aktivitet ku është përqëdruar vëmëendja e këtij forumi.
3- **"Tjetër Vizion"** si shoqatë që ofron shërbimet ditore për gratë dhe vajzat (përfshirë këtu edhe këshillim, grupë diskutimi, aktivitete ludiko-krative); si edhe strehëzën për gratë dhe vajzat (ofron shërbim për gratë dhe vajzat e dhunuara).

4- **Fondacioni Ndihmë për Fëmijët** orgnaizatë kombëtare ofron mbështetje përmes duke mbështetur gratë, familjet dhe komunitetet e marxhinalizuara përmes zbatimit të projekteve/programeve efektive të financuara nga qeveria, donatorët ose nga të ardhurat e saj, të cilat kontribuojnë për strategjitë lokale dhe kombëtare.

Nëse për fëmijët, gratë dhe vajzat ekzistojnë disa shoqata që ofrojnë shërbime, nuk mund të themi të njëjtën gjë për *kategorinë e të moshuarve*, për të cilët vetëm një qëndër jo-publike është në dispozicion, A2B (Ndihmë për Ballkanin), e cila i ofron shërbim rreth 80-100 të moshuarve, që përfitojnë vaktin ushqimor, shërbimin e infermierisë dhe pagesën e recetave të barnave.

Së fundmi *për komunitetin Rom*, organizatat që ofrojnë shërbime janë:

1) **"Fondacioni Ndihmë për Fëmijët" (NPF)** i cili ofron shërbime sociale të decentralizuara për komunitetin rom, fëmijët, familjet dhe komunitetet në nevojë në lidhje me arsimimin, formimin profesional, punësimin dhe aktivitete të gjenerimit të të ardhurave si dhe ngritje të kapaciteteve të punonjesve të sektorit të shërbimit social publik vendor.

2) **Terre des Hommes** është organizata që ka një kontrbut madhor në lidhje me këtë komunitet, sepse ofron që nga mbështetja psiko-sociale, ligjore e deri tek ajo ekonomike për fëmijët dhe familjet e tyre.

Përshkrimi i shërbimeve dhe aktiviteteve që ofrojnë këto organizata (te perdoret kudo njesoj) është i nevojshëm, sepse dokumenton edhe njëherë larmishmërinë e shërbimeve që ofrohen për të gjitha kategoritë vulnerable të përfshira në program, të cilat i prekin të gjitha llojet e shërbimeve duke filluar që nga ato shërbime që mbulojnë nevojat bazë si ushqim e strehim, e për të vazhduar deri tek shërbimet për rritje të kapaciteteve individuale dhe zhvillim personal.

Përfundime

Shërbimet sociale në Bashkinë Elbasan nuk ofrohen vetëm nga strukturat shteterore por edhe nga shoqëria civile, e cila është shumë aktive. Përfshirja e shoqërisë civile ka rritur llojshmërinë e shërbimeve, ka rritur cilësinë dhe numrin e përfituesve në nevojë. Shërbimet për integrimin e grupeve të margjinalizuara të ofruara në Bashkinë Elbasan janë multidisiplinare dhe pjesa e konsiderueshme e tyre ofrohet nga prej organziatat e shoqërisë civile, prandaj edhe kjo e fundit konsiderohet palë e rëndësishme e ofrimit të shërbimeve të përkujdesjes socile, por kurrsesi nuk mund dhe nuk duhet të konisiderohet si një zëvendësim i shërbimeve financuar nga qeveritë lokale dhe qendrore, por partnerë integralë në planifikimin afatgjatë të ofrimit të shërbimeve.

Ky partneritet bazohet tek *parimi i partneritetit* që thekson se funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qëndrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet të tjera jo publike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për grupet e pafavorizuara shoqërore. (do shtohet diku qe ligji i prokurimeve sociale dhe buxhetet te alokuara mjaftueshem do te

ndihmonin qe sherbimet ne pergjithesi te administrohen nga bashkia permes sherbimeve direkte te ofruara nga NGO-te lokale, si mendon?)

Kështu, meqënëse sektori jo-fitimprurës kontribuon dhe ofron shërbime të përkujdesjes sociale, të cilat janë të nevojshme dhe të domosdoshme për t'u ofruar, këtij sektori i duhet dhënë më shumë hapësirë dhe legjitimitet, për vetë faktin se e njohin terrenin, njohin problematikat si edhe kanë besueshmëri ndër komunitetet që veprojnë.

Bibliografi:

- Bashkia Elbasan *"Plani Social i Zonës Elbasan" (2011)*
- Propozimi i Këshillit të Ministrave *Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë. Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.*
- Bashkia Elbasan, *Raport për Elbasanin (2016)*
- Tjetër Vizion *"Plani i veprimit të përfshirjes sociale 2016-2020, Bashkia Elbasan* (2016)

MATRICA E PLANIT SOCIAL PËR BASHKINË E ELBASANIT

Qëllimi 1: Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë	
Objektivi 1.1: Rritja e mbështetjes për familjet e varfëra dhe ekstremisht të varfëra për të ndryshuar situatën e tyre social-ekonomike	
Rezultati/ Produkti	**Aktiviteti**
1.1.1 Transparencë nga sistemi i Ndihmës Ekonomike për mënyrën e përfitimit të kësaj ndihme. 1.1.2 Intergrim i këtyre familjeve në skemat e punësimit 1.1.3 Ulje e numrit të familjeve që janë përfituese nga skema e Ndihmës Ekonomike	1.1.1.1 Asistencë e rritur nga pushteti vendor për të gjitha familjet që aplikojnë për skemën e ndihmës ekonomike. 1.1 .2.1 Takime dhe konsultime me familjet që janë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike për problemet që ata hasin. 1.1.3.1 Bashkëpunim me bizneset për mundësi punësimi, nëpërmjet trajnimeve. 1.1.3.2 Asistencë për plotësimin e saktë të të dhënave për personat që aplikojnë për të përfituar ndihmën ekonomike. 1.1.3.3 Takime me familjet për shqëtësimet që ata kanë në jetën e tyre të përditshme.
Objektivi 1.2: Rritja e kapaciteteve lokale që të adresojnë shërbimet sociale në varësi të nevojave që ka popullata.	
Rezultati/ Produkti	**Aktiviteti**
1.2.1 Minimizimi i problemeve për familjet në nevojë. 1.2.2 Paraqitja e nje harte më të qartë për situatat me të cilat përballen familjet në nevojë. 1.2.3 Rritja e mundësive për të ndryshuar situatën në bashkëpunim me OJF dhe institucionet publike.	1.2.1.1 Ngritja e grupeve multidisiplinare që bëjnë vlerësimin e situatave familjare në çdo njësi administrative. 1.2.2.1 Hartëzim dhe Vlerësim periodik mbi ecurinë e ndryshimeve për familjet në nevojë. 1.2.3.1 Monitorim nga pushteti vendor mbi ecurinë e shërbimeve në plotësimin e nevojave të popullatës

	1.2.3.2 Ngritje e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë, nëpërmjet trajnimit.
Objektivi 3 Të rritet transparenca në mënyrën e menaxhimit të të ardhurave dhe fondeve të bashkisë	
Rezultati/ Produkti	**Aktiviteti**
1.3.1Luftë kundër korrupsionit 1.3.2 Ritja e përfitimeve të drejta, për grupet në nevojë.	1.3.1.1 Monitorim nga organe të posaçme të bashkisë/ qeverisë/ shoqëria civile për të reduktuar numrin e abuzimeve. 1.3.2.1 Informim më intensiv i komunitetit mbi vendimarrjen.
Objektivi 1.4: Përdorimi eficent i burimeve për sektorët më premtues të ekonomisë siç janë: bujqësia, blegtoria, industria, zhvillimi rural, turizmi etj.	
Rezultati/ Produkti	**Aktivitete**
1.4.1 Zhvillim i shpejtë, i qëndrueshëm dhe i balancuar social-ekonomik 1.4.2 Nxitje e sipërmarrjes së lirë.	1.4.1.1 Promovimi i burimeve premtuese të bashkisë dhe të çdo njësie administrative për integrimin në punë të personave në NE. 1.4.2.1 Monitorim mbi përdorimin i burimeve premtuese të ekonomive lokale 1.4.2.2 Promovim i skemave të vetë-punësimit për personat në NE 1.4.2.3 Mbështetje për iniciativat që janë në funksion të implemetimit të skemës së re të ndihmës ekonomike. 1.4.2.4 Fuqizimi i grup moshave specifike përmes skemave të personalizuara të nxitjes së punësimit dhe vetëpunësimit. 1.4.2.5 Integrimi në skemat e nxitjes së punësimit. 1.4.2.6. Lehtësira fiskale për gratë, zonat muzeale, etj.

Objektivi 1.5: Të rritet bashkëpunimi me OJF-të që veprojnë në Bashkinë Elbasan	
Rezultati/ Produkti	**Aktivitete**
1.5.1 Rritje e numrit të familjeve që përfitojnë shërbime nga OJF-të si: trajnime, këshillime, ushqime, strehim, arsimin, veshëmbathje etj. 1.5.2 Rritje e numrit të projektev/ shërbimeve nga OJF-të në dobi të grupeve në nevojë. 1.5.3 Shtrirje të shërbimeve në të gjitha njësitë administrative dhe përmisim i cilësisë së shërbimeve	1.5.1.1 Prezantimi i gjendjes së familjeve të varfëra dhe problemet që ato hasin. 1.5.2.1 Kordinim mes organeve të pushtetit vendor dhe OJF-të 1.5.2.2 Lobim pranë organizatave ndërkombëtare për thithje fondesh 1.5.3.2 Mbështje e organizatave për t'u lidhur me komunitetin dhe për të dhënë kontributin e tyre.
Qëllimi 2: Përmisimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuar.	
Objektivi 2.1: Rritja e aksesit ndaj shërbimeve sociale dhe shëndetësore si dhe lobimi për plotësimin e nevojave bazë të personave me aftësi të kufizuar për një jetë dinjitoze.	
Rezultati/ Produkti	**Aktivitete**
2.1.1 Paraqitje më e qartë e situatës në të cilën ndodhen personat me aftësi të kufizuar për një ndërhyrje më efikase. 2.1.2 Mbështetja e mekanizmave të cilat punojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. 2.1.3 Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese për personat me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre në komunitet dhe në skemat e punësimit.	2.1.1.1 Sesione ndërgjegjësuese per njohjen me kushtet e jetesës dhe nevojat që paraqesin grupe të ndryshme të personave me aftësi të kufizuar. 2.1.2.1 Organizimeve i trajnimeve për stafet e pushteti vendor për mënyrën e trajtimit të personave me aftësi të kufizuar 2.1.2.2 Sesione ndërgjesuese për specilistët mbi zbatimin e kuadrit ligjor që ndalon diskriminimin për shkak të paaftësisë. 2.1.3.1 Identifikim të shërbimeve të intgruara për PAK sipas kategorive. 2.1.3.2 Takime periodike midis aktorëve lokal për koordinim të suportit me karaker integrues. 2.1.4.1 Realizimi i takimeve për ofrimin e asistencës sociale dhe shëndetësore

2.1.4 Ofrimi i shërbimeve që këta persona të jenë më të përfshirë në shoqëri. 2.1. 5 Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave që janë në mbështetje të personave me aftësi të kufizuar. 2.1.6 Nxitja për heqjen e pengesave në ndërtim në mënyrë që të lehtësohet lëvizja në ndërtesa, hapësira publike dhe në sistemet e transportit.	pranë familjeve që kanë persona me aftësi të kufizuar. 2.1.5.1 Trajnimi i punonjësve social dhe shëndetësor mbi mënyrën e trajtimit të personave me aftësi të kufizuar. 2.1.6.1 Vlerësime dhe vëzhgime për të identifikuar pengesat që hasin personat me aftësi të kufizuar.
Objektivi 2.2: Rritja e transparencës së skemës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet ngritjes së regjistrit elektronik për të shmangur sa më shumë rastet e abuzimit.	
Rezultati/ Produkti	**Aktivitete**
2.2.1 Zbatimi i parimit të drejtësisë ku përfitojnë nga skema e paaftësisë personat që janë vërtetë në një situatë të tillë. 2.2.2 Përmisimi i shërbimit të kontrollit dhe të auditit për të ulur numrin e rasteve të abuzimit. 2.2.3 Ulje e rasteve të abuzimit nga raportimet që bëhen nga komuniteti. 2.2.4 Transparencë mbi mënyrën se si përdoren fondet që alokohen për përsonat me aftësi të kufizuar. 2.2.5 Rritje e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në vlerësimin e paftësisë. 2.2.6 Rritja e pagesës së personave me aftësi të kufizuar nga një përzgjedhje e drejtë. 2.2.7 Personat e vlerësuar duhet të kenë të drejtën të njihen me dokumentacionin e vlerësimit të tyre.	2.2.2.1 Ngritja e grupeve multidisiplinare që bëjnë vlerësimin e saktë dhe transparent mbi paaftësinë në çdo njësi administrative. 2.2.2.1 Ofrimi i trajnimeve për stafin që do të monitorojë skemën e vlerësimit të personve me aftësi të kufizuar, shtimi i burimeve njerëzore. 2.2.3.1 Ngritja e një sistemi raportimi nga komuniteti mbi abuzime të mundëshme në skemat e ndihmës. 2.2.4.1 Sesione ndërgjegjësimi për komunitetetet për të raportuar rastet e abuzimit. 2.2.5.1 Të bëhen publike të gjitha fondet që vijnë në shërbim të personave me aftësi të kufizuar dhe mënyra e menaxhimit të tyre. 2.2.5.2 Zhvillim trajnimesh per rritje te kualifikimit profesional për aktorët e përfshirë në skemën e paaftësisë. 2.2.6.1 Takime dhe lobim me MMSR për të parë mundësitë për rritjen e pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe 2.2.7.2 verifikim mbi përfituesit e skemës së paaftësisë.

Objektivi 2.3: Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet sociale me shërbimet e punësimit për një zhvillim social-ekonomik për personat me aftësi të kufizuar.	
Rezultati/ Produkti	**Aktivitete**
2.3.1 Sisteme integrimi nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.	2.3.1.1 Krijimi i një databaze me të dhënat mbi shkollimin apo formimin profesional të personave me aftësi të kufizuar në zyrat e punësimit.
2.3.2 Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar duke krijuar mundësi për një jetë të pavarur.	2.3.2.1 Kordinimi i punës ndërmjet institucioneve, OJF-ve dhe bizneseve për të arritur zbatueshmërinë e ligjeve ekzistuese.
2.3.3 Përmisimi i situatës social-ekonomike te personave me aftësi të kufizuar	2.3.3.1 Lehtësira në taksa për bizneset që punësojnë personat me aftësi të kufizuar.
2.3.4 Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në jetën shoqërore dhe zvogëlimi i paragjykimi mbi personat me aftësi të kufizuar.	2.3.4.1 Takime informuese për të parë mundësitë e integrimit në punë të personave me aftësi të kufizuar
2.3.5 Ofrimi i shërbimeve te inegruara ne nivel vendor për rehabilitimin apo riaftësimin në punë te personave me aftësi të kufizuar në bashkëpunim me OJF-të.	2.3.5.1 Hartimi i një marrëveshje bashkëpunimi midis Drejtorisë dhe Shoqatave PAK. 2.3.5.2 Mbledhja e rregullt e tavolinës multidisplinare për personat me aftësi të kufizuar.
Objektivi 2.4: Sigurimi i mundësive të arsimimit gjithëpërfshirëse ku të jenë pjesëmarrës personat me aftësi të kufizuar	
Rezultati/ Produkti	**Aktivitete**
2.4.1 Ofrimi i mundësive për t'u arsimuar bën që personat me aftësi të kufizuar të hedhin një bazë të fort për veten e tyre dhe në të ardhmen të shërbejnë edhe si specialist në sektorët e tyre.	2.4.1.1 Sesione trajnimi edukues dhe informuese për personat me aftësi të kufizuar si të kthehen në persona aktiv për advokim.
2.4.2 Rritja e kapaciteteve profesionale që mësuesit dhe edukatorët e tjerë të kuptojnë nevojat e mësimit nga studentët me aftësi të kufizuar	2.4.2.2 Informime dhe trajnime të stafeve të shkollave për mënyrën e trajtimit të personave me aftësi të kufizuar, verifikim periodik nga specialistët mbi trajtimin e personave me aftësi të kufizuar në ambientet e shkolave apo kopshteve.
2.4.3 Krijimi i ambienteve të shkollave të përshtatshme dhe gjithë përfshirësë që plotësojnë nevojat për arsimin e personave me aftësi të kufizuar.	2.4.3.1 Ndërgjegjësim në komunitetet e shkollave dhe komunitetet shoqërore për mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuar.

2.4.4 Ngritja e mekanizmave që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për shkollë për arsye të aftësisë së kufizuar. 2.4.5 Fuqizimi i kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuar si pjesë e vendimarrjes në jetën shoqërore.	2.4.4.1 Lobim për përgatitjen e lëndëve mësimore të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar. 2.4.5.1 Organizimi i takime me tavolina multidisiplinare ku të jenë pjesëmarrës edhe personat me aftësi të kufizuar, përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në mbledhjet e këshillave bashiakë.
Objektivi 2.5 Zbatimi i kuadrit ligjor për garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.	
Rezultati/ Produkti	**Aktivitete**
2.5.1 Zbatueshmëria e ligjit nga ana e stafit për një shoqëri më të drejtë për personat me aftësi të kufizuar. 2.5.2 Respektimi i të drejtës së informimit dhe të drejtës së pjesëmarrjes në vendimet që merren nga pushteti vendor.	2.5.1.1 Ofrimi i trajnimeve dhe informimi për stafet përgjegjëse të pushtetit vendor për të rritur kapacitetet e tyre profesionale në shërbim të personave me aftësi të kufizuar. 2.5.2.1 Seanca informuese me personat me aftësi të kufizuar për të njohur më shumë të drejtat e tyre dhe për të raportuar për rastet e shkeljeve, të përfshihen e pikëpamjet e personave me aftësi të kufizuar për një vendimarrje më të drejtë.
Objektivi 2.6: Reformimi i sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar duke ulur përqindjen e rasteve abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar	
Rezultati/ Produkti	**Aktivitete**
2.6.1 Rritja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuar në jetën shoqërore dhe përfshirja e tyre në vendimarrje. 2.6.2 Vlerësimi dhe referimi nga punonjësi social i njësisë vendore mbi ecurinë e funksionimit të skemës së paaftësisë 2.6.3 Mosdiskriminimi dhe garantimi i respektimit të parimit të barazisë në shoqëri. 2.6.4 Rritja e kapaciteteve të stafit të shërbimit social për	2.6.1.1 Informim dhe këshillim bazë për të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, informimi edhe për përfitimet cash. 2.6.2.1 Rraportime tremujore të performancës së skemës së paaftësisë për politik-bërësit dhe për vlerësimin e profilit të riskut nga ana e punonjësit social të njësisë. 2.6.3.1 -Realizimi i takimeve periodike mujore me stafet përgjegjëse të pushtetit vendor dhe organizatat e shoqërisë civile për raportime mbi respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. 2.6.4.1 Trajnimi i personave përgjegjës për mënyrën e aplikimit të personave

menaxhimin e skemës së vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar. 2.6.5 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar për të shprehur mendimet e tyre 2.6.6 Krijimi një sistemi të përshtatshëm për metodat e komunikimit dhe informacionit në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara. 2.6.7 Ulja e numrit të personave që përfitojnë në mënyrë të padrejtë nga skema e paaftësisë dhe rritje e përfitimeve për personat që janë me aftësi të kufizuar. 2.6.8 Ngritja dhe forcimi i mekanizmit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar në nivel vendor. 2.6.9 Sensibilizimin e personave të vlerësuar lidhur me legjislacionin në fuqi dhe të drejtat e tyre.	me aftësi të kufizuar në skemën e paaftësëisë. 2.6.5.1 Sesione dëgjuese për të marrë mendimet që kanë personat me aftësi të kufizuar për mënyrën e re të vlerësimit të paaftësisë. 2.6.6.1Trajnime për stafin për mënyrën e komunikimit me personat me aftësi të kufizuar për të marrë dhe për të dhënë informacion. 2.6.7.1 Sesione ndërgjegjësimi për komunitetin e bashkisë dhe të njësive vendore si dhe për personat me aftësi të kufizuar për të raportuar abuzimet e mundshme. 2.6.8.1 Kontrolle periodike mujore nga specialistë për të bërë monitorim e funksionimit të skemës së re të vlersimit të personave me aftësi të kufizuar. 2.6.9.1 Sesione informuese me personat me aftëssi të kufizuar për të njohur me legjislacionin në fuqi.
Qëllimi 3: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social për Fëmijët, Gratë dhe Moshën e tretë	
Objektivi 3. 1 Rritja e mbështetjes për qendrat të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit social për ngritjen e një sistemi të integruar shërbimesh në njësinë vendore	
Rezultati/Produkti	**Aktivitete**
3.1.1 Ngritja e sistemit të integruar të informacionit në nivel lokal, për te identifikuar, referuar nevojat për shërbime të përkujdesit shoqëror. 3.1.2 Ofrimi i shërbimeve në trajtimin e problemeve dhe integrimin e grupeve vulnerabël në shoqëri bëhet në mënyrë efektive.	3.1.1.1 Organizimi i takimeve nga një grup specialistësh për të vlerësuar nevojat që kanë qendrat që ofrojnë shërbime të kujdesit social për grupe të ndryshme si dhe kordinimi i punës së këtyre qendrave . 3.1.1. 2 Paraqitja e një harte të qartë mbi shtrirjen që kanë qendrat që ofrojnë shërbime të kujdesit social dhe gjendjen në të cilën ndodhen këto qendra. 3.1.2.1 Rritje të kapciteteve profesionale për ofrimin e shërbimeve të kujdesit

3.1.3 Rritja e bashkëpunimit të pushtetit vendor me donatorë të cilët ofrojnë mbështetje në shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor. 3.1.4 Ngritja ose nxitja e mekanizmave që mund të ofrojnë mbështjeve për grupet vulnerabël për integrimin e tyre ne jetën shoqërore dhe krijimin e pavarësisë nga ana ekonomike.	social në përputhje me standartet e përcaktuara nga ministria përgjegjëse. 3.1.3.1 Trajnime për stafet që ofrojnë shërbime të kujdesit social në njësitë vendore, për rritjen e kapaciteteve profesionale 3.1.4.1 Promovimin i modeleve të reja të shërbimeve sociale nëpërmjet organizimit të tryezave të rrumbullakta. 3.1.4.2 Organizimi i takimeve nga pushtetit vendor me përfaqësues të biznesit apo OJQ-ve për të parë mundësinë për rritjen e fondeve për këto shërbime. 3.1.4.3 Realizimi i takimeve me agjencitë e formimit profesional apo shkollat dhe bizneset për të parë mundësitë që ofrojnë për kurse profesionale apo edhe mundësi punësimi. 3.1.4.4 Ngritja e njësisë së hartimit të politikave sociale pranë organeve të bashkisë e përbërë nga tre specialistë të politikave sociale, që adresojnë problemet sociale.
Objektivi 3.2 Rritja e cilësisë së shërbimeve që ofrohet nga qendrat e kujdesit social për një efektivitet me të madh për përdoruesit e shërbimeve.	
Rezultati/Produkti	**Aktivitete**
3.2.1 Shtrirja e shërbimeve dhe ofrimi i shërbimeve në afërsi me vendbanimin e personave që kanë nevojë për kujdes social 3.2.2 Krijimi i një sistemi kualifikimi dhe përmisimi i kapaciteteve profesionale për të ofruar një shërbim sa më efektiv në dobi të personave që përfitojnë shërbime të kujdesi social.	3.2.1.1 Ndërtimi i qendrave mjekësore informuese, këshilluese dhe ndihmëse apo krijimi i pavioneve të veçanta në spitale për individë që janë përdorues të shërbimeve të kujdesit social. 3.2.2.1 Trajnime për përmisimin e aftësive profesionale dhe mjështërive komunikuese për stafin e punësuar aktualisht, por gjithashtu lidhet me zgjerimin e këtij stafi me profesionistë të profesioneve të reja. 3.2.3.1 Ngritja e një komisioni të përbërë nga tre persona që merren me

3.2.3 Rritja e transparencës mbi mënyrën e funksionimit dhe menaxhimit të qendrave që ofrojnë shërbime të kujdesit social. 3.2.4 Ndërgjegjësimi i përdoruesve të shërbimit për tu bërë pjesë e përmisimit të shërbimeve të kujdesit social. 3.2.5 Deinstitucionalizimi dhe fuqizimi i përdoruesve të shërbimeve të kujdesit social për tu angazhuar në skemën e punësimit dhe jetën shoqërore. 3.2.6 Menaxhimi i shërbimevenëpërmjet krijimi të një databaze për secilën qendër që ofron shërbime të kujdesit social dhe mundësia për të ndërhyrë në të ardhmen duke bërë vlersimin e raportimeve. 3. 2.7 Zhvillimi dhe integrimi i sistemit të mirëqenies sociale në favor të grupeve në nevojë	monitorimin periodik të cilësisë së shërbimeve dhe raportimin mujor pranë zyrës përkatëse. 3.2.4.1 Sesione informuese me personat që përdorin shërbime të kujdesit social për mënyrën se si mund të veprojnë në rast se ju shkelen të drejtat e tyre. 3.2.5.1 Trajnimi i përdoruesve të shërbimeve të kujdesit social për tu integruar në jetën social-ekonmike dhe nxitjen e pavarësië. 3.2.6.1 Sesione informuese për stafin në lidhje me raportimet e dokumentuara që duhet të kenë pranë zyrës së tyre dhe rëndësinë që mbartin këto raportime mujore. 3.2.7.1 Realizimi i një studimi për të vlerësuar hendekun e nevojave për shërbime sociale krahasuar me shërbimet e ofruara. 3.2.7.2 Ngritja e një qëndre polivalente në nivel vendor me kapacitet 50 shtrtër, për moshën 25 – 60 vjec.
Objektivi 3.3 Nxitja dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe integrimi i tyre në shoqëri.	
Rezultati/Produkti	**Aktivitete**
3.3.1 Ngritja e shërbimit të kujdesit social për fëmijët si njësi më vete në secilën njësi vendore me staf të dedikuar. 3.3.2 Fuqizimi dhe sensibilizimi i mekanizmave mbi rolin e rëndësishëm që ka kordinimi i punës së tyre në mbrojtje të drejtave të fëmijëve. 3.3.3 Rritja e kapaciteteve profesionale për mënyrën e të vepruarit dhe adresimin e problemeve të fëmijëve duke	3.3.1.1 Ngritja e komisionit për identifikimin, vlerësimin dhe planifikimin e nevojave që kanë fëmijët në secilën njësi vendore. 3.3.2.1 Trajnime dhe fushta sensibilizimi 3.3.3.1 Trajnime mbi mënyrën e identifikimit dhe referimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve me punonjësit e njësive administrative, me mjekët e familjes, me punonjësi e policisë në komunitet, me mësuesit, me psikologë apo punonjësit socialë që ndodhen në shkolla apo edhe në qendra të

ulur numrin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve. 3.3.4 Respektimi i të drejtave të fëmijëve duke ju garantuar jetën dhe duke ju ofruar asistencë dhe mbrojtje sociale të përshtatshme sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve. 3.3.5 Ulja e numrit të fëmijëve që marrin pëkujdes rezidencial dhe afrimiteti i tyre me familjarët apo personat kujdestar mbas largimit nga qendra. 3.3.6 Rritja e bashkëpunimit dhe e advokacisë për buxhetim me fokus fëmijët.	ofrimit të kujdesit social, me përfaqësues të qeverive të nxënësve. 3.3.4.1 Ngritja e një qëndre pritëse dhe pajisja me të gjitha standartet për shërbimet rezidenciale dhe ditore për fëmijët në nevojë, si dhe rekrutimi i stafit përgjegjës. 3.3.5.1 Organizmi i takimeve ndërgjegjësuese me prindërit e fëmijëve në nevojë apo persona përgjegjës për ta 3.3.6.1 Realizimi i takimeve me bizneset lokale, apo fondacione të ndryshme për të kontribuar për fëmijët në nevojë.
Objektivi 3. 4 Ndërgjegjësimi i autoriteve lokale dhe komunitetit për problematikat e moshës së tretë.	
Rezultati/Produkti	**Aktivitete**
3.4.1 Ofrimi i mbështetjes për një komunitet të shëndetshëm ku të moshuarit të kenë mundësi të jenë të sigurtë dhe të qetë, të përfshihen dhe të jetojnë me dinjitet në shoqëri. 3.4.2 Aktivizimi i të rinjëve për të dhënë kontributin e tyre në shoqëri për nevojat specifike që paraqesin të moshuarit në jetën e tyre të përditshme. 3.4.3 Rritja e përfshirjes dhe ndërgjegjësimit të komunitetit për të ofruar kontributin e tyre shoqëror në shërbim të të moshuarve. 3.4.4 Përmirësimi i jetës social-shëndetësore dhe	3.4.1.1 Evidentimi i nevojave emergjente të të moshuarve për të cilat kërkohet kërkohet ndërhyrje e qendrave të shërbimeve të kujdesit social apo dhe komuniteti. 3.4.2.1 Ngritja dhe trajnimi e një rrjeti të rinjsh vullnetarë që ndihmojnë të moshuarit me shërbime në familje apo dhe aktivitete ditore në secilën njësi vendore. 3.4.3.1 Sesione ndërgjegjësuese me komunitetin mbi dobishmërinë që ato kanë dhe për të ardhmen jo pozitive nëse nuk parandalojmë sot problemet e të moshuarve. 3.4.4.1 Krijimi i ambienteve socializuese dhe integruese për të moshuarit që të

kulturore të të moshuarve në territorin e bashkisë dhe njësive vendore. 3.4.5 Rritja e bashkëpunimit me median për të publikuar mesazhe sensibilizuese për shoqërinë dhe paraqitjen e situatës së të moshuarve. 3.4.6 Kordinimi dhe bashkëunimi i autoriteteve lokale dhe OJQ-ve që veprojnë në Korce për të ndërhyrë më situatat më emergjente të të moshuarve.	ndihen të përfshirë në jetën shoqërore. 3.4.5.1 Krijimi i bashkëpunimit me televizione lokale apo kombëtare për të përfshirë në emisionet e tyre çështjet e të të moshuarve. 3.4.6.1 Hartimi i raporteve gjashtë mujore nga secila njësi vendore për të paraqitur sfidat dhe problemet konkrete të të moshuarve.
Objektiva 3. 5 Inkurajimi i grave për të qenë të përfshira në vendimarrjedhe për të raportuar rastet e shkeljes së drejtave të tyre	
Rezultati/Produkti	**Aktivitetet**
3.5.1 Adresimi i problemeve që paraqesin gratë në nevojë për ndërhyrje sociale nga autoritet e pushtetit lokal, OJQ, edhe nga komuniteti në të cilin jetojnë këto gra. 3.5.2 Rritja e ndërgjegjësimit nga ana e publikut për të dhënë kontributin e tyre në përmisimin e situatës së grave si një faktor pozitiv për shoqërinë. 3.5.3 Informimi i grave dhe ndërgjegjësimi burrave për ti thënë STOP dhunës ndaj gruas dhe ulja e numrit të grave të keqtrajtuara. 3.5.4 Rritja e numrit të grave të punësuar në punë të paguara dhe përfshirja e tyre në vendimmarrjen shoqërore duke respektuar kuadrin ligjor. 3.5.5 Kordinimi dhe bashkëpunimi i institucioneve lokale	3.5.1.1 Vlerësimi nga ekspertë që merren me çështjet gjinore për nevojat dhe problemet që paraqesin gratë në secilën njësi vendore për të parë nevojën për ndërhyrje. 3.5.2.1 Përgatitja e materiale informuese si fletëpalosje, postera, spote publicitare dhe emisione televisive për parandalimin e keqtrajtimit të grave. 3.5.3.1 Organizimi i sesioneve ndërgjegjësuese me gra dhe burra në secilën njësi të qeverisjes vendore për ti thënë STOP dhunës ndaj gruas, si dhe informimin për mënyrën e të vepruarit në një rast abuzimi. 3.5.4.1 Shumëfishimi i trajnimeve që u interesojnë grave në të gjitha sferat e shtrirjes në shoqëri për tu bërë pjesë e vendimmarrjes në shoqëri. 3.5.5.1 Organizimi i takimeve me pjesëmarrës OJQ që veprojnë në Berat si dhe përfaqësues të ofrimit të shërbimit të kujdesit social për gratë për të bërë të mundur kordinimin e punës së tyre për të ofruar një shërbim sa më cilësor për

për intergrimin dhe fuqizimin e grave të cilat kanë nevojë për mbështetje për të ndryshuar situatën e tyre social-ekonomike. 3.5.6 Ofrimi i shërbimeve cilësore për gratë e dhunuara dhe përmirësimi i kapaciteteve profesionale të shërbimeve për një integrim sa më të sigurt të këtyre grave në shoqëri. 3.5.7 Respektimi i kuotave gjinore në këshillin bashkiak si një formë e mirëqeversjen së pushtetin vendor për ofrimin e shanceve të barabarta	gratë. 3.5.6.1 Zgjerimi i shërbimeve këshilluese dhe rehabilituese, strehëzave për gratë të cilat vuajnë nga keqtrajtimet dhe pajisja e tyre me staf të kualifikuar. 3.5.7.1 -Organizimi i diskutimeve të hapura nga organet e pushtetit vendore për respektimin e kuaotave gjinore në këshillat bashkiakë.
Qëllimi 4: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social për Komunitetin Rom dhe Egjyptian	
Objektiva 4.1 Ndërtimi i një ambienti shoqëror të shëndetshëm për komunitetin rom dhe egjiptian përmes fushatave të ndërgjegjësimit social-kulturor dhe shëndetësor për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.	
Rezultati/Produkti	**Aktivitetet**
4.1.1 Rritja e bshkëpunimit të pushtetit vendor me shoqërinë civile për të ofruar sa më shumë shërbime social-ekonomike në ndihmë të komunitetit rom dhe egjiptian për një jetë më të sigurt dhe të qetë. 4.1.2 Informimi i komunitetit rom dhe egjiptian nga ana e pushtetit vendor në programet e mbështetjes sociale dhe procedurat për të përfituar nga këto programe si një formë për integrimin dhe rritjen e përfshirjes në jetën shoqërore ku ata jetojnë 4.1.3 Ofrimi i mundësive që familjet e komunitetit rom	4.1.1.1 Përshtatje e planit lokale të zhvillimit me nevojat për komunitetin rom dhe Egjiptian për të vlerësuar situatën në të cilën ata ndodhen duke përfshirë arsimin, punësim, gjendjen shëndetësore, strehmin, ushqimin etj. 4.1.2.1 Mbështetje dhe asistencë e rritur nga njësitë e pushtetit vendor për të gjitha familjet e komunitetit rom dhe egjiptian që kërkojnë të përfshihen në skemat e shërbimit social për pagesat e ndihmës ekonomike, pagesat për personat me aftësi të kufizuar dhe banesat sociale. 4.1.3.1 Organizimi i diskutimeve me përfaqësues të autoriteteve lokale dhe këshillit bashkiakë për të rritur aksesin e komunitetit rom dhe egjiptian për të përfituar nga skema e banesave sociale.

dhe egjitpian të bëhen përfitues të skemës së banesave sociale duke ndryshuar kriteret që i bëjnë përfitues ata. 4.1.4 Fuqizimi dhe intregrimi i të rinjëve/rejave në skemat e punësimit dhe rritja mundësive për të krijuar pavarësinë e tyre social-ekonomike në jetën e përditshme. 4.1.5 Informimi dhe ndërgjegjësimi i familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian me këshilla praktike mbi mënyrën e të vepruarit dhe të raportuari në situata të ndryshme.	4.1.4.1 Ofrimi i kurseve profesionale në qendrat e formimit profesional për të rinjtë dhe të rejat rome dhe egjiptiane për tu bërë pjesë e skemave të punësimit. 4.1.5.1 Seminare të mbajtura nga punonjes profesionale me familje të komunitetit rom dhe egjiptian mbi çështje të arsimit, konflikteve në familje, komunikimin dhe dialogun, të drejtave të tyre etj.
Objektivi 4.2 Integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian në edukimin e përgjithshëm publik dhe trajnimin profesional	
Rezultati/Produkti	**Aktivitete**
4.2.1 Garantimi për akses të barabartë të komunitetit rom dhe egjiptian në sistemin arsimor. 4.2.2 Integrimi dhe rritja e numrit të antarëve të komunitetit rom dhe egjiptian të përfshirë në skemat e punësimit. 4.2.3.1 Rritja e numrit të projekteve në favor të komunitetit rom dhe egjiptian dhe e numrit të përfituesve. 4.2.4 Rritja e fushtave ndërgjegjësuese dhe rritja e numrit të personave si punëkërkues të regjistruar në fillim dhe në fund të fashatave. 4.2.5 Fuqizimi dhe shtimi i numrit të biznese të vogla apo	4.2.1.1Organizimi i takimeve me përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, pushtetit vendor dhe ministrisë së arsimit për ofrimin e mundësive të barabarta për fëmijët e komunitetit. 4.2.2.1 Nxitja e komunitetit rom dhe egjiptian për të ndjekur kurse profesionale për tu përfshirë në skema e punësimit si profesionistë. 4.2.3.1 Financimin e projekteve të zhvillimit ekonomik që u mundësojnë komunitetit rom dhe egjiptian për të kaluar pragun e varfërisë. 4.2.4.1 Organizimi i fushtave informuese dhe ndërgjegjësuese me të papunët rom dhe egjiptian mbi mundësitë dhe përfitimet nga programet e punësimit dhe formimit profesional. 4.2.5.1 Ofrimi i shërbimeve mbështetëse për sipërmarrësit rom dhë për

edhe të mëdha me sipërmarrës persona të komunitetit rom dhe egjiptian.	pjesëmarrësit në programet e gjenerimit të të ardhurave.
Objektivi 4.3 Fuqizimi i komuniteteve rom dhe egjiptiane për të mbrojtur liritë dhe të drejtat, në mënyrë që të parandalohet dhe të ulen rastet e diskriminimit	
Rezultati/Produkti	**Aktivitete**
4.3.1Publikimi i materialeve dhe programeve me fokus kuadrin ligjor për informimin e komunitetit rom dhe egjiptian për të mbrojtur të drejtat e tyre. 4.3.2 Rritja e bashkëpunimit të komunitetit rom dhe egjiptian me institucinet shtetëore dhe private për të dhënë zgjidhje rasteve të diskriminimit. 4.3.3 Ndërgjegjësimi i antarëve të komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe kmunitetit që i rrethon për të denoncuar raste të tilla. 4.3.4 Realizimi i vendimeve të marra në funksion të intergrimit të komunitetit rom dhe egjiptian në shoqëri. 4.3.5 Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit rom dhe egjiptian për tu njohur me të drejtat dhe detyrimet që ato kanë në shoqëri.	4.3.1.1 Zhvillimi i programeve të edukimit ligjor për anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian me synimin rritjen e njohurive mbi të drejtat e njeriut 4.3.2.1 Organizimi i takimeve me me përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, me drejtuesit e institucioneve publike, dhe organizatat jo-qeveritare me qëllim që të ndjekin dhe të zgjidhin me korrektësi rastet e diskrimit. 4.3.3.1 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe aktiviteteve me karakter informues për trafikim dhe dhunën në familje. 4.3.4.1 Monitorimi i zbatimit të masave lehtësuese për komunitetin rom dhe egjiptian për përfitimin nga skema e mbrojtjes sociale. 4.3.5.1 Ofrimi i këshillimit prindëror në shkolla dhe kopshte për prindërit rom dhe egjiptian rreth të drejtave dhe detyrimeve për zhvillimin arsimor të fëmijëve.
Objektivi 4.4 Krijimi i kushteve për ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore të komuniteteve rome dhe egjiptiane.	
Rezultati/Produkti	**Aktivitetet**

4.4.1 Promovimi i traditës dhe kulturës së komunitetit rom dhe egjiptian me ndihmën e organeve të pushtetit lokal për ti bërë edhe ata pjesë të shoqërisë. 4.4.2 Festimi i ditëve të shënuara të komunitetit rom dhe egjiptian për ti bërë të ndjehen pjesë e shoqërisë. 4.4.3 Respektimi i identitetit të komunitetit dhe ofrimi i mundësive për të punësuar profesionistëve të gjuhës. 4.4.4 Ndërgjegjësimi i shoqërisë komunitetin rom dhe egjiptian për të rritur frymën e bashkëjetesës me komunitetin rom dhe egjiptian. 4.4.5 Rritja e frymës së bashkëpunimit të organeve shtetërore, private dhe OJQ-ve, për të dhënë kontributin në integrimin në shoqëri të komunitetit rom dhe egjiptian. 4.4.6 Kthimi i shkollave në qendra komunitare për promovimin e vlerave ndër-komunitare.	4.4.1.1 Organizimi i aktviteteve social-kulturore nga pushteti lokal për të promovimin e vlerave, traditave dhe kulturës së komunitetit rom dhe egjiptian. 4.4.2.1 Celebrimi i ditëve të shënuara si 8-Prilli për komunitetin rom përmes organizimit të aktiviteteve kulturore. 4.4.3.1 Hartimi i një kurrikule për mësimin e gjuhës së komunitetit në Qendrën Komunitare Ndër-Kulturore me mesues të gjuhës përkatëse. 4.4.4.1 Organizimi i eventeve kulturore ku të mund të shfaqen ekspozita me fotografi, piktura, drama, muzikë, të cilat nxisin bashkëjetesën në komunitet. 4.4.5.1 Organizimi i tryezave teknike me përfaqësues të komunitetit, institucioneve publike dhe private, dhe OJQ, për nxitjen e nismave që mbështesin multi-kulturalizmin dhe diversitetin. 4.4.6.1 Organizimi nga shkollat i veprimtarive social-ndërkulturore me prindër dhe fëmijë rom dhe egjiptian por edhe pjesëmarrës fëmijë dhe prindër nga shumica.

MODEL BUXHETIMI VJETOR - SHERBIMET SOCIALE NE BASHKI

Bashkia ELBASAN

Programi:

PROGRAMI I SHERBIMEVE SOCIALE

Politika e programit:

*** Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë** duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, përmirësimin e shenjëstrimit të tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndihmës Ekonomike, si dhe lidhjen me shërbime të integruara dhe skemat e punësimit, me qëllim riintegrimin social të tyre.

*** Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara (PAK)** nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në Cash me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

*** Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social** për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale, si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes se plotë dhe efektive në shoqëri.

Parimet:

* Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi: Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.
* Mbrojtja: Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.
* E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit: Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.
* Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve: Individët janë përgjegjës për jetën e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka
* Përfshirja dhe integrimi: Respektimi i të drejtave dhe nevojave.
* Partneriteti: koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.
* Cilësia e shërbimeve: Standardet Kombëtare udhëheqin vendimmarrjen në nivel vendor.

Standartet:

http://www.sherbimisocial.gov.al/standardet-per-sherbimet-shoqerore

Buxheti permbledhes per 5 vite

ne Leke

A: Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë	Kosto / objektiv	Ndarja e kostos sipas artikujve buxhetore			
		600 + 601	602	230	231
Obj. A 1	1,879,012,600	-	1,879,012,600	-	-
Obj. A 2	1,400,000	-	1,400,000	-	-
Obj. A 3	1,975,000	-	1,975,000	-	-
Obj. A 4	30,000	-	30,000	-	-
Obj. A 5	1,900,000	-	1,900,000	-	-
Total A	1,884,317,600		1,884,317,600		
B: Përmirësimi i cilësisë se jetesës së PAK	**Kosto / objektiv**	**Ndarja e kostos sipas artikujve buxhetore**			
		600 + 601	602	230	231
Obj. B 1	900,000	-	900,000	-	-
Obj. B 2	1,650,000	-	650,000	-	1,000,000
Obj. B 3	5,393,557,800	-	5,393,557,800	-	-
Obj. B 4	1,200,000	-	1,200,000	-	-
Total B	5,397,307,800	-	5,396,307,800	-	1,000,000
C: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social	**Kosto / objektiv**	**Ndarja e kostos sipas artikujve buxhetore**			
		600 + 601	602	230	231
Obj. C 1	59,150,000	-	59,150,000	-	-
Obj. C 2	200,000	-	200,000	-	-
Obj. C 3	2,700,000	-	2,700,000	-	-
Obj. C 4	1,000,000	-	1,000,000	-	-
Obj. C 5	1,000,000	-	1,000,000	-	-
Obj. C 6	2,500,000	-	2,500,000	-	-
Obj. C 7	595,084,028	-	182,584,028	37,500,000	375,000,000
Total C	661,634,028	-	249,134,028	37,500,000	375,000,000
D: Burimet njerezore	**Kosto / objektiv**	**Ndarja e kostos sipas artikujve buxhetore**			
		600 + 601	602	230	231
Obj. D 1	143,857,200	143,857,200	-	-	-
Obj. D 2	6,025,000	-	5,025,000	-	1,000,000
Total D	149,882,200	143,857,200	5,025,000		1,000,000

TOTALI	8,093,141,628	143,857,200	7,534,784,428	37,500,000	377,000,000

MODEL BUXHETIMI - SHERBIMET SOCIALE

Bashkia ELBASAN

- Dokumentin e pronësisë së bashku me hartën treguese të pronës kufitare private apo marrëveshjet e sipërmarrjes/porosie/shkëmbimit apo të tjera të ngjashme me këto, që subjekti privat ka për këto pasuri, në kufi me pronën në pronësi të Bashkisë Elbasan.

1. Shqyrtimi i kërkesës për shprehje interesi

1. Procedura për shqyrtimin, negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes zbatohet në përputhje me parimet e ruajtjes dhe garantimit të interesit publik, si dhe ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës së Bashkisë Elbasan.
2. Me paraqitjen e kërkesës, Drejtoria e Aseteve Pronave dhe Strehimit kryen këto veprime:
a. Verifikon nëpërmjet listave të inventarit nëse pasuria e propozuar për marrëveshje është apo jo pjesë e tyre, si dhe verifikon tagrin ligjor që ka Bashkia Elbasan mbi të;
b. Merr informacionin zyrtar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan për statusin juridik të pasurive që kërkohet të zhvillohet si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm provues tekniko-ligjor.
3. Nëse pasuria e paluajtshme sipas verifikimit të mësipërm, rezulton në pronësi të Bashkisë Elbasan dhe zhvilluesi privat ka një marrëdhënie juridike, ose kontratë sipërmarrjeje, me pronën kufitare në pronësi të Bashkisë së Elbasanit, Drejtoria e Aseteve Pronave dhe Strehimit, së bashku me statusin juridik të pronave i përcjell kërkesën dhe dokumentacionin përkatës Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Projekteve , për të marrë në shqyrtim kërkesën në përputhje me kuadrin ligjor të planifikimit të territorit dhe Planin e Përgjithshëm Vendor.
4. Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve në përfundim të shqyrtimit e verifikimit të kërkesës, si edhe të dokumentacionit shoqërues, në bashkëpunim me Drejtoria e Aseteve Pronave dhe Strehimit , arrijnë në konkluzionin se:

a. Kërkesa e paraqitur nga subjekti privat është në përputhje me elementët e planifikimit të territorit dhe PPV-në e Bashkisë Elbasan dhe së bashku me informacionin e siguruar ia përcjellin Komisionit të Negocimit, duke njoftuar edhe zhvilluesin privat për këto veprime.

b. Kërkesa e paraqitur nga zhvilluesi privat nuk është në përputhje me elementët e planifikimit të territorit, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe vendoset refuzimi i saj. Refuzimi i kërkesës i njoftohet edhe zhvilluesit privat.

2. Komisioni i negocimit dhe përmbajtja e marrëveshjes

1. Në zbatim të këtij vendimi, për shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave të paraqitura nga zhvilluesit privat, ngrihet dhe funksionon Komisioni i Negocimit të Marrëveshjes, i cili ngrihet me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.
2. Anëtarë të këtij komisioni, si rregull janë një përfaqësues i Drejtorisë Juridike , një përfaqsues i Drejtorisë së Aseteve , Pronave dhe Strehimit , dy përfaqësues të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Projekteve dhe një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të të Planifikimit të ë Ardhurave , Aseteve , Buxhetit dhe Financës.
3. Nuk mund të marrin pjesë në Komision e Negocimit personat që kanë konflikt interesi me partneritetin privat sipas kuptimit të ligjit "Për konfliktin e interesit". Anëtarët e Komisionit të Negocimit kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e negocimit.
4. Marrëveshja e sipërmarrjes/shkëmbimit, midis Bashkisë së Elbasanit dhe zhvilluesit privat reflekton termat e referencës së procedurës së përzgjedhjes së përcaktuar në këtë vendim, që konsiderohen të mirëqena dhe të cilat janë kushtet të panegociushme të marrëveshjes nga ana e Komisionit të Negocimit. Marrëveshja përmban kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi, si dhe parashikon ato terma që vlerësohen të përshtatshme nga palët, të tilla si:

a. Dokumentacioni i plotë i partnerit privat (ekstrakt i QKB, vërtetim shlyerje detyrimesh tatimore dhe bashkiake)
b. Kohëzgjatja e marrëveshjes.
c. Pronat në pronësi të Bashkisë së Elbasanit të vendosura në dispozicion të zhvilluesit privat.
d. Sipërfaqen takuese ndërtimore që do të përfitohet nga Bashkia e Elbasanit , e cila në çdo rast duhet ti referohet përqindjes mesatare të kontratave të ngjashme të lidhura në zonën përreth, por në çdo rast kjo përqindje nuk mund të jetë më pak se 30 % e sipërfaqes ndërtimore për pjesën takuese që Bashkia Elbasan ka vendosur në dispozicion të zhvilluesit privat.
e. Në rast se prona në pronësi të Bashkisë Elbasan është godinë, atëherë Bashkia duhet të përfitoj si rregull të njëjtën sipërfaqe ndërtimore, e cila do ti vendoset në dispozicion të zhvilluesit privat, por në asnjë rast jo më pak se 50 % të sipërfaqes, në ato raste kur godina është në gjendje të amortizuara. Në çdo rast, Bashkia e Elbasanit mund të kërkoj kryerjen e ekspertizës nga ekspertë të fushës, mbi gjendjen e godinës dhe vlerës së saj financiare.
f. Paraqitjen e një projekt ideje mbi projektin që synohet të zhvillohet.
g. Paraqitjen e një pasqyre financiare që pasqyron fuqinë ekonomike të zhvilluesit privat dhe/apo çdo dokument provues nga pala financuese, nëse ka, për garantimin e zhvillimit të projektit
h. Sanksionet konkrete kundrejt zhvilluesit privat në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër në marrëveshjen e sipërmarrjes/shkëmbimit me Bashkinë Elbasan .
i. Të drejtat e Bashkisë së Elbasanit apo strukturës së autorizuar për të monitoruar punimet dhe cilësinë e tyre që duhet të ofrohen nga zhvilluesi privat sipas kushteve dhe kritereve të specifikuara në marrëveshje.
j. Çdo kufizim ose kusht të zbatueshëm për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve të zhvilluesit privat të një i tretë, pa marrë më parë miratimin me shkrim të Bashkisë së Elbasanit për pjesën e saj takuese.

k. Përkufizimi dhe pasoja e forcës madhore, ndryshimi në ligj dhe ndryshime të tjera të rrethanave, duke përfshirë çdo të drejtë të Bashkisë Elbasan për të kërkuar kompensimin ose rishikimin e kontratës.
l. Garancitë për tu përmbushur dhe politikat e sigurimeve dhe të drejtave të punonjësve që duhet të ndiqen nga zhvilluesi privat gjatë zbatimin dhe gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes.
m. Procedurat e rregullimit të shkeljes së marrëveshjes, të bëra nga njëra prej palëve.
n. Ligjin e zbatueshëm dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes që mund të lindin ndërmjet Bashkisë së Elbasanit dhe zhvilluesi privat.
o. Procedura për zgjidhjen e marrëveshjeve së sipërmarrjes/shkëmbimit apo të tjera të ngjashme me këto, pas kalimit të afateve të vendosura ndaj zhvilluesit privat dhe aplikimin e sanksioneve për këtë shkak.

5. Komisioni i Negocimit, në përputhje me kriteret dhe kushtet e panegociushme të marrëveshjes të vendosura në këtë vendim, vlerëson, negocion dhe harton projekt marrëveshjen finale të negociuar nga palët, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave.

3. Projekt marrëveshja, miratimi i saj dhe hyrja në fuqi.

1. Projekt marrëveshja, e shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, i dërgohet për nënshkrim kryetarit të bashkisë apo personit të autorizuar prej tij. Kryetari i bashkisë dërgon për miratim në këshillin bashkiak marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe zhvilluesit privat.
2. Data e hyrjes në fuqi e marrëveshjes do të jetë data e hyrjes në fuqi e vendimit të këshillit bashkiak.
3. Në rast të një procedure të suksesshme për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me zhvilluesin privat, komisioni i negocimit do të vendosë si kusht në marrëveshje edhe detyrimin e zhvilluesit privat për të paguar vlerën përkatëse të paguar nga Bashkia Elbasan , në rastin e kryerjes së ekspertizave të ndryshme, nëpërmjet ekspertëve privat të fushave përkatëse.
4. Çdo sipërfaqe ndërtimore e përfituar si rezultat i marrëveshjeve të sipërmarrjes/shkëmbimit përdoren vetëm për realizimin e funksioneve dhe përmbushjes së misionit të Bashkisë Elbasan.
5. Çdo taksë apo tarifë që rrjedh si pasojë e marrëveshjes së sipërmarrjes/shkëmbimit midis Bashkisë së Elbasanit dhe zhvilluesit privat është në ngarkim të këtij të fundit, me përjashtim të tarifës së pajisjes me dokumentin e pronësisë në emër të Bashkisë Elbasan .
6. Pas përfundimit të projektit, me urdhër të kryetarit të bashkisë ngrihet grupi i punës për marrjen në dorëzim të sipërfaqeve takuese ndërtimore, të përcaktuara sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe zhvilluesit privat.
7. Drejtorisë së Aseteve , Pronave dhe Strehimit ndjek të gjithë hapat dhe procedurat e nevojshme për regjistrimin e sipërfaqeve ndërtimore të fituara në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ZVRPP Elbasan , duke reflektuar edhe ndryshimet përkatëse në listat e inventarit.
8. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë së Aseteve , Pronave dhe Strehimit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projektimit dhe Komisioni Negocimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

9.Procedurat e këtij vendimi do të zbatohen dhe për kërkesat e depozituara deri më sot në bashkinë Elbasan për parcelat kadastrale në pronësi të saj , në njësitë A1 të PDV-së me Kod 1/47 të miratuar me Vendimin Nr.307 datë 4.03.2019 të Kryetari të Bashkisë Elbasan në të cilën ka në pronësi **3429.75** m2 dhe në njësinë A2 të PDV-së me Kod 1/55 të miratuar me Vendimin Nr.57/1 datë 28.12.2018 të Kryetari të Bashkisë Elbasan, në të cilën ka në pronësi **4859.98** m2, të cilat sipas

Planit të Përgjithshëm Vendor i miratuar me vendim Nr.1 datë 29.12.2016 të KKTRSH-së janë troje të lira të miratuara si njësi për zhvillim, menjëherë me miratimin e këtij vendimi .

10. Zbatimin e këtij vendimi në cdo rast kur zhvilluesi privat shprehin interes për të hyr në marrëveshje me Bashkinë e Elbasanit për këtë qëllim.

Ky vendim me përcaktimet e parashikuara në relacionin bashkëlidhur, hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

Zv. KRYETARI
ALKETA IPEKU

Drejtoria A.P.S	A. Suli
Drejtoria e Buxhetit	M. Beluli
Drejtoria e Financës	A. Merkja
Drejtoria P.P.A.A.B.F	Q. Tusha
Drejtoria e P.T.P	G. Tabaku
Drejtoria Juridike	O. Deliallisi
Avokati Qytetit	A. Hoxha
Zv.Kryetari	K. Krasnika

2422/2
25.03.19

6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr.420/1 prot.

Elbasan, më 26.3.2019

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.38 datë 21.03.2019 "Për përcaktimin e procedurës për negociimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me bashkinë e Elbasanit nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Gledian Llatja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

499
28.3.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2268/1 **Prot.** **Elbasan, më**___.___.**2019**

VENDIM

Nr. 39 **Datë :** 21/03/ **2019**

" Mbyllje procedure privatizimi banese shtetërore"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.___.2019 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës, (Sektori i Strehimit, Privatizimit), mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.1440 datë 04.04.1996 " Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara ", Ligji Nr. 22/2018 "Per Strehim Social", VKM nr.97 datë 03.02.2008 " Për procedurat e privatizimit të banesave ", objekt i ligjit nr.7652 date 23.12.1992 " Për privatizimin e banesave shtetërore ", si dhe ligji nr.9321, datë 25.11.2004 " Për privatizimin e banesave shtetërore dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore " .

V E N D O S I :

1) Miraton ***"Mbyllje procedure privatizimi banese shtetërore"*** për qytetarët e mëposhtëm:

- **Qytetari Shyqyri Sadri Meta dhe personat e tjerë madhore sipas çertifikatës të gjëndjes familjare 01.12.1992**, banor në lagjjen " Vullnetari ", pallati nr.646/1, hyrja A, kati 3, apartamenti nr.3, zona kadastrale 8525, Elbasan, e përbërë nga një dhomë dhe një kuzhinë.

Tarifat e pagesës së privatizimit do të bëhen në mbështetje të VKM Nr.97 datë 03.02.2008

" Për procedurat e privatizimit të banesave shtetërore ".

Llogaritja e koeficientëve për vlerën e banesës dhe të truallit do të merren parasysh të dhënat e paraqitura sipas indeksit dhjetor 1992 dhe indeksi muajit në momentin e nënshkrimit të

kontratës së shit-blerjes të këtyre banesave .

2) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës, (Sektori i Strehimit, Privatizimit).

3) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

ZV/KRYETARI

Alketa IPEKU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:
Sektori i Strehimit: *A.Xhaja* *A. Gjorga*
Drejtore e DAPS: *A. Suli*
Drejtor i DPPAABF: *Q. Tusha*
Drejtore e DJ: *O.Deliallisi*
Zv/Kryetar: *K. Xhoxhi*

2268/2
02.04.19

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 499/1 prot.

Elbasan, më 2.4.2019

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.39 datë 21.03.2019 "Për mbyllje procedure privatizimi banese shtetërore", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Gledian Llatja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-NA
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

500
28.3.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2385 Prot.

Elbasan, më___.03.2019

V E N D I M

Nr.40 Datë:21.03.2019

Mbi miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pasurive ndodhur në Z.K. 8527, lagja "Emin Matraxhiu", për realizimin e projektit, me interes publik "Rikonstruksion i Rrugës "Haki Ballshi"", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi"".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.03.2019 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operiacionale dhe Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Miraton në parim fillimin e proçedurës së shpronësimit për pasuritë nr. 178/19; 178/11; 179/16; ndodhur në Z.K 8527, lagja "Emin Matraxhiu", për realizimin e projektit, me interes publik "Rikonstruksioni i Rrugës "Haki Ballshi"", nga Bashkia Elbasan.

2. Miraton përdorimin e shumës së mbetur disponibël nga kredia e miratuar me V.K.B. nr.101 datë 23.11.2009, si burim financimi për shpronësimin e pasurisë të prekur nga projekti i lartpërmendur.

3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

ZV/KRYETAR
Alketa Ipeku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN -

Sektori Pronave : *R. Hida*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Finances: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *Q. Tusha*
Drejtoria P.Sh.O.: *E. Kënuti*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *K. Xhoxhi*

2385/2
08.04.19

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr.500/1 prot. Elbasan, më 3.4.2019

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.40 datë 21.03.2019, "Për miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pasurive ndodhur në Z.K. 8527, lagja "Emin Matraxhiu", për realizimin e projektit me interes publik "Rikonstruksion i Rrugës Haki Ballshi", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Gledian LLATJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", Tel: 054 252138, www.prefektielbasan.gov.al, prefekti.elbasan@mb.gov.al

603

24.4.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3084/1 Prot

Elbasan më 24/04/ 2019

VENDIM
Nr. 41 datë 23 04.2019

Për propozimin e dhënies së ndihmës ekonomike për muajin PRILL 2019

Bazuar në nenin 29 të ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, në nenin 6 të kreut II të V.K.M nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" si dhe Udhëzimi nr. 3 datë 17.2.2017 "Mbi zbatimin e VKM nr. 955, datë 7.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar,

VENDOSI

Të propozojë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan të përfitojnë nga aplikimi:

1. Kanë aplikuar për ndihmë ekonomike **6134** familje, me një fond mujor _____ lekë,
2. Individë me statusin e Jetimit **16** persona, me një fond **48000** lekë,
3. Individë viktima të trafikimit **1** persona, me një fond **3000** lekë,
4. Individë viktima të dhunës në familje **45** persona, me një fond **135000** lekë,
5. Individë prindër të fëmijëve të lindur:
   a. Trinjakë **1** familje, me një fond **9000** lekë;
   b. Katërnjakë **0** familje, me një fond **0** lekë;
   c. Pesënjakë e më shumë njëherësh **0** familje, me një fond **0** lekë
6. Fëmijë në kujdestari të një familje kujdestare **9** aplikime, me një fond **81000** lekë,
7. Kompesim per dhenien e energjise elektrike **3186** familje.

Drejtori K. Social Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori i Buxhetit E. Beluli
Drejtori i Financës A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Altin Idrizi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

604
24.4.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3085/1 Prot Elbasan më 24 /04/2019

VENDIM

Nr 42 datë 23 /04/2019.

Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë, për muajin PRILL 2019

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21, 34, 29 pika 9 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"(i ndryshuar), V.K.M nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" të Udhëzimit nr. 4 datë 17.02.2017 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar të M.M.S.R si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 5 datë 24.01.2019

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin PRILL 80 familje me fond 250.000 lekë.
2. Masa e pagesës për familjet përfituese të jetë sipas VKM nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" pika 13, dhe udhëzimit nr.4 datë 17.2.2017 të MMSR të ndryshuar.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Sh. K. Soc Komunit Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Financës A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Altin Idrizi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

605

24.04.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr3086/1 Prot Elbasan më 24 /04/ 2019

VENDIM
Nr. 43 datë 23 /04/2019

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin PRILL 2019

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 29 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, V.K.M nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", Udhëzimeve nr. 3, 4 dhe 5 datë 17.2.2017, "Mbi zbatimin e vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuara të M.M.S.R si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 50 datë 19.05.2017

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **PRILL 2019** gjithsej 180 familje me një fond prej 500.000 lekë.
2. Masa e pagesës për familjet përfituese të jetë sipas V.K.M nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve,të procedurave,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" pika 13 dhe të udhëzimeve nr 3,4 dhe 5 datë 17.02.2017 te ndryshuar të M.M.S.R
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Altin Idrizi

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

606
24.04.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr.3084/1 prot. Elbasan më 24.04. 2019

VENDIM
Nr. 44 datë 23 /04/2019

Mbi dhënien e Pagesave për aftësinë e kufizuar për muajin PRILL 2019

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 7 dhe neni 29 pika 2 të ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar; V.K.M nr. 618 datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar; Udhëzim nr. 626, datë 27.8.2018 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar"; ligjin nr. 8089, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit"i ndryshuar, VKM nr. 277 datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit" Udhëzimin nr. 627 datë 27.08.2018 ''Mbi zbatimin e Vendimit Nr 277 te Këshillit te Ministrave Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit", i ndryshuar ; Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", V.K.M nr. 31 datë 20.01.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar; Udhezimin nr. 625 date 27.08.2018 "Mbi zbatimin e Vendimit Nr.31 datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave ''Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar ;V.K.M nr. 869 datë 18.06.2008 "Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit",

VENDOSI

1. Të përfitojnë pagesë paaftësie për muajin PRILL 2019 në total 6701 persona me fond 85.628.410 lekë, të ndarë në :

- Persona të paaftë 4630 persona
- Kujdestarë paaftësi 616 persona
- Të verbër 694 persona ;
- Kujdestarë verbërie 142 persona ;
- Para/tetraplegji 311 persona ;
- Kujdestarë p/tetraplegj 308 persona

2. Përfitojnë pagesë për shkak invaliditeti në punë për muajin PRILL 2019, në total 5705 persona me fond 18.520.200 lekë.
3. Kompesim për energjinë elektrike 824 persona me fond 1.741.720 leke.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar dhe Drejtoria e Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:

Dr.Sh. K.S.Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxhetit M . Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Altin Idrizi

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

655

30.4.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3088/1 **Prot.** **Elbasan më,**26.04.**2019**

VENDIM

Nr. 45 **Datë:**23 **.04.2019**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e baneseve të shtetasve Z. Arjan Sotir Panxhi banor i fshatit Shelcan Nj. Ad. Shushicë, Z. Nebi Gani Basha Banor i fshatit Mamël Nj. Ad. Gracen, Z. Artan Ramazan Tafa banor i fshatit Bradashesh Nj. Ad. Bradashesh e Z. Shefqet Dalip Musaj banor i fshatit Kusarth Nj. Ad. Bradashesh dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.04.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e baneseve të shtetasve Z. Arjan Sotir Panxhi banor i fshatit Shelcan Nj. Ad. Shushicë, Z. Nebi Gani Basha Banor i fshatit Mamël Nj. Ad. Gracen, Z. Artan Ramazan Tafa banor i fshatit Bradashesh Nj. Ad. Bradashesh e Z. Shefqet Dalip Musaj banor i fshatit Kusarth Nj. Ad. Bradashesh dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr.8756 datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

VENDOSI:

3. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesat e shtetasve:
   - **Z. Arjan Sotir Panxhi** është në **179 634** (njëqind e shtatëdhjetë e nëmtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në

pajisje dhe orendi, d.m.th. **51 268 x 50% = 25 634 lekë + 154 000 lekë = 179 634** lekë.

- **Z. Nebi Gani Basha** është në **196 674** (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **265 348 x 50% = 132 674 lekë + 64 000 lekë = 196 674** lekë.
- **Z. Artan Ramazan Tafa** është në **158 486** (njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **244 972 x 50% = 122 486 lekë + 36 000 lekë = 158 486** lekë.
- **Z. Shefqet Dalip Musaj** është në **91 860** (nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **183 721 x 50% = 91 860 lekë + 0 lekë = 91 860** lekë.

2. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga bashkia Elbasan.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetëmijë) lekë, për secilën familje:
   Z. Arjan Sotir Panxhi
   Z. Nebi Gani Basha
   Z. Artan Ramazan Tafa
   Z. Shefqet Dalip Musaj
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës për shtetasit:
   Z. Arjan Sotir Panxhi prej **129 634** (njëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlera totale e dëmeve të konstatuara) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.
   Z. Nebi Gani Basha prej **146 674** (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlera totale e dëmeve të konstatuara) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.
   Z. Artan Ramazan Tafa prej **108 486** (njëqind e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlera totale e dëmeve të konstatuara) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.
   Z. Shefqet Dalip Musaj prej **41 860** (dyzet e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlera totale e dëmeve të

konstatuara) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.

meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 2 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Ju faleminderit!

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Altin Idrizi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

656
30.4.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3086/1 **Prot.** **Elbasan më,** 26.04.**2019**

VENDIM

Nr. 46 **Datë:** 23 **.04.2019**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesat e Z. Pëllumb Selim Dërstila banor i fshatit Dërstilë, Njësia Administrative Gjinar, Z. Nozi Veri Shqau banor i fshatit Gjinar, Njësia Administrative Gjinar, Z.Naim Kamber Muça banor i fshatit Kamiçan, Njësia Administrative Zavalinë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.04.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e baneseve të shtetasve **Z. Pëllumb Selim Dërstila** banor i fshatit Dërstilë, Njësia Administrative Gjinar, **Z. Nozi Veri Shqau** banor i fshatit Gjinar, Njësia Administrative Gjinar e **Z. Naim Kamber Muça** banor i fshatit Kamiçan, Njësia Administrative Zavalinë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr.8756 datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

VENDOSI:

4. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmet e shkaktuara nga rrëshqitja në banesat e shtetasve:
   - **Z. Pëllumb Selim Dërstila** është në **1 000 144** (një milion njëqind e njëmbëdhjetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët, d.m.th. **2 000 289 x 50% = 1 000 144 lekë.**
   - **Z. Nozi Veri Shqau** është në **1 668 175** (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **3 336 350 x 50% = 1 668 175 lekë.**
   - **Z. Naim Kamber Muça** është në **855 676** (tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashttëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së

preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **1 711 352 x 50% = 855 676 lekë.**

2. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga bashkia Elbasan.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetëmijë) lekë, për secilën familje:
   Z. Pëllumb Selim Dërstila
   Z. Nozi Veri Shqau
   Z. Naim Kamber Muça
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës për shtetasit:
   Z. Pëllumb Selim Dërstila prej **950 144** (nëntëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.
   Z. Nozi Veri Shqau prej **1 618 175** (një milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.
   Z. Naim Kamber Muça prej **805 676** (tetëqind e pesë mijë e gjashttëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.

meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 2 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Ju faleminderit!

SEKRETARI **KRYETARI**

Klajd Gripshi **Altin Idrizi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

652
30.4.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3054/1 **Prot.** **Elbasan më,**26.04.**2019**

VENDIM

Nr. 47 **Datë:** 23 **.04.2019**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesat e Z. Xhevit Rexhep Bardhi, Z. Shpëtim Behexhet Vaska, Z. Ramazan Mustafa Vaska, Z. Ramazan Hasan Musta, Z. Petraq Demir Vaska, Z. Hyqmet Demir Vaska, Z. Behexhet Demir Vaska. banor në fshatin Godolesh, Njësia Administrative Labinot Fushë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.04.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e baneseve të shtetasve **Z. Xhevit Rexhep Bardhi, Z. Shpëtim Behexhet Vaska, Z. Ramazan Mustafa Vaska, Z.Ramazan Hasan Musta, Z. Petraq Demir Vaska, Z. Hyqmet Demir Vaska, Z. Behexhet Demir Vaska,** banor në fshatin Godolesh, Njësia Administrative Labinot Fushë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr.8756 datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

VENDOSI:

3. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmet e shkaktuara nga rrëshqitja në banesat e shtetasve:
   - **Z. Xhevit Rexhep Bardhi** është në **1 878 387** (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët, d.m.th. **3 956 775 x 50% = 1 878 387** lekë.
   - **Z. Shpëtim Behexhet Vaska** është në **1 338 525** (një milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **2 679 051 x 50% = 1 338 525** lekë.

- **Z. Ramazan Mustafa Vaska** është në **894 265** (tetëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **1 988 530 x 50% = 894 265** lekë.
- **Z. Ramazan Hasan Musta** është në **1 338 160** (një milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **2 676 320 x 50% = 1 338 160** lekë.
- **Z. Petraq Demir Vaska** është në **1 333 839** (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **2 667 679 x 50% = 1 333 839** lekë.
- **Z. Hyqmet Demir Vaska** është në **1 656 559** (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **3 313 118 x 50% = 1 656 559** lekë.
- **Z. Behexhet Demir Vaska** është në **1 972 233** (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **3 944 466 x 50% = 1 972 233** lekë.

2. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga bashkia Elbasan.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetëmijë) lekë, për secilën familje:
   Z. Xhevit Rexhep Bardhi
   Z. Shpëtim Behexhet Vaska
   Z. Ramazan Mustafa Vaska
   Z. Ramazan Hasan Musta
   Z. Petraq Demir Vaska
   Z. Hyqmet Demir Vaska
   Z. Behexhet Demir Vaska
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës për shtetasit:
   Z. Xhevit Rexhep Bardhi prej **1 828 387** (një milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.
   Z. Shpëtim Behexhet Vaska prej **1 288 525** (një milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Z. Ramazan Mustafa Vaska prej **844 265** (tetëqind e dyzet e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Z. Ramazan Hasan Musta prej **1 288 160** (një milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Z. Petraq Demir Vaska prej **1 283 839** (një milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Z. Hyqmet Demir Vaska prej **1 606 559** (një milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Z. Behexhet Demir Vaska prej **1 922 233** (një milion e nëntëqind e njëzet e dy mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 1 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi.

meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 2 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Ju faleminderit!

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Altin Idrizi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

6578
30.4.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Nr.3090/1 **Prot.** **Elbasan, më** 26.04. **2019**

VENDIM
Nr.48 **Date** 23/04/2019

"Mbi miratimin e mases se qirase mujore te banesave sociale me qira, per vitin 2019"

Keshilli bashkiak ne mbledhjen e tij te dates /04/2019 , pasi shqyrtoi relacioni e paraqitur nga Njesia e Menaxhimit te Banesave Sociale , mbeshtetur ne :
-Ligjin nr.139/2015 "Per veteqerisjen vendore"
-Ligjin NR.9232 date 13/05/2004 "Per programet sociale te strehimit"(i ndryshuar)
-Manualin e Menaxhimit te banesave Sociale

VENDOSI :

1)Te miratoje *"Masen e qirase mujore te banesave sociale me qira , per vitin 2019"*si me poshte:
-Me siperfaqe prej **77.88** m2, masa e qirase eshte **8.100** leke ;
-Me siperfaqe prej **72.07** m2, masa e qirase eshte **7.500** leke ;
-Me siperfaqe prej **69.67** m2, masa e qirase eshte **7.200** leke ;
-Me siperfaqe prej **56.72** m2, masa e qirase eshte **5.900** leke ;
2)Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Njesia e Menaxhimit te banesave Sociale,Sektori i Strehimit dhe Drejtoria e Buxhetit.
3) Ky vendim hyn ne fuqi10 dite pas shpalljes .

SEKRETARI
Klajd GRIPSHI

KRYETARI
Altin IDRIZI

Koncepoi
Njesia e Menaxhimit te BS : A.Lushnjani S.Çepa XH.Kapllanaj

659
30.4.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3081/1 Prot.

Elbasan, më 26.04.2019

V E N D I M

Nr. 49 datë 23.04.2019

PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE TË EKONOMIVE PYJORE "FUSHKUQE-ZAVALINË "DHE "SHPAT"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____.____.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit "Mbi hartimin e planeve të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomive pyjore "Fushkuqe-Zavalinë" dhe "Shpat" (pjesa ekonomike 1&2)" , i mbështetur në:

Ligjin nr.7850 datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9385, dt. 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, ligjin nr. 10120 dt. 23.4.2009 'Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjeksore...' ligjin nr.10006, dt. 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", ligjin nr.10253, dt. 11.03.2010 "Për gjuetinë", Vendimin e Këshillit të Ministave nr. 433 dt.8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", urdhërin nr. 62 dt. 4.4.2016 '...lista e llojeve të shpendëve të egër veçanërisht vunerabël...', urdhëri nr.1280 datë 20.11.2013 'për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës së egër', akteve nënligjore në zbatim të tyre, rregulloren nr. 4, dt.19.9.2008, udhëzimin nr. 1 dt.28.3.2001 "Për hartimin e planeve të mbarështrimit", i miratuar nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Kërkimeve Pyjore, dhe 'Manualin e mbarështrimit të pyjeve',

V e n d o s i:

1. Të miratojë rishikim e Planeve te Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave të ekonomive pyjore "Fushkuqe-Zavalinë" dhe "Shpat" (pjesa ekonomike 1 dhe 2).

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.

Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Altin Idrizi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Juristi i DSHPBVM	R. Kasa
P/Sektorin e Admin.-menaxhmit	J. Bodurri
Drejtori DSHPBVM	Sh. Çullhaj
Drejtoria Juridike	O Deliallisi
Drejtoria e DPPAABE	Q. Tusha
Z/V Kryetari	K.Krasnika

660
30.4.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3083 Prot. **Elbasan, më 26.04.2019**

V E N D I M

Nr.50 Datë:23.04.2019

"Mbi dhënie në përdorim, (pa kundërshpërblim) të ambjentit ish-DRSHTRR Lagja"Hekurudha", U.K.E sh.a. nga Bashkia Elbasan"".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.04.2019 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore"*, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;

V E N D O S I :

1. Miraton dhënien në përdorim (pa kundërshpërblim) të ambientit ish-DRSHTRR me sipërfaqe 209 m^2 ndërtesë dhe 740 m^2 truall, ndodhur në Lagjen "Hekurudha", Z.K 8523, për t'u përdorur si zyra të U.K.E Sh.A., për periudhën 1 (një) vjeçare nga data 01.04.2019 deri më 31.03.2020 (planvendosje bashkëlidhur).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (sektori pronave), Drejtoria e Përgjithëshme Operacionale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Altin Idrizi

Sektori Pronave:	*R. Thanasi*
Drejtoria A.P.S.:	*A. Suli*
Drejtoria Buxhetit:	*M. Behluli*
Drejtoria Financës:	*A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.:	*Q. Tusha*
Drejtoria P.Sh.O.:	*E. Kënuti*
Drejtoria Juridike:	*O. Deliallisi*
Zv.Kryetari:	*K. Xhoxhi*

661
30.4.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK I QYTETIT ELBASAN

Nr. 3415/2 Prot. Datë 26 .04. 2019

VENDIM

NR. 57 DATË 23 . 04. 2019

MBI

"Transferim fonde për investime"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 23. 04. 2019, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Transferim fonde per investime", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", vendimin e Këshillit Bashkiak nr.162, datë 24.12.2018 mbi "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2019" dhe nr.26, date 21.03.2019 "Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve, si dhe transferim fonde në buxhetin e vitit 2019",

VENDOSI :

1. Miratimin e fondit 4,500,000 lekë, për financimin e objektit "Blerje koka ndricuesish, me gjithë krahë", për Agjensinë e Shërbimeve Publike, duke bërë transferimet, si më poshtë :

   Paksohet :
   - 570,000 lekë, (grant), objekti "Furnizim vendosje kufizues shpejtësie" (tepricë nga prokurimi), artikulli 231, ASHP.
   - 3,930,000 lekë, (të ardhura), shpenzime energji elektrike, artikulli 602, ASHP.

   4,500,000 lekë gjithsej.

   Shtohet :
   - **4,500,000** lekë, objekti "Blerje koka ndriçuesish me gjithë krahë", programi 06440, artikulli 231, ASHP.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Prokurimeve dhe ASHP.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Altin Idrizi

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa", Tel. +355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

3115/3
13.05.19

2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr.Prot 661/1 **Elbasan, më** 08.05.**2019**

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.51 dt.23.04.2019 "Mbi transferim fonde për investime", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Gledian LLATJA

